



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 237 Akti

Nr. 318 Vendimi
Tiranë, më 3.12.2020

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Brunilda Bekteshi	Relatore
Xhensila Pine	Anëtar

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Denisa Kosta, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova, në datën 17.11.2020, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Kujtim Luli**, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, paragrafi 5, neni Ç, paragrafi 1 dhe nenet D, DH dhe E, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Brunilda Bekteshi, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. FAKTET DHE RRETHANAT E ÇËSHTJES

- 1.** Subjekti i rivlerësimit, z. Kujtim Luli, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme, referuar pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtruar rivlerësimit, *ex officio*, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni).
- 2.** Referuar neneve 33, 39 dhe 43, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komision e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP).
- 3.** Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni ka zhvilluar shortin në datën 15.3.2019, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit, z.Kujtim Luli, do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Brunilda Bekteshi dhe Xhensila Pine. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Brunilda Bekteshi.
- 4.** Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 21.11.2018, të trupit gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Kujtim Luli, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioner Olsi Komici. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
- 5.** Në datën 3.7.2019, subjektit iu komunikua në rrugë elektronike përbërja e trupit gjykues, duke iu bërë me dije e drejta për t’u shprehur në lidhje me konfliktin e interesit. Subjekti i rivlerësimit, në datën 4.7.2019, deklaroi përmes postës elektronike se nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit.
- 6.** Në datën 6.10.2020 Komisioni me vendimin nr. 2, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ për të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit; (iii) mbi paraqitjen e pretendimeve brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e njoftimit me postë elektronike për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35 - 40 dhe 45 – 47, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në zbatim të vendimit të sipërcituar, subjektit të rivlerësimit iu njoftuan rezultatet e hetimit dhe në datën 14.10.2020 subjekti dërgoi parashtrësja/shpjegime në rrugë zyrtare¹së bashku me dokumentacionin shoqërues mbështetës.

8. Në datën 15.10.2020, trupi gjykues, me vendimin nr.3, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Kujtim Luli, në seancë dëgjimore, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti u njoftua me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 19.10.2020, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

9. Në datën 16.10.2020, trupi gjykues, me vendimin nr. 4, të vendosi rihapë hetimin administrativ, për shkak të paraqitjes së një denoncimi anonim, dhe, po në të njëjtën datë, njoftoi edhe subjektin e rivlerësimit.

10. Në datën 10.11.2020, trupi gjykues, me vendimin nr. 5, vendosi rimbylljen e hetimit administrativ, dhe kalimin në seancë dëgjimore, duke e njoftuar, subjektin me anë të postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 17.11.2020, në orën 10:00, në Pallatin e Koncerteve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

11. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Kujtim Luli, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Elka Ermenkova. Subjekti i rivlerësimit ishte prezent në seancën dëgjimore, ku shpjegoi lidhur me rezultatet e hetimit dhe barrën e provës. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

12. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Kujtim Luli, si dhe të ndërpresë seancën dëgjimore të datës 17.11.2020, për të rifilluar në datën 3.12.2020, për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Z. Kujtim Luli ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas afatit të përcaktuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, përgjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ të zhvilluar.

IV. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

14. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport² për dosjen nr. IND - ***, si për subjektin e rivlerësimit, ashtu edhe për personat e lidhur, për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas neneve 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016, ku konstatohet:

➤ *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mosdeklarim të pasurisë ndër vite;*

¹Me shkresën nr. *** prot., datë 16.11.2020.

²Me shkresën nr. *** prot., datë 20.6.2018.

- ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurive;
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- nuk ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

15. Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë *Vetting*, në zbatim të nenit 31/1, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Kujtim Luli, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në datën 26.1.2017 (duke përfshirë personin e lidhur), në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, fakt ky qëkonfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Për sa më sipër, subjekti e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit, z. Kujtim Luli, është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

16. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI, në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (d) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, deklaratimet e subjektit gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (e) deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI; (ë) analizën financiare të bërë nga Njësia Ligjore e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Nga shqyrtimi i provave të administruara nga Komisioni, për secilën nga pasuritë dhe të ardhurat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur rezulton, si vijon:

1. Në lidhje me pasurinë e paluajtshme, apartament me sip.105.1 m² në Rr. “F. R.”, p. ***, shk. ***, ap. ***, Tiranë, blerë me kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 23.7.2003 dhe me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 1.11.2014, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me certifikatën me nr. pasurie ***, z. k. ***, me sip. 93 m².

Burimi i krijimit:kredia për strehim në Bankën e Kursimeve në shumën 5.000.000 lekë, me afat shlyerje 25 vjet. Vlëra: 48.346 USD. Pjesa takuese: 50%.

1.1 Për këtë pasuri, subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës dokumentet, si vijon³: certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 16.12.2014; kontratë shitblerje nr. ***, datë 1.11.2014; kontratë sipërmarrje, datë 23.7.2003, ndërmjet shtetases N.Z., investitore, shoqërisë së ndërtimit “****”

³Referojuni Aneksit nr. 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së.

sh.p.k., në cilësinë e ndërtuesit dhe subjektit Kujtim Luli, në cilësinë e porositësit; prokurë e hartuar me porosi në datën 30.4.2014 në Turqi nga shtetësja Ç. Z. (N. Z.).

Faktet e konstatuara dhe hetimi i kryer nga Komisioni

1.2 Këtë pasuri subjekti e deklaroi për herë të parë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 me përshkrimin: *“Apartament 2+1, në fazën e ndërtimit, i porositur, sipas kontratës së sipërmarrjes, me investitorin dhe firmën ndërtuese. Sipërfaqja 105 m². Vlera: 48.346 USD. Burimi i krijimit: kredi për strehim në Bankën e Kursimeve, Dega Tiranë”*.

1.3 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, subjekti ka deklaruar: *“Pasuri e paluajtshme e peregjistruar, një apartament me sipërfaqe 105.1 m² në Rr. “F. R.”, pas A.-së, ap. ***, Tiranë, pagesa me kredi, me kontratë sipërmarrje të vitit 2003 në emrin tim, hyrë në shtator 2005”*.

1.4 Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, subjekti deklaroi: *“Regjistruar pasuria e paluajtshme (deklaruar në vitin 2005 me kontratën e sipërmarrjes) me certifikatën e pronësisë nr. ***, datë 16.12.2014, zona kadastrale ***, Tiranë, një apartament me sipërfaqe 93 m², Rr. “F. R.”, shk. ***, kat. ***, ap. ***, Tiranë. Vlera: 48.346 USD”*.

1.5 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2019, informon se në emër të shtetasit Kujtim Sh.Luli figuron e regjistruar pasuria: apartament me sip. 93 m², z. k. ***, vol. ***, f. ***, në bashkëpronësi me znj. F. M. L. .

1.6 UKT-jame shkresën nr. ***prot., datë 1.10.2019, informon se shtetasi Kujtim Luli identifikohet abonent me kontratën: nr. ***, për objektin me adresë, Rr. “F.R.”, Tiranë. Kontrata është me status aktiv në kategorinë e konsumatorëve familjarë. Nga kontrolli në arkivën e UKT-së për kontratën me nr. *** disponohet regjistër i kontraktuesve të vitit 2005.

1.6.i Nga hetimi ka rezultuar se kontratat apo abonentët e tjerë të identifikuar në informacionin e dhënë, nuk i përkasin subjektit apo kësaj pasurie.

1.7 OSHEE-ja me shkresën nr. *** prot., datë 3.10.2019, informon se shtetasi Kujtim Luli, identifikohet abonentë me kontratë të furnizimit me energji elektrike me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, kontratë në qytetin e Tiranës, në adresën Rr.“F.R.”.

1.7.i Nga hetimi ka rezultuar se kontratat apo abonentët e tjerë të identifikuar në informacionin e dhënë, nuk i përkasin subjektit apo kësaj pasurie.

1.8 Kjo pasuri konfirmohet me kontratën e shitblerjes⁴së pasurisë së paluajtshme nr. ***, datë 1.11.2014, me palë shitëse Ç. Z. (kjo e fundit rezultoi se ka ndryshuar emrin nga “N.Z.” në “Ç. Z.”) dhe palë blerëse shtetasit K. dhe F.L. .

1.8.i Sipas kësaj kontrate palët kanë rënë dakord që çmimi i shitjes së apartamentit me sip. 93m² dhe sipërfaqe të përbashkët 8 m², është 48.346 USD, vlerë e cila është likuiduar në përmbushje të kushteve të kontratës së pororsisë nr. 4924/840, datë 24.7.2003.Palët deklarojnë se apartamenti është marrë në dorëzim në vitin 2005.

⁴Aneks 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së.

1.8.ii Kontrata e sipërmarrjes⁵ nr. ***, datë 24.7.2003, ka si palë investitore znj.N.Z., si palë ndërtuese shoqërinë e ndërtimit “****” sh.p.k., dhe si palë porositëse z.Kujtim Luli. Sipas kësaj kontrate është porositur sipërfaqja e ndërtimit prej 105.1 m². Çmimi për sipërfaqe ndërtimi është përcaktuar 460 USD/m² x 105.1 m²= 48.346 USD.

1.8.ii.a Sipas parashikimeve të kontratës së sipërmarrjes:

- Kësti i parë do të paguhej menjëherë me kredinë e porositësit të dhënë nga Dega e Bankës së Kursimeve Tiranë, në shumën 5.000.000 lekë e konvertuar në 41.000 USD, në nr. e llogarisë *** në dollarë, në Bankën Amerikane, të firmës ndërtuese “****” sh.p.k.
- Diferenca prej 7.346 USD do të paguhej nga porositësi, me përfundimin e të gjitha punimeve të parashikuara në projekt dhe në kontratë, me dorëzimin e çelësave të apartamentit.

1.9 Komisioni hetoi në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, nga ku rezultoi si vijon:

Në lidhje me kredinë e marrë për strehim në “Raiffeisen Bank” (ish-Banka e Kursimeve), në shumën 5.000.000 lekë

1.9.i Nga analiza e dokumentacionit të administruar, kjo kredi konfirmohet me kontratë huaje⁶ për blerje banese me nr***, datë 25.6.2003, nënshkruar mes palëve, huadhënës Dega e Bankës së Kursimeve Tirana -1, e përfaqësuar nga z.D.H. dhe huamarrës, z. Kujtim Luli.

1.9.ii Objekti i huas është përcaktuar për blerje banese, ku huaja e akorduar është në shumën 5.000.000 lekë, interesi bankar 3% në vit dhe i pandryshueshëm. Afati i kthimit 25 vjet.

1.9.iii Kontrata e huas është bazuar në VKM-në nr.102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

1.9.iii.a Kontrata e huas është shoqëruar edhe me kontratën e dorëzimit nr***, datë 25.6.2003, me palë dorëzantës z.N. L.(vëllai i subjektit të rivlerësimit) dhe huadhënës, Dega e Bankës së Kursimeve Tirana -1, e përfaqësuar nga drejtori i saj, z.D. H. .

1.9.iii.b Objekti i kësaj kontrate është hipotekimi i pasurisë së paluajtshme të dorëzantës N.L., në dobi të huadhënësit, për të siguruar përmbushjen e detyrimit të huas së dhënë huamarrësit z.Kujtim Luli në shumën 5.000.000 lekë.

1.9.iii.c Në kontratë është pasqyruar se dorëzantësi në bazë të regjistrimit hipotekor ka në pronësi një pasuri të regjistruar me nr.191, datë 19.5.2003, zona kadastrale nr. ***, që është një objekt, apartament i ndodhur në Rr. “****”, apartamenti ***, kati i shtatë, me sip.95.3 m².

1.10 Nga korrespondeca e mbajtur mes Komisionit dhe “Raiffeisen Bank”⁷rezulton se kredia e përfituar në shumën 5.000.000 lekë, është transferuar në datën 7.7.2003, te shoqëria “K****”sh.p.k., me nr.llogarie***, në Bankën Kombëtare Tregtare Nr.1, me përshkrimin “*Likuiduar me kredi sipas kontratës nr. *** rep., datë 12.5.2003*”.Në dokumentacionin e depozituar është administruar kontrata e sipërmarrjes datë 12.5.2003 (vërtetuar me nr. ***rep.,

⁵Aneks 4/1 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶Aneks 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷Shkresë nr***prot., datë 30.9.2019.

datë 19.5.2003), ndërmjet shoqërisë “K***” sh.p.k., në cilësinë e investitorit e përfaqësuar nga z.M. L. dhe nga ana tjetër z. Kujtim Luli që vepron me cilësinë e porositësit.

1.10.i Sipas kësaj kontrate, apartamenti ndodhet në pallatet në Rr. “***.”, afër stacionit të fundit të autobusave të Tiranës së Re, të pasqyruar në planimetrinë e apartamentit nr. ***, kati ***, godina ***, sipas kërkesave të projektzbatimit dhe sipërfaqes të ndërtimit të porositur. Në të ka qenë parashikuar se *dorëzimi i apartamentit dhe ambienteve do të bëhet në datën 30.12.2003.*

1.10.ii Sipas parashikimeve kontraktore, detyrimet e porositësit ndaj sipërmarrësit janë cituar shprehimisht, si vjon:

“1. Të paguajë sipërfaqen e ndërtimit me çmim 400 USD/m², me vleftë gjithsej 44.800 USD ose me kursin e sotëm (122 lekë) 5.465.600 lekë.

2. Kësti i parë u pagua me firmosjen e kësaj kontrate në shumën 3.500USD ose 427.000 lekë.

*3. Kësti i dytë do të paguhet me kredi nga Dega e Bankës Kursimeve Tiranë në shumën 5.000.000 lekë ose 41.300USD, në nr. e llogarisë ***, të sipërmarrësit në BKT.*

4. Diferencat që do të krijohen për shkak të kursit të dollarit do të paguhet nga porositësi, me përfundimin e të gjitha punimeve të parashikuara në projekt dhe sipas kësaj kontrate”.

1.11 Komisionit gjatë hetimit i ka rezultuar se në datën 14.7.2003, subjektit i është kthyer në llogarinë e tij në Bankën Kombëtare Tregtare⁸ shuma 5.000.000 lekë nga shoqëria “K***” sh.p.k., me përshkrimin *“Anulim i kontratës së sipërmarrjes datë 12.05.2003 sipas transfertës ***, datë 10.06.2003”.*

1.11.i Komisioni e ka pyetur subjektin⁹ në lidhje me këto transaksione, si dhe për anulimin e kësaj kontrate. Ndër të tjera, subjekti ka sqaruar se: *“Nuk isha i kënaqur me cilësinë e punimeve në apartamentin e porositur dhe pas lidhjes së kontratës me shoqërinë “K***” sh.p.k., kam marrë një ofertë nga shoqëria e ndërtimit “***” për një apartament 2+1, me sipërfaqe 105.1 m² me vlerë 48.346 USD, në Rr. “ ***”, prapa ish-***, Tiranë. Kjo ofertë ishte më e mirë, si për faktin se pasuria/apartament ndodhej në një zonë më të mirë të Tiranës, larg rrugës kryesore, afër vendodhjes së institucionit ku unë punoj dhe afër shkollës së fëmijëve ...”.*

1.11.ii Subjekti ka depozituar dokumentacionin përkatës për të gjitha veprimet e tij, si vijon:

- kontratën e sipërmarrjes me shoqërinë “K***” sh.p.k., datë 12.5.2003 (vërtetuar me nr. ***rep., datë 19.5.2003);
- anulimin e kontratës së sipërmarrjes nr.4006 rep., datë 17.7.2003;
- deklaratën noteriale nr. ***, datë 14.7.2003;
- transaksionet bankare për tërheqjen e kredisë dhe pagesën prej 41.000USD për shoqërinë “***” sh.p.k., për apartamentin në Rr. “F.R.”, Tiranë.

1.11.iii Nga dokumentacioni i depozituar vihet re se si në deklaratën noteriale ashtu edhe në dokumentin e anulimit të kontratës citohet si nga administratori i shoqërisë ashtu edhe nga subjekti se është kthyer shuma 5.000.000 lekë, *se anulimi është bërë me mirëkuptim mes palëve dhe se është bërë për shkak se subjekti nuk ka qenë i kënaqur me plotësimin e kontratës, me*

⁸Shkresë nr. *** prot., datë 24.10.2019.

⁹Pyetësor nr.3, datë 18.3.2020.

cilësinë e punimeve që janë bërë nga sipërmarrësi në apartamentin e porositur prej tij. Për këstin në shumën prej 427.000 lekësh palët nuk shprehen nëse është kthyer apo jo.

1.11.iv Subjekti në përgjigje të pyetësorit sqaron se shuma prej 3.500 USD ose 427.000 lekë e paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes i është kthyer *cash* nga përfaqësuesi i shoqërisë ndërtimore “K.” sh.p.k. Ky fakt konfirmohet dhe nga znj. S. M. Sh., vajza e trashëgimlënësit M. L., me deklaratën personale, datë 14.10.2020, para noterit, e cila ka shpjeguar se: *“Jam në dijeni që shoqëria ‘K***’ sh.p.k., i ka kthyer z. Kujtim Luli edhe këstin e parë në shumën 3.500 USD, menjëherë me nënshkrimin e anulimit të akteve...”*¹⁰.

1.12 Në lidhje me pagesat për likuidimin e pasurisë apartament në Rr. “F. R.” dhe në analizë të dokumentacionit të administruar ka rezultuar se:

1.12.i Pas anulimit të kontratës, subjektit i është kthyer në datën 14.7.2003, shuma prej 5.000.000 lekësh në llogarinë e tij në BKT. Subjekti ka tërhequr në datën 24.7.2003, shumën prej 4.995.000 lekësh të cilën pasi e ka këmbyer e ka derdhur *cash* në llogarinë e tij në “Intesa Sanpaolo Bank”, në shumën prej 41.050 USD. Në po të njëjtën datë është transferuar shuma 41.000 USD për shoqërinë “****” sh.p.k., me përshkrimin “pagesë kontrate sipërmarrje”¹¹.

1.12.ii Subjekti deklaron si burim krijimi kredinë për strehim, në shumën 5.000.000 lekë ose 41.000USD, por ndërkohë gjatë hetimit¹² ka deklaruar se shumën 7.346 USD, si këst i dytë e ka paguar gjatë viteve 2003, 2004 dhe 2005, me materialet e nevojshme të ndërtimit dhe pajisjet për apartamentin. Për këtë shumë deklaron si burim krijimi të ardhurat dhe kursimet familjare nga paga të deklaruara në deklaratat periodike vjetore për vitet 2003, 2004 dhe 2005, si dhe vlerën prej 600.000 lekësh të shumës së përfutur nga shitja e pasurisë së trashëguar nga babai në Shkodër.

1.12.iii Komisioni ka analizuar kontratën e sipërmarrjes për këtë pasuri, datë 23.7.2003, nga ku ka rezultuar se parashikimet për pagesat e kësteve (referuar titullit II “Detyrimet e porositësit ndaj sipërmarrësit”), kanë qenë të kushtëzuara duke lejuar pagesën e këstit të parë në shumën 41.000 USD me kredinë e marrë nga subjekti në shumën 5.000.000 lekë dhe kësti i dytë prej 7.346 USD do të paguhet me përfundimin e punimeve, ashtu sikurse këto të fundit janë parashikuar në kontratë, si dhe me dorëzimin e çelsave të apartamentit. Në këto kushte, duket se nuk ka pasur gjasë që subjekti në tejkalim të këtij kushti, të shlyente të gjithë shumën kontraktore për porosinë e apartamentit prej 48.346 USD, duke konsideruar këtu parashikimin kontraktor të bërë në pikën 1 dhe 2 të titullit “III Detyrime të përbashkëta”, ku thuhet se: *“1. Pranohen ndryshime të kësaj kontrate si shtrim të dyshemesë të dhomave me parket, lëvizje e mureve ndarëse, et.j, deri në masën 15% për të cilat duhet të bien dakord të dyja palët (përqindje e cila i korrespondon afërsisht diferencës prej 7.346 USD e parashikuar në titullin II, pika 3 të kësaj kontrate), si dhe në pikën 4 ku thuhet se, në rast të depozitimit të shumës së plotë porositësit i bëhet zbritje (pra nëse pagesa do të ishte bërë e plotë do të ishte e evidente në kontratë së bashku me uljen prej 15%). Varianti më i pranueshëm është që subjekti ka paguar në vitin 2003 shumën 41.000 USD sikurse edhe ka deklaruar. Subjekti ka deklaruar gjatë hetimit administrativ se ka kryer këtë pagesë të përkthyer në materiale sikurse kanë lejuar (i*

¹⁰Deklarata notoriale datë 14.10.2020, bashkëlidhur shpjegimeve për rezultatet e hetimit datë 14.11.2020.

¹¹Kërkesë për transfertë e depozituar nga subjekti në Pyetësorin nr.3, datë 18.3.2020,

¹²Pyetësor nr.2, datë 3.2.2020.

kanë dhënë këtë mundësi) edhe parashikimet kontraktore të vitit 2003. Referuar kushtit kontraktor se kësti i dytë do të shlyhej me dorëzimin e apartamentit dhe ky fakt është deklaruar si i përmbushur në vitin 2005, si dhe referuar kontratës së formalizuar të shitjes së kësaj pasurie në vitin 2014, ku thuhet se pagesa e kësaj pasurie është shlyer sipas parashikimit në kontratën e sipërmarrjes, lë të nënkuptohet që shuma 7.346 USD është shlyer në formën e parashikuar në kontratë sipas vullnetit të shprehur mes palëve.

1.13 Komisioni, në analizën financiare të kryer për këtë pasuri, e ka pasqyruar investimin në shumën 41.000 USD (ose 5.000.000 lekë) në vitin 2003 dhe në shumën 7.346 USD në vitin 2005.

1.14 Nga analiza financiare për këtë pasuri, Komisionit i rezultoi se dukej se subjekti kishte pasur mundësi financiare të investonte në blerjen e kësaj pasurie, përgjatë viteve 2003 dhe 2005, të krijonte gjendjen *cash* të deklaruar prej 2.000.000 lekësh në vitin 2003 dhe ta mbante atë të pandryshuar, si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare dhe në këto kushte nuk i rezultuan problematika.

Në lidhje me kredinë e marrë për strehim në “Raiffeisen Bank” (ish-Banka e Kursimeve) në shumën 5.000.000 lekë

1.15 Nga dokumentacioni i administruar rezultoi se dhënia e kredisë është bazuar në VKM-më nr.102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”.

1.16 Komisioni e ka pyetur¹³ subjektin në lidhje me aplikimin dhe përfitimin e kësaj kredie, në përgjigje të së cilës subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 21.6.1999. Sipas kësaj shkrese, Prokuroria e Përgjithshme i është drejtuar Kryetarit të Këshillit të Ministrave, z.P.M., për shtimin e listës së përfituesve për kredi për strehim, me dy punonjës. Nga verifikimi i bërë, subjekti i rivlerësimit listohet i dyti.

1.17 Në lidhje me ligjshmërinë e përfitimit të kredisë lehtësuese, nisur nga kriteret¹⁴ e parashikuara në VKM-në nr. 102/1999, përfitimi i saj bëhej kur aplikanti nuk kishte banesë, apo për sipërfaqe shtesë banimi.

Nga hetimi administrativ ka rezultuar se subjekti në kohën e aplikimit dhe përfitimit të saj zotëronte pasurinë, apartament me sip. 55.9 m², në Rr. “Q. S.”, pll. ***, shk. ***, ap***, Tiranë, blerë me privatizim me kontratën, datë 21.9.1993, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me certifikatën me nr.pasurie ***, z. k. ***, të cilin subjekti e zotëron edhe aktualisht.

1.18 Kredia është akorduar në shumën 5.000.000 lekë, me interes bankar 3% në vit dhe të pandryshueshëm, me shlyerje për 25 vjet.

¹³Pyetësori nr. 2 datë 3.2.2020.

¹⁴Pasi pika 2, e VKM-së nr.102/1999, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, e ndryshuar, citon shprehimisht: “Gjatë kohës që funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore ... janë në këto funksione dhe janë pa banesë ose kane nevojë për një shtese sipërfaqeje banimi, u lind e drejta të kërkojnë strehim nga shteti. ..., u lind e drejta të kërkojnë strehim nga shteti.” Pika 6 e po këtij akti nënligjor citon shprehimisht: “Kredia jepet me vlerë deri në 5 milionë lekë, me interes 3 përqind dhe afat kthimi deri në 25 vjet për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore, që nuk kanë banesëderi në 2.5 milione leke me interes 3 përqind e afat kthimi në 15 vjet për ata që duan shtese sipërfaqeje banimi.”

1.19 Nga analiza e dokumentacionit të administruar, marrja e kredisë konfirmohet me kontratë huas¹⁵ nr. ***, datë 25.6.2003, me qëllim blerje banese. Akti kontraktor është nënshkruar mes Degës së Bankës së Kursimeve Tirana -1 dhe subjektit të rivlerësimit. Kalimi i saj është bërë në favor të shoqërisë ndërtuese “***” sh.p.k., nga e cila subjekti ka përfituar pasurinë objekt hetimi, të ndodhur në Rr. “F. R.”, Tiranë. Këtë pasuri subjekti e disponon aktualisht.

1.20 Për këtë kredi, rezultoi se subjekti kishte vendosur kolateral pasurinë e vëllait të tij (N. L.), me sip. 95.3 m², regjistruar me nr. ***, datë 19.5.2003 z. k. ***, ndodhur në Rr. “Bulevardi***”.

1.21 Komisioni për të verifikuar praktikën e kredisë, iu drejtua EKB-së me shkresën nr. *** prot., datë 6.8.2020. Kjo e fundit ka informuar se *nuk rezulton të ketë kryer procedura privatizimi apo kredihënie për qytetarin Kujtim Luli dhe, për rrjedhojë, nuk rezulton asnjë dokument apo dosje në emër të tij pranë këtij institucioni*. EKB-ja ka sugjeruar që praktika të kërkohet në “Raiffeisen Bank”.

1.22 Në vijim, Komisioni e shtriu kërkimin pranë “Raiffeisen Bank”. Kjo e fundit ka dërguar¹⁶ praktikën e kredisë. Nga dokumentacioni i administruar u konsatua se subjekti kishte depozituar kërkesë personale në datën 20.5.2003, për përfitimin e kredisë në shumën 5.000.000 lekë duke cituar se i referohet VKM¹⁷-së nr.102/1999, ndryshuar me VKM-nënr. 695, datë 20.12.2000. Gjithashtu, në praktikë rezulton i administruar, vërtetimi i organit punëdhënës në lidhje me pagën mujore dhe vjetore të subjektit të rivlerësimit, vlerësimi i pasurisë së lënë kolateral i cili përkon plotësisht me atë të depozituar nga subjekti gjatë hetimit administrativ. Konstatohet se pasuria me sip 95.3 m², e lënë kolateral për llogari të subjektit, figuron në emër të vëllait (N. Sh. L.) të këtij të fundit. Po ashtu, në aktet e administruara figuron edhe relacioni shpjegues i ekonomistit të kreditit ku, ndër të tjera, cilësohet dakordësia e tij për miratimin e kredisë pas verifikimit të kushteve dhe kriterëve për përfitimin e saj.

1.23 Komisioni i kërkoi subjektit të japë shpjegime¹⁸ pasi dukej se:(a) kredia në shumën 5.000.000 lekë nuk ishte përfituar në përputhje me kërkesat e VKM-së nr.102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, i ndryshuar; (b) nga analiza e dokumentacionit të administruar dhe sqaruar më sipër, dukej se subjekti në deklaratën periodike, si dhe deklaratën *Vetting* deklaronte si burim krijimi kredinë në shumën 5.000.000 lekë, ndërsa gjatë hetimit përveç kredisë pasqyron si burim edhe kursimet familjare nga paga, si dhe vlerën 600.000 lekë të përfituar nga shitja e pasurisë së trashëguar nga babai i tij, në qytetin e Shkodrës; dhe se (c) dukej se subjekti në vitin 2003 nuk kishte deklaruar detyrimin në shumën prej 7.346 USD, ndaj shoqërisë së ndërtimit “***” sh.p.k.

¹⁵Aneks 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁶Me shkresën nr. *** prot., datë 14.9.2020.

¹⁷Sipas pikës 7 të kësaj VKM-je kërkohet që kredimarrësit të paraqesin pranë Bankës së Kursimeve (më tej Raiffeisen Bank) këto dokumente: (a) kërkesën personale; (b) certifikatën e gjendjes familjare; (c) dokumentin identifikues; (ç) dokumentin e vërtetimit të të ardhurave personale; (d) aktin e blerjes së banesës, vlerësimi i së cilës është bërë nga ekspertë vlerësues të licencuar; (dh) në rastin e ndërtimit të banesës paraqitet dokumentacioni sipas ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998, "Për urbanistikën".

¹⁸Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

1.24 Për konstatimin e Komisionit të përshkruar në germën “a” dukej se kredia në shumën 5.000.000 lekë nuk ishte përfituar në përputhje me kërkesat e VKM-së nr.102, datë 5.3.1999, “Për trajtimin me strehim të funksionarëve politikë dhe nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore”, i ndryshuar, subjekti ka sqaruar, se:

*“Kredia është përftuar në zbatim të pikave 1, 2, 6, 7 e vijues të vendimit të KM-së nr.102, datë 5.3.1999, i ndryshuar me vendimin e KM-së nr. 965, datë 20.12.2000, sipas vullnetit të shprehur në listën e miratuar nga Kryetari i Këshillit të Ministrave, mbi kërkesën e Prokurorit të Përgjithshëm, i cili ka vlerësuar meritat, nevojat dhe gjendjen e strehimit të deklaruar nga ana ime, dhe në shkresën (nr*** prot., datë 21.6.1999), drejtuar Kryetarit të Këshillit të Ministrave, ka kërkuar citoj, “Në vijim të kërkesës sonë (nr. ***, datë 23.3.1999), për dhënie kredie për strehim shtojmë punonjësit:...2) Kujtim Luli, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme” (pa u shprehur në kërkesë për vlerën/shumën e kredisë).*

Në pikën 2 të vendimit nr.102/1999 është shprehur vullneti i Këshillit të Ministrave, që subjektet e parashikuar në nenin 1 të këtij vendimi (ku përfshihet dhe funksioni që unë ushtroja në Prokurorinë e Përgjithshme), kanë të drejtë të kërkojnë strehim nga shteti. Ndërsa, në pikat 3, 4 dhe 5 të këtij vendimi trajtohet kredia si mjet nëpërmjet të cilës ofrohet mundësia e strehimit nga shteti.

Në kuptim dhe interpretim të pikës 6 të këtij vendimi të ndryshuar (riformular), Këshillit të Ministrave, duke hequr togfjalëshit “...që nuk kanë banesë...” dhe “...për ato që duan shtesë sipërfaqe banimi” dhe zëvendësuar me togfjalëshin “...në përputhje me kërkesën e paraqitur nga funksionari”, ka hequr kushtet/kriteret për vlerën e kreditimit në vartësi të gjendjes së strehimit dhe e ka lënë (vlerën e kreditimit) në përputhje me vullnetin e funksionarit në kërkesën e paraqitur prej tij. Në zbatim të pikës 7 të vendimit të KM-së nr.102, datë 5.3.1999, në Degën e Bankës së Kursimeve kam paraqitur të gjithë dokumentat e listuar në KM. Kërkesa ime drejtuar bankës për kreditim në vlerën 5 (pesë) milion lekë është trajtuar dhe konfirmuar si e bazuar në ligj nga specialistët jurist dhe ekonomist të Degës së Bankës së Kursimeve Tirana 1, të cilët në relacionet përkatëse, pasi kanë verifikuar dhe konstatuar se plotësoja kushtet dhe kriteret ligjore dhe ekonomike për përfitimin e saj, kanë shprehur dakortësinë e tyre për miratimin e kredisë. Sipas subjektit, pagesat e kësteve të kredisë në shumën 5 (pesë) milion lekë, janë kryer rregullisht, deri në shlyerjen e plotë të kredisë në shtator 2020, duke paguar sipas planit të amortizimit të saj përfundimisht shumën 7.113.170 lekë ose 2.113.170 lekë apo 42,2 % më shumë se vlera e kredituar.

Kërkesa drejtuar bankës për tu kredituar me vlerën e përfituar 5 (pesë) milion lekë është në përputhje me vendimin e KM-në nr. 102, datë 5.3.1999, i ndryshuar me vendimin e KM 695, datë 20.12.2000, i cili ka ndryshuar pikën 6 të VKM-së nr.102/2019, që parashikonte: “Kredia jepet me vlerë deri në 5 milionë lekë, me interes 3 përqind dhe afat kthimi deri në 25 vjet për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore, deri ne 2.5 milione leke me interes 3 përqind e afat kthimi ne 15 vjet, në përputhje me kërkesën e paraqitur nga funksionari.”

Po sipas subjektit, këto rrethana fakti të bazuara në prova dhe në kuptim e interpretim të vendimit të KM i ndryshuar, qartësojnë dhe konfirmojnë bindshëm se kredia është përfituar në

përputhje me ligjin, arsye bazuar në të cilat kërkoj pranimin e këtij arsyetimi në vlerësimin e rezultatit të hetimit administrativ.

1.25 Për konstatimin e Komisionit të përshkruar në germën “b”, dukej se subjekti në deklaratën periodike dhe në deklaratën *Vetting* deklaroi si burim krijimi kredinë në shumën 5.000.000 lekë, ndërsa gjatë hetimit përveç kredisë shton si burim edhe kursimet familjare nga paga, si dhe vlerën 600.000 lekë të përfituar nga shitja e pasurisë së trashëguar nga babai në Shkodër, subjekti ka sqaruar se:

- *Në deklaratën periodike të vitit 2003 dhe në atë të Vetingut kam deklaruar kredinë në vlerën 5.000.000 lekë dhe kontratën e huas me Degën e Bankës Kursimeve Tirana I (aktualisht Raffaisen Bank), si burim krijimi kryesor i destinuar për blerjen e pasurisë së paluajtshme të apartamentit 2+1 në Rr: ‘F. R.’, dhe kam deklaruar gjithashtu vlerën 48.346 USD të pasurisë së porositur dhe kontratën e sipërmarrjes për këtë pasuri.*
- *Diferenca e vlerës së apartamentit të porositur me vlerën e paguar të kredisë në dukje përbën gabim material në mosdeklarimin e vlerës shtesë që do të mbulonte blerjen e pasurisë, ndërsa në fakt sipërmarrësi/ndërtuesit apartamentin e porositur për blerje e kanë shitur në vlerën 41,000 USD ose 5.000.000 lekë që i korrespondon vlera e kredisë e deklaruar. Kjo për faktin se në zbatim të nenit III të kontratës sipërmarrjes ndërtuesi/sipërmarrësi më kanë kaluar mua të drejtën për blerjen e disa materialeve/pajisjeve në masën 15 % të vlerës së kontratës ose në shumën 7.346 USD. Kjo shumë sipas kontratës do të përbënte këstin e fundit, nëse të gjitha materialet do të bleheshin nga sipërmarrësi/ndërtuesi.*
- *Vlera e materialeve të ndërtimit të blera nga unë në vitet 2003, 2004 dhe 2005 kanë pasur burim krijimi të ardhurat nga paga dhe vlerën 600.000 lekë të përfituar nga shitja e pasurisë së trashëguar nga babai, të deklaruara në deklaratat periodike 2003, 2004 dhe 2005, ndërsashpenzimet për blerjen e materjaleve, nisur nga fakti se nuk e kanë kaluar shumën/vlerën (5,000 dollar) e parashikuar në shkronjën “c” të nenit 4, të ligjit nr.9040, datë 10.3.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe disa nëpunësve publik”, në fuqi në kohën e kryerjes së këtyre shpenzimeve, nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore në vitet 2003, 2004 dhe 2005.*

1.26 Për konstatimin e Komisionit të përshkruar në germën “c”, dukej se subjekti në vitin 2003 nuk ka deklaruar detyrimin në shumën prej 7.346 USD, ndaj shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., subjekti ka sqaruar se:

- *Në vitin 2003 nuk kam deklaruar detyrimin në shumën 7.346 USA, ndaj shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k., dhe investitorit, për arsyet e sqaruar më sipër se me nenin III të kontratës shoqëria ndërtuese dhe investitori më ka njohur të drejtën që 15 % të vlerës totale të kontratës që i korrespondon këstit të fundit në vlerë 7.346 USD, materialet/pajisjet e shënuara në kontratë të bliheshin nga unë në cilësinë e porositësit, të drejtë të cilën e kam ushtruar në vitet 2003, 2004 dhe 2005, duke u bërë inegzistent ky detyrim ndaj sipërmarrësit/ndërtuesit.*

1.26.i Gjithashtu, subjekti në lidhje me shumën 3.500 USD ose 427.000 lekë, dhënë paraprakisht shoqërisë ndërtimore “K****” sh.p.k., me të cilën kishte pasur një kontratë sipërmarrje të mëparshme, ka sqaruar se kjo shumë i është kthyer nga arka e shoqërisë dhe për

këtë ka depozituar edhe deklaratën noteriale, datë 14.10.2020, në të cilën deklaruesi ka deklaruar kthimin e shumës në favor të z. Kujtim Luli.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues në analizë të provave të administruara, fakteve dhe rrethanave të cilësuar më sipër, përgjigjeve të subjektit në pyetësorë, si dhe parashtrimeve të tij në prapësime, arsyeton si vijon:

a. Në lidhje me ligjshmërinë e kredisë lehtësuese të përfituar nga subjekti, vlerësohen disa komponentë të cilët shihen të ndërthurur me njëri-tjetrin dhe që, për pasojë, e bëjnë bindës përfitimin e drejtë të saj, të bazuar në prova dhe në ligj. Më konkretisht, gjatë hetimit u konstatua se kredia është përfituar bazuar në VKM-në nr. 102/1999, dhe, për pasojë, edhe arsyetimi synon të pasqyrojë përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve reciproke të palëve që përfshihen në aktin nënligjor, me qëllim përfitimin e saj. Trupi gjykues, vlerëson se përmes këtij akti nënligjor, dhënia e dy mundësive¹⁹ për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese është parashikuar për disa kategori të caktuara përfituesish dhe që në çdo rast padyshim përfitimi i saj është paraprirë nga parashtrimi i nevojës për strehim nga aplikanti dhe, më tej, nga vijimi i procedurave nga institucioni punëdhënës. Është konstatuar se VKM-ja nr.102, datë 5.3.1999, ka ndryshuar, në një periudhë të shkurtër vetëm njëvjeçare nga viti 1999 në vitin 2000 duke pësuar një amendim të vetëm dhe, pikërisht, duke lënë në fuqi përfitimin e kredive në shumën 5.000.000 lekë apo 2.500.000 lekë, por pa cilësuar se kur mund të përfitohet secila prej tyre. Në të tilla kushte dispozita ka krijuar lehtësira në zbatueshmërinë e saj duke i lënë të drejtën organit punëdhënës që nën përgjegjësinë e tij të pranojë ose refuzojë kërkimin e një funksionari. Në këtë linjë ligjvënësi ka parashikuar edhe nenin 47 të ligjit nr.8737²⁰/20019 (ligjit të kohës). Përgjegjësia e organit punëdhënës në vlerësimin dhe pranimin e kërimit të çdo aplikanti nuk mund të shihet si e dhënë apriori por si një e drejtë ekskluzive mbi vlerësime të motivuara rast pas rasti.

Nga hetimi rezultoi se subjekti e ka përmbushur detyrimin e tij takues. Subjekti në mënyrë konsistente ka deklaruar se kërkesa për përfitim të kredisë lehtësuese është pranuar nga organi punëdhënës, pasi ka saktësuar nevojat dhe gjendjen e tij të strehimit, çka nënkupton se ka qenë i saktë dhe i vërtetë në kërkimin e tij, pra, duke treguar dhe pranuar pasjen e një apartamenti.

Në raport me parashikimet e aktit nënligjor nr. VKM-në nr.102/1999, vërehet se subjekti ka përmbushur edhe detyrimin tjetër të përcaktuar në pikën 7 të VKM-së, duke depozituar çdo dokumentacion të nevojshëm për miratimin e kredisë. Nga ana tjetër organi punëdhënës ka operuar mbi të drejtat e ushtruara prej subjektit për të kërkuar strehim nga shteti, për t'i mundësuar kredinë subjektin.

Trupi gjykues, verifikoi edhe mbi ekzistencën e ndonjë akti ligjor apo nënligjor të miratuar, ku të normohet sipërfaqe banimi për m², në rast të përfitimit të kredisë nga institucioni punëdhënës, për shkak të funksionit. U vërejt se ligjvënësi ka normuar²¹ sipërfaqe për m² për një person i cili përfiton nga *banesat e ndërtuara me fonde shtetërore*. Ky parashikim ligjor i

¹⁹Gjatë kohës që funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë të administratës së lartë shtetërore ... janë në këto funksione dhe janë pa banesë ose kanë nevojë për një shtesë sipërfaqeje banimi, u lënd e drejta të kërkojnë strehim nga shteti.

²⁰“Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”

²¹ Me VKM nr. 113, datë 20.01.1997 “Për normat e strehimit në banesat e ndërtuara me fonde shtetërore”

vlerësuar në parim, në rastin objekt hetimi administrativ, shihet në harmoni me faktet dhe rrethanat në të cilat subjekti i rivlerësimit ka aplikuar dhe përfituar kredinë lehtësuese. Në këtë drejtim trupi gjykues konstaton se:

Së pari, subjekti i rivlerësimit nuk ka përfituar strehim nga EKB-ja, pra, nga banesat e ndërtuara me fonde shtetërore. Po ashtu, sikurse qartësohet më sipër në arsyetim, në asnjë rast nuk u provua që subjekti të kishte kërkuar një vlerë të caktuar për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, ndërsa vlerësimi është bërë për arsyet dhe motivet e vlerësuar nga institucioni punëdhënës. Ky është argumenti bazë që kjo VKM, nuk është përfshirë si bazë ligjore në përfitimin e kësaj kredie dhe as ka gjetur zbatim në të. Gjithsesi, një shumë e përfituar për sipërfaqe shtesë, pra, e ndryshme nga ajo që subjekti ka përfituar, nuk gjen lehtësira për t'ju bashkëngjitur çdo apartamenti aktual, në një godinë me shumë banorë.

Së dyti VKM-ja nr.102/1999, nga ku ka përfituar subjekti nuk referon këtë akt nënligjor. Së treti, edhe nëse i referohemi këtij akti nënligjor, konstatohet se apartamenti që subjekti dispononte ishte thjesht dhe vetëm 1+1, me sipërfaqe totale 55.9 m². Nëse i përmbahemi VKM-së nr.113²² datë 20.01.1997, sipërfaqe banimi brenda një apartamenti tip, i referohet sipërfaqes totale të dhomave të gjumit dhe dhomës së ditës, ku dukshëm kuptohet se nuk plotësohej norma e strehimit²³ për 9-11 m²/person (metër katror për person). Pra, duket se subjekti i rivlerësimit nuk kishte hapësirë të mjaftueshme strehimi sipas këtij parashikimi ligjor.

Trupi gjykues në vlerësimin e kësaj situate ka konstatuar se: (i) subjekti ka deklaruar në mënyrë konsistente se ka kërkuar kredinë me kushte lehtësuese duke deklaruar se kishte një pasuri dhe se ka deklaruar, gjithashtu, edhe përbërjen e tij familjare; (ii) institucioni punëdhënës i subjektit i ka kërkuar Këshillit të Ministrave miratimin e vetëm dy emrave të tjerë ku përfshihet edhe subjekti; (iii) Komisioni nga hetimi nuk administroi ndonjë provë kundërshtuese që të provonte se subjekti kishte kërkuar specifikisht vlerën e kredisë, duke vlerësuar se subjekti ka aplikuar nëzbatim të pikës 2 të VKM-së nr.102/1999, ku shprehet vullneti i Këshillit Ministrave, që subjektet e parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, kanë të drejtë të kërkojnë strehim nga shteti.

Trupi gjykues, në çështjen objekt vlerësimi, ka mbajtur në konsideratë rrethanat tërësore faktike dhe ligjore, që nga momenti i aplikimit deri në përfitimin e saj. Kështu, përveç sa më sipër arsyetuar, trupi gjykues ka konstatuar se në momentin e përfitimit të kredisë, subjekti i është përmbajtur, parashikimeve ligjore të ndryshuara të aktit nr.102/1999 dhe specifikisht pikës 6 të këtij vendimi të ndryshuar, të Këshillit të Ministrave, ku është hequr togfjalëshi“...që nuk kanë banesë...” dhe “...për ato që duan shtesë sipërfaqe banimi” dhe është zëvendësuar me togfjalëshin “...në përputhje me kërkesën e paraqitur nga funksionari”, që sikurse është parashikuar, ndryshimi ligjor ka hequr kushtet/kriteret për vlerën e kreditimit në varësi të gjendjes së strehimit dhe e ka lënë (vlerën e kreditimit) në përputhje me vullnetin e funksionarit në kërkesën e paraqitur prej tij.

Në referencë sa më sipër, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktet se: (i) në analizë të praktikës së kredisë, përcjellë nga banka, ka rezultuar se kërkesa e subjektit pranë bankës

²² Pika 1, paragrafi 2, i tij;

²³ Referuar VKM-së nr.113, datë 20.01.1997, shkalla 9-11 m² për person, është vetëm për sipërfaqen e përgjithshme të dhomave të gjumit dhe dhomës së ndenjes. Një apartament me sipërfaqe totale prej 55.9 m², (1+1) , nuk mund të ketë 44 m² vetëm dhomën e gjumit dhe atë të ndenjes. Me një llogaritje të thjeshtë mbetet që 11.9 m² (55.9 m² – 44 m²) të jenë tualeti, ballkoni dhe korridor.

përmban referim kërkimi, pikërisht, bazën ligjore të ndryshimit të aktit nr. 102/1999; (ii) subjekti ka vendosur kolateral pasurinë e vëllait të tij, fakt ky i cili provon se pasuria që subjekti dispononte nuk përmbushte parametrat e duhur për të mundësuar marrjen e kredisë; (iii) akti i ekspertit vlerësues i administruar në praktikën e kredisë bankare, qartëson vlerën dhe të gjithë parametrat e përmbushur të pasurisë së vëllait të subjektit, z. N. L., të cilat i janë përshtatur politikës bankare dhe kanë bërë të mundur përfitimin e saj; (iv) relacioni shpjeguesi punonjësve të bankës konfirmon dokumentacionin rregullt ligjor, për përfitimin e kredisë.

Trupi gjykues hedh dritë edhe mbi një fakt tjetër të evidentuar gjatë hetimit administrativ, se subjekti në blerjen e kësaj pasurie përveç kredisë ka investuar edhe të ardhura nga pagat familjare sikurse ka deklaruar, por edhe të ardhurat e krijuara nga shitja e një pasurie (e trajtuar në vijim), që kanë pasur ai dhe familja e tij në Shkodër të cilën e kanë shitur. Pra, në përgjithësi provohet se të ardhurat kanë shkuar në të vetmin investim familjar, në një apartament banimi.

Në konkluzion, për sa është arsyetuar më sipër, trupi gjykues vlerëson se nuk ka rrethana që të penalizojnë subjektin në raport me përfitimin e kësaj kredie me kushte lehtësuese.

b. Për sa i përket konstatimit tjetër të Komisionit se dukej se subjekti në deklaratën periodike, dhe në deklaratën *Vetting* deklaronte si burim krijimi kredinë në shumën 5.000.000 lekë, ndërsa gjatë hetimit përveç kredisë pasqyron si burim edhe kursimet familjare nga paga, si dhe vlerën 600.000 lekë të përfituar nga shitja e pasurisë së trashëguar nga babai i tij, në Shkodër, trupi gjykues, në vlerësim të parashtrimeve të subjektit në prapësime, si dhe dokumentacionit të administruar, vlerëson fillimisht faktin se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi në deklaratën periodike për vitin 2003, shumën me të cilën është dakordësuar me shoqërinë ndërtimore “***” sh.p.k., për të blerë pasurinë objekt i këtij hetimi administrativ. Pra, subjekti ka deklaruar me saktësi shumën 48.346 USD. Ky deklarim në pikëpamje të parë merr rëndësi të veçantë, por njëkohësisht vlerësohet ndërthurur, edhe me parashikimet kontraktore në kontratën e sipërmarrjes. Fakti që subjekti nuk ka deklaruar shumën e mbetur për t’u shlyer pas kalimit të kredisë në favor të shoqërisë ndërtimore, nuk sjell asnjë pasojë në dëm të tij. Kjo, për arsye se u provua që subjektit i ishte dhënë e drejta të kompensonte shumën e mbetur në materiale ndërtimore apo pajisje (pra, t’i blinte vetë ato) për pasurinë, dhe, për pasojë, ka shpenzuar vit pas viti, deri në marrjen në dorëzim të apartamentit, shuma të cilat jo vetëm nuk kanë kaluar limitin e përcaktuar në deklaratën periodike për t’u deklaruar, por duke qenë se marrëdhëniet mes palëve kontraktore përfundonin me dorëzimin e apartamentit, vullneti i tyre i shprehur, shlyerja e shumës dhe finalizimi i kontratës së shitjes pa asnjë pretendim, tregojnë qartazi që nuk ka pasur veprime të qëllimshme nga subjekti për të mosdeklaruar shumën e mbetur. Pra, subjekti nuk ka shtuar burim të ri për krijimin e kësaj pasurie, thjesht ka deklaruar gjatë hetimit se çfarë të ardhurash ka përdorur për blerjen e materialeve/pajisjeve. Nën këto argumente, parë nën dritën e objektivitetit, nuk kemi të bëjmë me një burim të shtuar, por thjesht dhe vetëm me logjikë të përdorur nga subjekti, për sa kohë ka deklaruar shumën e plotë të pasurisë, pasi nuk ka paguar kështu në monedhë lekë apo dollarë, por ka investuar materiale.

c. Kjo logjikë arsyetimi gërshetohet edhe lidhur me konstatimin e radhës për të cilin subjektin iu kërkua të japë shpjegime, më konkretisht për mosdeklarimin në vitin 2003 të shumës së mbetur për porositjen e apartamentit, pas transferimit të kredisë në favor të shoqërisë ndërtimore. Dy janë momentet për të vlerësuar vërtetësinë e deklaramit. Së pari, sikurse u

qartësua më sipër, është deklaruar vlera e blerjes së pasurisë siç është pasqyruar në kontratën e sipërmarrjes, që do të thotë është pranuar e nënshkruar paraprakisht vullneti i palëve. Mandej, gëzimi qetësisht i pasurisë, i finalizuar me kontratën e shitjes, nënkupton përmbushjen e detyrimeve kontraktore të sipërmarrjes dhe që, për pasojë, qartazi vetëkuptohet se edhe kësti i mbetur është shlyer në formën dhe mënyrën e parashikuar, me dorëzimin e apartamentit. Gjithashtu, përsa kohë subjekti ka rezultuar në balancë pozitive, edhe ky është një rezultat tjetër në favor të tij, për të pranuar konkluzionin sepërmbushen të gjithë elementët faktikë e ligjorë që bëjnë të besueshëm qëndrimin e mbajtur nga subjekti në raport me këtë pasuri, si dhe bindin trupin gjykues se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi këtë pasuri dhe se gjendet në balancë pozitive, duke përmbushur kështu ligjshmërinë e krijimit të saj, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

2. Në lidhje me pasurinë e paluajtshme, apartament me sip.55.9 m², në Rr. “Q. S.”, p. *, shk. ***, ap. ***, Tiranë, blerë me privatizim me kontratën, datë 21.9.1993, regjistruar në ZVRPP-në Tiranë me certifikatën me nr.pasurie ***, z. k. ***. Burimi i deklaruar i krijimit: të ardhurat nga paga. Vlera: 4.203 lekë. Pjesa takuese: 50%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²⁴.**

2.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur:

- Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë (në deklarinë “Para fillimit të detyrës 2003”, apartamenti është deklaruar nga subjekti në vlerën 3.500.000 lekë. Në vlerësimin e pasurisë do të merret shuma e paguar në privatizim, si për deklarimin e parë, ashtu edhe në deklaratën Vetting).
- Është e paqartë paraqitja në procesin e rivlerësimit deklarates²⁵ së noterizuar, datë 30.9.1993, që i përket shtetasve A. dhe V. L. .

Faktet e konstatuara dhe hetimi i kryer nga Komisioni

2.2 Komisionit i ka rezultuar se këtë pasuri subjekti e deklaroi për herë të parë në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 me përshkrimin “apartament 1+1, në pronësi bashkëshortore dhe dy fëmijët”. Vlera: 3.500.000 lekë.

2.3 Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2019, informon se në emër të shtetasit Kujtim Sh. Luli figuron e regjistruar pasuria: apartament me sip.55.9 m², z. k. ***, vol. ***, fq. ***, në bashkëpronësi me shtetasen F.M.L. .

²⁴Certifikatë për vërtetim pronësie, datë 8.10.2007, për apartament me sip. 55.9 m², në Rr. “Q. S.”, p. ***, shk.***, k. ***, ap. ***, Tiranë, me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, në pronësi të Kujtim dhe F. Luli + kartelë pasurie. kontratë shitblerje e datës 21.9.1993, sipas së cilës Kujtim dhe F.Luli, blejnë nga Ndërmarrja Komunale Banesa Nr.1 Tiranë, apartament me sip. 55.9 m², në Rr. “Q. S.”, kundrejt vlefës 4.203 lekë + mandatarëtim nr. ***, datë 18.8.1993 + kontratë për privatizimin e banesës + certifikatë familjare + planimetri + planvendosje.

Deklaratë e datës 30.9.1993, sipas së cilës A. L. shpreh vullnetin e tij të lirë që të kalojë pronësinë e banesës së tij në L. ***, Rr. “Ll. B.” p. ***, shk. ***, ap. ***, në emrin e djalit V. L., banues në këtë adresë + vërtetimi i noterizimit nr. ***, datë 30.9.1993 (referojuni Aneksit nr. 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së).

²⁵Subjekti në prapsime ka depozituar vërtetim, datë 9.10.2020, lëshuar nga notere M.Sh., ku vërtetohet që dokumentacioni është bashkëlidhur gabimisht dhe i përket një praktike tjetër privatizimi.

2.4 Nga dokumentacioni i administruar kjo pasuri konfirmohet me kontratë shitblerje²⁶ nr. ***, datë 21.09.1993, me palë shitëse, Ndërmarrjen Komunale Banesa Nr.1 e përfaqësuar nga znj. M.Q. dhe palë blerëse shtetasit Kujtim Luli dhe F.L. .

2.4.i Në këtë kontratë citohet se Ndërmarrja Komunale Banesa Nr.1 ia shet këtë apartament blerësve legjitim kundrejt vleftës 5.253 lekë në të cilën përfshihet edhe vlefta e truallit prej 55.9 m² që përfaqëson 1.453 lekë. Kundërvlefta është përcaktuar nga Komisioni i Vlerësimit dhe është paguar menjëherë, gjë që e vërteton edhe mandatarëtimi nr. ***, datë 18.8.1993. Meqënëse likuidimi është bërë menjëherë zbritet 20% e vleftës dhe blerësi ka paguar 4.203 lekë.

2.5 UKT-jame shkresën nr. *** prot., datë 1.10.2019, informon se shtetasi Kujtim Luli identifikohet abonent me kontratë: Nr. *** për objektin me adresë Rr. “Q. S.”, Tiranë. Kontrata është me status aktiv në kategorinë e konsumatorëve familjarë me detyrime të palikuiduara me vlerë 108.2 lekë deri në datën 26.9.2019. Nga kontrolli në arkivën e UKT-së për kontratën me nr. *** disponohet regjistër i kontraktuesve të vitit 2003.

2.5.i Nga hetimi ka rezultuar se kontratat apo abonentët e tjerë të identifikuar në informacionin e dhënë, nuk i përkasin subjektit apo kësaj pasurie.

2.6 OSHEE-ja me shkresën nr. *** prot., datë 3.10.2019, informon se me gjeneralitetet Kujtim Luli, identifikohen abonentë me kontratë të furnizimit me energji elektrike me Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike. Kontrata në qytetin e Tiranës mban adresën Rr. “Q.S.”.

2.6.i Nga hetimi ka rezultuar se kontratat apo abonentët e tjerë të identifikuar në informacionin e dhënë, nuk i përkasin subjektit apo kësaj pasurie.

2.7 Nga analiza e dokumentacionit të depozituar, trupi gjykues konstatoi se pasuria është përfituar sipas ligjit nr.7652/1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe në tërësi të hetimit administrativ lidhur me mënyrën e përfitimit të saj nuk i kanë rezultuar problematika.

3. Në lidhje me pasuri të luajtshme, autoveturë tip “Mercedes-Benz”, tipi 250D, me naftë, vit prodhimi 1992, me targa *, në pronësi të subjektit deklarues, blerë me kontratë shitje nr. ***, datë 15.6.2009. Burimi i deklaruar i krijimit:të ardhura nga paga dhe shitja e automjetit tip “Opel Kadet” me targa ***, me kontratën nr. ***, datë 17.9.2009. Vlera: 600.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente²⁷.**

3.1 ILDKPKI-ja në raportin e saj është shprehur:

- DPSHTRr-ja konfirmon automjetin e deklaruar tip “Mercedes-Benz” me targa ***, në pronësi të subjektit Kujtim Luli. Gjithashtu, konfirmon edhe automjetin me targa ***, në pronësi të znj. F.L. .

²⁶Aneks 4/2 në dosjen e ILDKPKI-së, si dhe në dokumentacionin shoqërues të pyetësorit nr. 2, datë 3.2.2020, në dosjen e Komisionit.

²⁷Kontratë nr. ***, datë 15.6.2009, sipas së cilës subjekti Kujtim Luli blen automjet tip “Mercedes Benz 250D”; kontratë shitje nr. ***, datë 17.9.2009; vërtetim i njësisë me origjinalin, datë 27.1.2017 (referojuni Aneksit nr. 4/3, në dosjen e Komisionit).

- Referuar deklaratës së interesave private të vitit 2009, rezulton se subjekti Kujtim Luli, nuk ka deklaruar shitjen e automjetit tip “Opel Kadet” në emër të bashkëshortes F. L., transaksion i konfirmuar me kontratën e shitjes nr. ***, datë 17.9.2009.
- Për sa i përket deklaramit në deklaratën *Vetting*, se burim për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, përveç të ardhurave nga paga, janë edhe të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Opel Kadet”, nuk është i saktë, pasi ky i fundit është shitur 3 muaj pas blerjes së automjetit tip “Mercedes-Benz”.

Faktet e konstatuara dhe hetimi i kryer nga Komisioni

3.2 Komisionit i ka rezultuar se subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2009 me përshkrimin “*pasuri e luajtshme, një autoveturë Mercedes Benz, tipo 250D, naftë, vit prodhimi 1992. Targa ***, në pronësi të deklaruesit, blerë në vitin 2009. Burimi i krijimit të ardhura nga paga. Vlera: 600.000 lekë. Pjesa takuese: 50%*”.

3.3 Ky automjet konfirmohet me kontratë shitje²⁸ pasurie të luajtshme nr. ***, datë 15.6.2009, me palë shitëse K.P. dhe palë blerëse Kujtim Luli, në vlerën 600.000 lekë, shumë për të cilën palët deklarojnë se është shlyer jashtë zyrës noteriale.

3.4 DPSHTRr-ja me shkresën nr. *** prot., datë 1.10.2019, informon se z. Kujtim Luli ka të regjistruar mjetin me targa ***.

3.5 Komisioni hetoi mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie, nga ku i rezultoi si vijon:

3.5.i Në lidhje me të ardhurat nga pagat, Komisionit për punësimin e subjektit nuk i kanë rezultuar problematika, pasi ato janë të konfirmuara nga institucionet publike. Ndërsa, për bashkëshorten e subjektit ka rezultuar se ka qenë e punësuar si konsulente ligjore/juridike me kontratë shërbimi në shoqëritë “P***shi” sh.p.k., “P***o” sh.p.k., dhe “A. K.” sh.p.k.

3.5.ii Komisioni e ka pyetur subjektin²⁹ mbi të ardhurat e përfituara nga këto shërbime, mbi mënyrën e kryerjes së pagesës dhe, njëkohësisht, i ka kërkuar të depozitonte pagesën e detyrimeve tatimore mbi këto të ardhura.

3.5.ii.a Subjekti ka depozituar kontratën e shërbimit të lidhur mes bashkëshortes së tij dhe secilës shoqëri, si dhe ka sqaruar se për shërbimet sipas kontratave, mënyra e pagesës është kryer me mandatpagesë dhe secila shoqëri tregtare ka marrë përsipër detyrimin për të paguar tatimin në burim për shpërblimin e shërbimit. Për shoqërinë “A.K.” sh.p.k., ka depozituar edhe një faqe nga bilanci i vitit 2009 dhe 2011, më konkretisht, Pasqyrën Pasive dhe Kapitale, ku ka identifikuar në zërin Huat dhe parapagimet, Detyrime tatimore për Tatimin në Burim në shumën 76.500 lekë për vitin 2009 dhe 676.548 lekë për vitin 2011.

3.5.ii.b Komisioni i ka kërkuar informacion dhe dokumentacion edhe Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë për secilën shoqëri. Kjo drejtori në përgjigjen e saj në rrugë elektronike (datë 14.4.2020) ka informuar se nga verifikimi i rekordeve bankare për dy kompani (më konkretisht “P***o” sh.p.k. dhe “P***shi” sh.p.k.), nuk figuron të jetë paguar tatim në burim ndërsa për shoqërinë “A.K.” sh.p.k. ka pagesa tatimi në vitin 2014 për tatim mbi qira dhe tatim në burim, por ky vit nuk i korrespondon periudhës që ka punuar bashkëshortja e subjektit, pasi ajo

²⁸Aneks 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

²⁹Pyetësori nr.2, datë 3.2.2020.

ka punuar në vitet 2009 dhe 2011. Në vazhdim të informacionit të dërguar, kjo drejtori po në rrugë elektronike (e-mail i datës 24.6.2020) ka informuar se nga verifikimet e kryera në sistemin e tatimeve të tjera, jashtë sistemit informatik, për shoqërinë “P***shi” sh.p.k. rezultojnë pagesa të kryera nga administratori shoqërisë me përshkrimin “Tatim mbi të Ardhurat Personale, në llogarinë e Tatimeve të Tjera”.

3.5.ii.c Komisioni³⁰ i ka kërkuar subjektit të depozitojë dokumentacion justifikues që provon pagesën e tatimit në burim për të ardhurat e përfituara nga shoqëritë private. Subjekti ka depozituar dokumentacion nga drejtoritë e tatimeve, ku konfirmohen pagesa të kryera nga shoqëritë për tatimin në burim. Më konkretisht:

- Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj³¹ për shoqërinë “A.K.” sh.p.k., ka konfirmuar se janë likuiduar pagesat e tatimit në burim për vitin 2009 në shumën 76.500 lekë dhe për vitin 2011 në shumën 676.548 lekë. Nga përlllogaritjet e Komisionit, lidhur me të ardhurat *neto* të përfituara (për vitin 2009 shuma 500.000 lekë dhe për vitin 2011 shuma 500.000 lekë), tatimit që duhej të ishte paguar për vitin 2009 i korrespondon vlera 55.555 lekë dhe për vitin 2011 vlera 55.555 lekë. Pavarësisht se pagesat e kryera nga ana e shoqërisë janë në total dhe nuk mund të specifikohet nëse janë për bashkëshorten e subjektit, dukshëm vihet re se pagesat e kryera janë më të larta se sa ajo që i përket detyrimit për bashkëshorten e subjektit. Si rrjedhim, Komisioni i ka marrë ato në konsideratë.
- Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë³² për shoqërinë “P***shi” sh.p.k., ka konfirmuar pagesat nëdatën 3.4.2009 në shumën 33.796 lekë dhenëdatën 7.8.2013 në shumën 17.719 lekë. Meqënëse bashkëshortja e subjektit ka punuar gjatë vitit 2009, Komisioni në përlllogaritje ka marrë në konsideratë vetëm shumën e paguar në vitin 2009, prej 33.796 lekë. Kjo shumë i korrespondon vlerës *neto* të përfitur prej 304.164 lekë.
- Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës³³ për shoqërinë “P***o” sh.p.k., ka konfirmuar se pagesat e kryera për Tatim në Burim nga krijimi deri më 31.12.2014, në total janë në shumën 312.944 lekë. Nga përlllogaritjet e Komisionit, lidhur me të ardhurat *neto* të përfituara (për vitin 2009 shuma 500.000 lekë, për vitin 2011 shuma 500.000 lekë dhe për vitin 2012 shuma 300.000 lekë), tatimit që duhej të ishte paguar për vitin 2009 i korrespondon vlera 55.555 lekë, për vitin 2011 vlera 55.555 lekë dhe për vitin 2012 vlera 33.333 lekë. Pra, në total duhej të ishte paguar shuma 144.443 lekë. Pavarësisht se pagesat e kryera nga ana e shoqërisë, janë në total dhe nuk mund të specifikohet nëse janë për bashkëshorten e subjektit, dukshëm vihet re se pagesat e kryera janë më të larta se sa ajo që i përket detyrimit për bashkëshorten e subjektit. Si rrjedhim, Komisioni i ka marrë ato në konsideratë.

3.6 Në lidhje me burimin tjetër të deklaruar për krijimin e kësaj pasurie, të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Opel Kadet”, është vërejtur se ky burim krijimi është pasqyruar në deklaratën *Vetting*, pasi subjekti nuk e ka cituar si burim në deklaratën periodike të vitit 2009.

³⁰Me pyetësorin nr.6, datë 16.6.2020.

³¹Shkresë nr. *** prot., datë 25.6.2020, kthim përgjigjeshoqërisë “A.K.” sh.p.k.

³²Shkresë nr. *** prot., datë 25.6.2020, kthim përgjigje znj. F. L.(bashkëshortja e subjektit).

³³Shkresë nr. ***prot., datë 26.6.2020, kthim përgjigje shoqërisë “P***so” sh.p.k.

3.6.i Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se ky automjet është shitur sipas kontratës së shitjes³⁴ së pasurisë së luajtshme nr. ***, datë 17.9.2009.

3.6.ii Subjekti në deklaratën periodike të vitit 2009 nuk e ka deklaruar shitjen e këtij automjeti.

3.6.iii Është konstatuar se ky automjet i cili përdoret si burim krijimi, është shitur rreth 3 muaj pasi është blerë automjeti “Mercedes-Benz”.

3.7 Komisioni e ka pyetur³⁵ subjektin mbi këtë mospërputhje paër të cilën ka sqaruar se: *“Burimi i krijimit të shumës për blerjen e makinës Benz janë të ardhurat e deklaruar nga paga e subjektit të rivlerësimit, paga e bashkëshortes dhe kursimet nga të ardhurat familjare vit pas viti, si dhe të ardhurat e rimborsuara pjesërisht në vlerën 140.000 lekë nga shitja e makinës Opel pas 3 muajsh të të njëjtit vit kalendarik (2009) objekt vetëdeklarimi. Për këto arsye, ky fakt i qartësuar në lidhje me deklaratën për vitin 2009 (në materialin ‘Shpjegime shtesë’, datë 28.3.2016 dhe në procesverbalin datë 18.3.2016 ‘Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive’ mbajtur nga inspektori përkatës i ILDKPKI), evidenton burimin e të ardhurave për blerjen e makinës Benz në atë vit, që është evidentuar në vetëdeklarimin e pasurisë në procesin e rivlerësimit kalimtar, dorëzuar më 27.1.2017 në ILDKPKI.”*

3.8 Nga korrespondenca e mbajtur mes Komisionit dhe ILDKPKI-së³⁶, për të administruar procesverbalin e datës 18.3.2016, në praktikën përkatëse është konstatuar se subjekti ka dërguar “shpjegime shtesë” në ILDKPKI, në datën 28.3.2015 (dukshëm është lapsus i viti 2015, pasi i korrespondon vitit 2016, në vështrim të numrit të protokollit të ILDKPKI-së që daton më 8.4.2016), ku ka sqaruar se: *“Burimi për likuidimin e shpenzimeve në vitet 2005, 2008 dhe 2009 për blerjen e makinave janë të ardhurat e deklaruar nga paga ime dhe e bashkëshortes dhe kursimet nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes vit pas viti në periudhën e viteve 2003-2005, 2007 dhe 2008, të mbuluara/rimborsuara më pas nga të ardhurat nga shitja e makinës Opel në vitin 2009 dhe Renault në vitin 2010-2011”.*

3.8.i Subjekti me sqarimin e tij ka orientuar qartazi destinacionin e të ardhurave nga shitja e automjetit Opel të cilat nuk kanë shërbyer si burim për blerjen e pasurisë automjet tip “Mercedes-Benz”, por ato kanë zëvendësuar atë shumë të kursimeve që është përdorur për këtë investim.

3.9 Komisioni kreu analizën financiare vjetore jo në momentin e blerjes së pasurisë sepse subjekti ka pasur një vit më parë gjendje *cash* të konsiderueshme. Gjendjen *cash*, Komisioni e ka trajtuar te paragrafi “Gjetjet e tjera” (shih në këtë titull, pikën nr.20).

3.10 Gjatë hetimit ka rezultuar se bashkëshortja e subjektit ka pasur një depozitë në shumën 6.000 euro në llogari dyemërore me djalin K. L. në “Intesa Sanpaolo Bankën”³⁷.

3.11 Nga analiza financiare e kryer nga Njësia e shërbimit Ligjor, për këtë pasuri, trupi gjykues konstatoi se subjekti ka pasur mundësi financiare për të investuar në këtë pasuri të luajtshme si dhe për të përballuar të gjitha shpenzimet e tjera familjare.

³⁴Aneks 4/3 në dosjen e ILDKPKI-së.

³⁵Pyetësi nr. 2 datë 3.2.2020.

³⁶Shkresë nr. ***prot., datë 30.3.2020.

³⁷Shkresë nr. ***prot., datë 9.10.2019.

3.12 Ndërsa, nga analiza e dokumentacionit të administruar në tërësi për këtë pasuri, Komisionit i rezultoi se:(a) subjekti nuk kishte deklaruar depozitën prej 6.000 euro në deklaratën periodike për vitin 2009, në “Intesa Sanpaolo Bankën” në llogarinë dyemërore të bashkëshortes dhe djalit, pra, F. dhe K. L.;(b) dukej se subjekti nuk kishte deklaruar në vitin 2009 shitjen e automjetit tip “Opel Kadet” në shumën 140.000 lekë; dhe se (c) dukej se subjekti në deklaratën e vitit 2009, deklaronte të ardhura nga pagat, në deklaratën *Vetting* shton edhe të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Opel Kadet” , ndërsa gjatë hetimit administrativ shton kursimet nga të ardhurat familjare vit pas viti, si dhe të ardhurat e rimbursuara pjesërisht në vlerën 140.000 lekë nga shitja e automjetit tip “Opel Kadet” dhe,për pasojë, i kërkoi subjektit të japë shpjegime³⁸.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera, në parashtrimet e tij ka sqaruar se:

- a. *Me mandatin, datë 15.03.2010, bashkëshortja ka tërhequr shumën 6.044,92 euro, me qëllimin e deklaruar “shpenzime për shkollimin e djalit” të pasqyruar në statementin e “Intesa Sanpaolo Bankën” dhe njoftim/mandat “debi” (mandapagesa) datë 15.3.2010. Shuma 6.044,92 euro e tërhequr nga banka më 15.3.2010, para deklarimit periodik vjetor 2009 (datë 25.3.2010) është përfshirë në shumën 11.523 USD në pagesën për shkollimin e djalit K., e kryer me transfertën, datë 2.8.2010, sipas faturës, datë 21.7.2010, të W***, pagesë e deklaruar në deklaratën periodike vjetore për vitin 2010.*
- b. *Në deklaratën periodike për vitin 2009,kam harruar të deklaroj shitjen e automjetit tip ‘Opel Kadet’ në pronësi të bashkëshortes, për shkak të vlerës dhe neglizhencës nisur edhe nga fakti se ky automjet nuk përdorej prej saj. Fakti i mosdeklarimit është konstatuar dhe përshkruar me të drejtë në materialin ‘Rezultati i hetimit administrative’, ndërsa reagimi im për mosdeklarimin e tij është pasqyruar dhe në procesverbalin datë 18.3.2016 ‘Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurisë’ mbajtur nga inspektori i ILDKPKI-së dhe në shpjegimet shtesë, datë 28.3.2016, ku kam paraqitur dhe dokumentacionin provues (kontratat e blerjes dhe shitjes së tij, etj.).*
- c. *Në lidhje me burimin e krijimit të shumës për blerjen e automjetit tip “Mercedes-Benz” në vitin 2009, ashtu siç kam deklaruar janë të ardhurat nga paga e ime, paga e bashkëshortes dhe kursimet nga të ardhurat familjare vit pas viti, ndërsa të ardhurat e rimbursuara pjesërisht pas 3 muajsh të të njëjtit vit kalendarik (2009) në vlerën 14.000 lekë nga shitja e automjetit tip “Opel Kadet”, ashtu siç trajtohet në materialin e ‘rezultatit të hetimit administrativ’, kjo e ardhur ka zëvendësuar shumën e kursimeve që kemi përdorur për blerjen e këtij mjeti.*

³⁸Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në lidhje me vërtetësinë dhe saktësinë e deklaramëve të subjektit në raport me dokumentacionin e administruar, duke konsideruar edhe shpjegimet³⁹ e tij në ILDKPKI, arsyeton si vijon:

a. Për sa i përket konstatimit të mosdeklarimit nga subjekti, në vitin 2009, të depozitës dyemërore F. & K. L. në “Intesa Sanpaolo Bankën”, në vlerën 6.000 euro, janë disa rrethana të cilat argumentohen dhe vlerësohen në raport me këtë mosdeklarim. Është fakt i pakontestueshëm që depozita është lehtësisht e verifikueshme, sepse është gjurmë bankare dhe ajo që kërkon vëmendje në këtë rast është ligjërimi i krijimit të saj. Në këtë drejtim është provuar nga analiza financiare se subjekti ka pasur mundësi të krijojë këtë depozitë.

Më konkretisht, nga aktet e administruara konstatohet se në datën 24.9.2009 është investuar nga llogaria dyemërore në “Intesa Sanpaolo Bankën”, shuma 6.000 euro në depozit, shumë e cila është maturuar në datën 15.3.2010 në vlerën 6.074,60 euro. Po në këtë datë (përpara dorëzimit të deklaratës periodike), bashkëshortja e subjektit, znj. F. L., ka tërhequr shumën 6.044,92 euro.

Është vërejtur që subjekti në llogarinë e tij bankare në BKT, ka kryer disa derdhje *cash* gjatë vitit 2010 për të plotësuar pagesën e vitit 2010 për shkollimin e djalit K. L. . Po ashtu, edhe deklaramet periodike të subjektit në lidhje me pagesat e shkollimit por edhe hetimi i kryer nga Komisioni konfirmojnë këtë fakt.

Pavarësisht se subjekti nuk i ka deklaruar saktë likuiditetet e tij, sepse deklarimi periodik përfshin periudhën 1 janar - 31 dhjetor dhe jo deri në momentin e dorëzimit të deklaratës, për sa kohë që kjo depozitë është e verifikueshme në bankë, por dhe e krijuar me burime të ligjshme nga të ardhurat nga pagat, se tërheqja e saj është përdorur për pagesën e shkollës së djalit K. L. dhe se kjo pagesë është deklaruar nga subjekti në deklaratën e vitit 2010, trupi gjykues e shikon këtë mosdeklarim thjesht si një pasaktësi që nuk përbën problematikë në tërësinë e vendimmarrjes.

Në vijim të këtij arsytimi, një rëndësi të veçantë merr fakti që depozita ka qenë dyemërore dhe pikërisht me djalin e subjektit K. L. për të cilin edhe kryheshin investimet shkollore. Pra, ajo që vetëkuptohet është fakti që në çdo rast apo eventualitet secili prej disponuesve të shumës mund të kryente veprime. Një argument tjetër është fakti që subjekti jo vetëm në këtë rast por në të gjithë deklaramet vjetore prej kohës së investimit shkollor për djemtë e tij ka qenë konsistent në deklaramet e dërgesave të kryera, pra, thënë ndryshe, ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi të gjithë shumat e investuara për studimin e tyre jashtë vendit, shuma të cilat kanë rakorduar me veprimet financiare edhe në shtetin pritës. Në këtë kontekst të gjithë argumentet e renditur konkurojnë në raport me të vetmin konstatim se subjekti nuk e ka deklaruar këtë shumë në vitin 2009.

b. Në vijim të arsytimit, trupi gjykues analizon edhe lidhur me destinacionin e shumës 140.000 lekë, si e ardhur e krijuar nga shitja e automjetit tip “Opel Kadet” të bashkëshortes së subjektit. Ky arsyetim pavarësisht vlerës së ulët merr rëndësinë e tij duke qenë se subjekti e ka pasqyruar

³⁹Në procesverbalin datë 18.3.2016, “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramit të pasurive” mbajtur nga inspektori përkatës i ILDKPKI-së.

në deklaratën *Vetting*, ndryshe nga fakti që nuk e kishte deklaruar në deklaratën për vitin 2009. Edhe në këtë rast, trupi gjykues çmon se përsa kohë shitja e automjetit provohet me kontratën përkatëse nr***, datë 17.9.2009, apo edhe për sa kohë subjekti ka deklaruar dhe qartësuar destinacionin e shumës në procesverbalin përkatës të mbajtur në vitin 2016 në ILDKPKI, pra, më parë përmbushjes së detyrimit për të plotësuar deklaratën *Vetting*, bëhet bindës qëndrimi i tij se shuma ka shkuar pikërisht në favor të zëvendësimit të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë së luajtshme automjet “Mercedes-Benz”, tipi 250D, objekt i këtij hetimi administrativ.

Trupi gjykues, pa dashur të ripërsëritet, vlerëson deklaratimet e subjektit, para deklaratës *Vetting*, gjatë procesverbalit të mbajtur nga inspektori i ILDKPKI-së në datë 18.3.2016 “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurisë” dhe në “Shpjegimet shtesë”, datë 28.3.2016, ku ka paraqitur edhe dokumentacionin provues (kontratat e blerjes dhe shitjes së tij). Gjithashtu, konstatohet se të njëjtin qëndrim subjekti ka mbajtur edhe gjatë hetimit administrativ, pa e ndryshuar deklaratimin e tij.

Po ashtu, përsa kohë subjekti ka rezultuar në balancë pozitive në blerjen e automjetit “Mercedes-Benz”, tipi 250D, përpara shitjes së automjetit “*Opel Kadet*” që dispononte më parë, nuk hidhet asnjë hije dyshimi për vërtetësinë e deklaratimeve, por thjesht dhe vetëm kuptohet që mosdeklarimi në vitin 2009 i destinuar për t’u shtuar në kursimet e tjera nuk ka marrë vëmendjen e duhur në kohë.

Gjithashtu, trupi gjykues qartëson se shuma prej 140.000 lekësh e përfituar nga shitja e automjetit është një e ardhur e shtuar në totalin e të ardhurave të familjes së subjektit, fakt ky që qëndron në favor të subjektit, pasi nuk është një shpenzim i kryer dhe i padeklaruar gjë që do ta rëndonte situatën financiare të tij.

c. Njëkohësisht, përsa i përket burimit të deklaruar për krijimin e shumës për blerjen e automjetit, subjekti i qëndron deklarimit se janë të ardhurat nga paga e tij, paga e bashkëshortes dhe kursimet nga të ardhurat familjare vit pas viti, ndërsa të ardhurat e rimbursuara pjesërisht pas 3 muajsh të të njëjtit vit kalendarik (2009) në vlerën 140.000 lekë nga shitja e automjetit tip “*Opel Kadet*”, kanë zëvendësuar shumën e kursimeve që ka përdorur për blerjen e këtij mjeti.

Në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor, si në momentin e investimit (ku nuk i ka përfshirë të ardhurat nga shitja e automjetit “*Opel Kadet*”), por edhe në atë të vitit kalendarik nuk i kanë rezultuar problematika, pasi subjekti ka pasur mundësi financiare të investoj në këtë pasuri.

d. Trupi gjykues, paralelisht me arsyetimin e bërë më sipër për depozitën dyemërore në shumën 6000 euro, arsyeton edhe lidhur me depozitën dyemërore L. B. & F. L. në “Intesa Sanpaolo Bankën”, megjithëse kjo depozitë nuk ka pasur asnjë rol në veprime financiare të subjektit të rivlerësimit apo edhe për faktin se për të nuk kanë rezultuar dyshime mbi krijimin e saj. Nga hetimi ka rezultuar se në datën 18.8.2010, L. B. (motra e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit), ka depozituar shumën 15.000 euro me përshkrimin “të ardhurat e vajzës të tërhequra nga Raiffeisen Bank”. Kjo shumë, po në këtë datë, është investuar në depozitë dhe me të nuk është kryer më asnjë lloj veprimi deri më 9.9.2014, ku më pas motra e bashkëshortes

së subjektit, znj. L.B., shumën e investuar sëbashku me interesat e përfituara e ka transferuar në llogarinë e saj personale. Fakti që me depozitën nuk është kryer asnjë lloj veprimi nga bashkëshortja e subjektit, dhe se depozita ka pasur një përshkrim të qartë të krijimit të saj, në kohë reale, pra, kur është depozituar, duke u cituar se nga vinte shuma, atëherë në interes të hetimit ka qenë vetëm arsyeja e pasqyrimin të emrit të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Përgjigja e subjektit⁴⁰ pasi është pyetur mbi këtë llogari dyemërore se: *“...llogaria në bankën ‘Intesa Sanpaolo Bank’ dhe burimi i krijimit të shumës 15.000 euro janë nga të ardhurat familjare (të vajzës) të L. B. . Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 14 korrik 2012 të bërë nga L.B., ajo ka shprehur gadishmëri për mbështetje financiare për shkollimin e djalit E. L., si garanci për dokumentacionin e nevojshëm në aplikimin për shkollë. Kjo ka qenë edhe arsyeja që depozita është bërë dyemërore, duke e përfshirë formalisht dhe emrin e bashkëshortes F.L. në atë llogari bankare e cila nuk ka patur asnjë tagër për të bërë veprime apo tërheqje shume në këtë llogari...Për këtë fakt jam pyetur dhe kam dhënë shpjegime të administruara në procesverbalin datë 18.3.2016 “Mbi shpjegimet e subjektit të deklaramin të pasurisë” mbajtur nga inspektori përkatës i ILDKPKI-së”, e bën të besueshëm dhe nuk lë vend për dyshime mbi autorësinë e kësaj shume, krijimin dhe destinacionin e saj, për më tepër kur u provua raporti i bashkëshortes së subjektit me këtë shumë, për të cilën ka qenë e kushtëzuar në përdorimin e saj. Nga ana tjetër fakt i pakontestuar është edhe lëshimi i deklaratës⁴¹ noteriale në kohë reale, nga motra e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit për të qenë garantore në bërjen e praktikës shkollore me qëllim miratimin dhe vijimin e studimeve. Pra, thënë ndryshe shuma (dokumenti që pasqyron atë) destinohet në favor të përgatitjes së dokumentacionit administrativ shkollor ku kërkohet edhe vlera e caktuar me të cilën studenti garanton aplikimin e tij për të rezultuar i suksesshëm, ndërsa vijueshmëria e pagesave është çështje vlerësimi nëse kryhet menjëherë apo në periudha të ndryshme me këste të shpërndara.*

Në përfundim, faktet që: (i) burimi i krijimit të shumës së depozituar është cituar në momentin që është kryer veprimi; (ii) bashkëshortja e subjektit nuk rezulton të ketë kryer asnjë veprim në këtë llogari (derdhje, tërheqje apo transferim fondi); (iii) deklarata noteriale e vitit 2012 (madje në gjuhë të huaj), e motrës së bashkëshortes së subjektit, ku shpreh gadishmërinë e saj për shkollimin e nipit, E. L. në SHBA; si dhe (iv) transferimi i fondeve në vitin 2014 në llogarinë e saj personale (L. B.), i krijojnë bindjen trupit gjykues se deklarimi i subjektit është i vërtetë/bindës jo vetëm gjatë hetimit administrativ, por edhe në deklaramin e bërë në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në vitin 2016.

e. Trupi gjykues megjithëse ka qartësuar më sipër mbi ligjshmërinë e të ardhurave të bashkëshortes së subjektit nga punësimet e saj në tri shoqëritë punëdhënëse, përkatësisht “A. K.” sh.p.k., “P***shi” sh.p.k. dhe “P***s” sh.p.k., dhe pavarësisht se nuk i kanë rezultuar problematika, për vetë faktin se të ardhurat e krijuara kanë impaktuar burime krijimi me destinacione të ndryshme si pagesa shkollimi të dy djemve të subjektit, etj., i kushton vëmendje ezaurimit të kësaj çështje edhe me disa faktorë të rëndësishëm. Në këtë drejtim, përveçse nuk rezultuan problematika lidhur me pagesat e tatimit nga punëdhënësit në favor të bashkëshortes së subjektit, pra, u provua ligjërimi i të ardhurave dhe, për pasojë, ato janë përlllogaritur në analizan financiare, thekson se nga analiza e kontratave të shërbimit, rezultoi se ato ishin me

⁴⁰ Në pyetësorin nr.3, datë 18.3.2020.

⁴¹Nr. *** rep., datë 14.7.2012.

afate kohore në përputhje me legjislacionin civil dhe që, për pasojë, nuk i nënshtroheshin veprimeve noteriale. Po ashtu, përsa kohë në objektin e tyre cilësohej se bashkëshortja e subjektit për llogari të shoqërive jepte konsulenca dhe merrej kryesisht me anën administrative të tyre, me të drejtë mes palëve kontraktore është ndërtuar marrëdhënia e shërbimit. Kontrata e shërbimit ligjëron të ardhurat e përfituara përmes pagesës së tatimit në burim, ndërsa kontrata individuale e punësimit ose ajo kolektive, ligjërojnë të ardhurat përmes pagesës së detyrimeve për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimit mbi të ardhurat personale. Në rastin konkret, përputhet pagesa e detyrimit tatimor për kontratën përkatëse sipas legjislacionit⁴² të fushës. Po ashtu, trupi gjykues, lidhur me pagesat e tatimit në burim nga ana e secilës shoqëri ku pasqyrohet një shumë e vetme totale dhe nuk identifikohet se për cilën kontratë shërbimi është paguar tatimi, çmon se në këtë pagesë përfshihet edhe bashkëshortja e subjektit për sa kohë që këto pagesa janë në vlera më të larta se sa detyrimi tatimor që i përket kontratës së shërbimit të bashkëshortes së subjektit, si dhe përsa kohë nuk u provua e kundërta, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë.

f. Trupi gjykues, duke ndjekur rrjedhën e arsytimit të provueshmërisë së të ardhurave të përfituara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit nga punësimi në tri shoqëritë përkatëse të pasqyruara më sipër, arsyeton mbi një çështje të diskutuar në seancën dëgjimore me subjektin lidhur me faktin nëse bashkëshortja e subjektit duhet të kishte punuar përgjatë kohës që ajo po ndiqte një proces gjyqësor për shkak të pozicionit që kishte ushtruar dhe se vendi i saj ishte suprimuar dhe në këtë këndvështrim, lindte pyetja, a duhet të trajtoheshin të ardhurat e përfituara si të ligjshme.

Lidhur me këtë situatë, subjekti në seancën dëgjimore por edhe në shpjegimet e dërguara⁴³, pas saj, ka sqaruar se: *“Padia e ngritur nga bashkëshortja e shqyrtuar në Gjykatën e Lartë me vendimin nr.288, datë 26.5.2011, ka për objekt: ‘Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhërit të drejtoreshës së Shkollës së Magjistraturës; konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Këshillit të Lartë të Drejtësisë; dhe shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga aktet e pavlefshme’ dhe jo kthimin në punë apo çështje që lidhen me statusin e gjyqtarit, të përdorur si shkak për pyetjen intimiduese lidhur me ligjshmërinë e të ardhurave të bashkëshortes. Për më tepër, edhe nëse objekti i kësaj padie do të ishte kthimi në punë dhe përfitimi i statusit të gjyqtarit, me vendimin të Këshillit të Lartë të Drejtësisë me nr.***, datë 3.2.2006, që ka vendosur ‘Konstatimin e suprimimit të vendit të punës të zv/drejtorit të Shkollës së Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë, si rezultat i hyrjes në fuqi të ligjit nr.9914, datë 20.05.2005’, qartësoj se statusi i gjyqtarit për shkak të funksionit si zv/drejtoreshë në Shkollën e Magjistraturës ka përfunduar ditën që i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës në këtë funksion. Me mbarimin e këtij statusi të gjyqtarit për shkak të suprimimit të funksionit dhe largimit nga detyra, nuk ka asnjë papajtueshmëri për bashkëshorten që do të përbënte pengesë ligjore për ushtrimin e profesionit të avokatit apo të çdo veprimtarie punësimi tjetër të ligjshme.*

Trupi gjykues, lidhur me situatën e mësipërme, paraprakisht verifikoi vendimin gjyqësor, nga ku përgjithësisht i rezultoi si vijon:

⁴²Ligji nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar” dhe Udhëzimi nr. 5 datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar”.

⁴³Me e-mail datë 18.11.2020.

Procesi gjyqësor ishte iniciuar nga znj.F.L., me objekt shqyrtimi, *shfuqizimi, si i papajtueshëm me Kushtetutën, i vendimit civil nr. ***, datë 15.5.2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; i vendimit nr. ***, datë 17.9.2007, të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe i vendimit nr. 288, datë 26.5.2011, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, me palë të interesuara KLD dhe Shkolla e Magjistraturës.*

Sipas vendimit kushtetues⁴⁴ (nr. 96, datë 20.9.2013) ku lexohet qartazi ecuria prej fillesës së procesit gjyqësor rezulton se kërkesja (me këtë cilësi në Gjykatën Kushtetuese) F.L., ka ushtruar detyrën si zëvendësdrejtores e Shkollës së Magjistraturës, pas emërimit në këtë detyrë nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. ***, datë 4.9.1999. Ky emërim është bërë në përputhje me nenin 7, paragrafi 7, të ligjit nr. 8136, datë 31.7.1996, “Për Shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë”,parashikohej se: “Zëvendësdrejtori emërohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë me propozim të bordit të drejtimit”.

Rezulton se në datën 16.9.2005, kërkesja është njoftuar për suprimimin e vendit të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, për shkak të ndryshimit të ligjit organik të këtij institucioni.

Sipas ligjit të ndryshuar, nr. 9414, datë 20.5.2005, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8136, datë 31.07.1996, ‘Për shkollën e Magjistraturës së Republikës së Shqipërisë’, veç të tjerash, është suprimuar vendi i punës së zëvendësdrejtorit në Shkollën e Magjistraturës të Republikës së Shqipërisë.

Znj. F.L., pas ushtrimit dhe ndjekjes së rrugës administrative, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë me padi me objekt “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të urdhrit të Drejtores së Shkollës së Magjistraturës dhe shpërblimin e dëmit të rezultuar nga ky urdhër”, si dhe “Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. ***, datë 3.2.2006, të KLD-së”.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë, ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë mbi ankimin e znj. F. L., me vendimin nr. ***, datë 17.9.2007, ka vendosur ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë. Mbi rekursin e Znj. Luli, Gjykata e Lartë me vendimin nr. ***, datë 26.5.2011, ka vendosur “Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 17.9.2007, të Gjykatës së Apelit Tiranë”.

Nisur nga vendimmarrjet e mësipërme, trupi gjykes ka konstatuar dhe vlerësuar se:

Vendimi është bërë i ekzekutueshëm prej përfundimit të procesit në Gjykatën e Apelit, pavarësisht rekursit të adresuar nga pala, përse kohë ndaj tij/vendimit, Gjykata e Lartë nuk vendos pezullimin e vendimit.

Vendimi i Gjykatës Apelit ka qenë në disfavor të znj. F.L., çka i ka dhënë asaj së paku prej këtij momenti (megjithëse në asnjë parashikim ligjor nuk ekziston ndonjë ndalesë e mundshme për të punuar përgjatë kohës së ndjekjes së proceseve gjyqësore, duke mbajtur këtu në vëmendje objektin e shqyrtimit gjyqësor, *konstatim pavlefshmërie...*) të gjithë të drejtën për të punuar dhe ushtruar të drejtat e saj në kuadër të të drejtave dhe lirive të njeriut.

⁴⁴ http://www.gjk.gov.al/web/Lista_e_Vendimeve_92_1.php

Në asnjë resht të vendimeve gjyqësore, nuk arsyetohet për ruajtje të statusit të magjistratit, për të gjykuar se kjo do ta kushtëzonte paditësen të punonte deri në përfundimin e procesit gjyqësor.

Gjithsesi, nga verifikimi i deklaratave periodike të subjektit të rivlerësimit, rezulton se në vitet 2006 dhe 2007 (pra, kohë në të cilën janë zhvilluar proceset gjyqësore deri në Gjykatën e Apelit) bashkëshortja F.L. nuk ka sigurur të ardhura nga punësimet. Po ashtu edhe në dosje nuk është administruar ndonjë provë që të kundërshtojë këtë fakt.

Nga aktet rezulton se znj. F. L. është regjistruar si Person Fizik në vitin 2008 dhe për gjithë periudhën njëvjeçare ka siguruar të ardhura të cilat janë vlerësuar në analizën financiare. Çdo punësim tjetër ka vijuar në vitin 2011 e në vijim me kompanitë punëdhënëse të lartpërmendura.

Në të tilla kushte, trupi gjykues arrin në konkluzion se bashkëshortja e subjektit ka gëzuar të drejtën e saj për të punuar së paku prej kohës së vendimmarrjes nga Gjykata e Apelit (kur vendimi quhet i formës së prerë), çka do të thotë se të ardhurat e saj edhe në këtë aspekt janë të ligjëruara dhe, për pasojë, përdorimi i tyre ligjëron edhe pasuritë në çdo rast.

4. Në lidhje me të ardhurat nga shitja e shtëpisë në Shkodër – trashëgimi e prindërve në bashkëpronësi me 1/5 – me kontratën premtim shitje nr. ***, datë 24.11.2001, me sipërfaqe të përafërt trualli 200 m² dhe sipërfaqe të ndërtesës 79 m², kundrejt çmimit 3.200.000 lekë. Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 24.9.2011 është bërë shitja përfundimtare e pronës në bashkëpronësi me 1/5 me nr.pasurie ***, z. k. ***, Shkodër, pasuri truall dhe ndërtesë me sip.trualli 277.28 m², nga të cilat 94 m² janë ndërtesë, kundrejt çmimit 6.409.200 lekë. Shuma 600.000 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁴⁵.

4.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, konstaton:

- pasuria truall + ndërtesë është shitur në shumën 3.200.000 lekë në vitin 2001 (me kontratë shitje me rezervë shtetasit Sh. I.), e konfirmuar pagesa totale në vitin 2006 me anë të një deklaratë noteriale dhe subjekti si 1/5 pjesë ka deklaruar se përfiton 600.000 lekë;
- mbetet e paqartë rishitja e pasurisë truall me sip. 277.28 m², nga e cila 94 m² ndërtesë, në Shkodër, në z. k. ***, në vitin 2011, djemve të shtetasit Sh. I., me çmimin prej 6.409.200 lekësh. Certifikata e pronësisë e datës 6.1.2011 është në emër të subjektit dhe bashkëpronarëve të tjerë. Në datën 7.9.2011 u bë rivlerësimi i pasurisë me çmimin 6.409.200 lekë.

4.2 Nga analizimi i dokumentacionit, Komisioni konstatoi se kjo pasuri është trashëguar nga prindërit e subjektit të rivlerësimit sipas vendimit nr. ***, datë 30.7.1996, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, me objekt “Çelje Dëshmi Trashëgimie”, për llogari të pesë trashëgimtarëve ligjorë, ku ndër të tjerë në cilësinë e trashëgimtarit është edhe subjekti i rivlerësimit në 1/5 pjesë takuese të çdo detyrimi e të ardhure nga trashëgimlënësit.

⁴⁵Akt shitblerje nr. ***, datë 24.9.2011 + certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 6.1.2011 + hartë treguese + kartelë pasurie + dokumente identiteti të palëve; kontratë shitje me rezervë nr. ***, datë 24.11.2001; deklaratë noteriale nr. ***, datë 31.8.2006; vërtetim njësimi me origjinalin nr. ***, datë 22.1.2017; vërtetim i njësisë së kopjes me origjinalin nr. ***rep., datë 27.1.2017 (referojuni Aneksit nr. 4/5 në dosjen e ILDKPKI-së). Gjithashtu, ky dokumentacion është depozituar nga subjekti edhe me pyetësin nr. 2, datë 3.2.2020, në dosjen e Komisionit.

4.3 Më tej u konstatua se me kontratën e shitjes me rezervë nr. ***, datë 24.11.2001, trashëgimtarët, këtë pasuri me origjinë në notën e transkriptimit datë 12.4.1946, si dhe atë të vitit 1962, ia kanë shitur shtetasit Sh. I. në shumën 3.200.000 lekë, me kushtin që me nënshkrimin e kontratës të shlyhej shuma prej 700.000 lekësh dhe pjesa e mbetur të shlyhej me këste duke filluar nga viti i dytë në 700.000 lekë dhe deri në vitin 2006 nga 600.000 lekë deri në datën 25 janar për çdo fundvit.

4.4 Me deklaratën noteriale datë 31.8.2006, depozituar nga subjekti, konstatohet se shitësit e pasurisë ku përfshihet edhe subjekti kanë deklaruar shlyerjen e të gjitha pagesave të kryera në favor të tyre deri në datën 31.8.2006. Po në këtë deklaratë është qartësuar edhe aplikimi i bërë në kohë (datë 9.3.2006) për të bërë tjetërsimin e pasurisë në favor të blerësve, si dhe përgjigjja e dhënë nga ZVRPP-ja Shkodër, ku është njoftuar se Ministria e Drejtësisë kishte pezulluar procedurat e regjistrimit për të gjitha pasuritë që i nënshtroheshin nenit 24/b të ligjit nr.7843, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Po në këtë deklaratë, deklaruesit kanë deklaruar kalimin faktik të pasurisë dhe se shitësit i kanë deklaruar blerësve se mund të përdorin këtë deklaratë së bashku me të gjitha dokumentet për të vërtetuar pronësinë praktike mbi shtëpinë dhe truallin dhe se mund të kryenin çdo veprimi administrativ dhe ligjor në interes të tyre deri në lidhjen e kontratës së shitblerjes.

4.5 Me vendimin nr. ***, datë 1.10.2010, të ZVRPP-së Shkodër, bazuar në nenin 24/b të ligjit nr. 7843/1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, është vendosur edhe regjistrimi i titullit të pronësisë në emër të trashëgimtarëve ligjorë të pasurisë me sip. 277.28 m², nga të cilat janë konfirmuar 94 m² ndërtesë.

4.6 Në zbatim të këtij vendimi, në datën 6.1.2011, është lëshuar edhe certifikata për vërtetim pronësie në emër të pesë trashëgimtarëve të trashëgimlënësit Sh. L. (i ndjeri, babai i subjektit të rivlerësimit), si dhe kartela e pasurisë, tek e cila identifikohet edhe fakti i bërjes së RVP-së në shumën 6.409.200 lekë.

4.7 Me ekzistencën e certifikatës së pasurisë është realizuar edhe shitja përfundimtare e pasurisë me kontratën e shitjes nr. ***, datë 24.9.2011, duke u cituar në të shuma e përcaktuar sipas RVP-së.

4.8 Subjekti i rivlerësimit është pyetur⁴⁶ në lidhje me mospërputhjen e shumës së konstatuar krahasimisht me atë të përcaktuar në kontratën e shitjes me rezervë dhe për këtë ka qartësuar se përsa kohë pasuria nuk ka qenë e regjistruar nuk mund të realizohej kontratë përfundimtare. Njëkohësisht subjekti i ka qëndruar shumës së cituar në kontratën e shitjes me rezervë, si dhe vlerës së përfituar sipas pjesës takuese (1/5 e tij) sikurse e ka deklaruar në vitin 2003 në shumën 600.000 lekë.

4.9 Trupi gjykues vlerëson se nga analiza e dokumentacionit, qartazi, konstatohet se kronologjia e veprimeve të kryera me këtë pasuri përputhet me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, pasi ka rezultuar se kjo pasuri është regjistruar në hipotekë (mbi kërkesën e trashëgimtarëve) vetëm pasi është realizuar shitja e saj, bazuar në kontratën e shitjes me rezervë. Po ashtu, përsa kohë palët kanë qenë në mirëbesim me njëra-tjetrën nuk kanë pasur kundërshti prej momentit të

⁴⁶Me pyetësorin nr. 2, datë 3.2.2020.

shitjes me rezervë, duke konfirmuar me deklaratimet e tyre në kohë se janë shlyer për këtë pasuri, tupi gjykues nuk konstaton asnjë problematikë. Trupi gjykues, në këtë konkluzion, ka vlerësuar edhe sqarimet e subjektit⁴⁷ gjatë hetimit se *për tjetërsimin e kësaj pasurie nga shitësit te blerësit është paguar vetëm tarifa e shërbimit në vlerën 2.750 lekë⁴⁸ pasi, sipas rubrikave të faturës rezulton se tatimi në fitim është 0 (zero) për shkak se prona është e rivlerësuar në vlerën 6.409.200 lekë dhe shitja në kontratë është bërë formalisht në të njëjtën vlerë (pasi në fakt vlera e shitjes është 3.200.000 lekë, siç është sqaruar dhe qartësuar në përgjigjen e pyetjes 7 të pyetësorit nr. 2, datë 3.2.2020. Në tërësi, subjekti ka sqaruar se të gjithë pagesat për tjetërsimin e pasurisë janë bërë nga blerësit e kësaj pasurie...*

Trupi gjykues vlerëson se në analizë të sa më sipër është e kuptueshme që në kushtet e rivlerësimit të pasurisë zyra noteriale t'i përmbahet çmimeve referencë në nivel qyteti dhe zone kadastrale.

Fakti që kontratës së shitjes i ka paraprirë kontrata e mëparshme me rezervë pa humbur efektet e saj, atëherë nënkuptohet se kjo e fundit i ka prodhuar dhe përmbushur parashikimet e saj.

4.10 Në të tilla kushte, analizuar mbi këto prova, trupit gjykues nuk i kanë rezultuar problematika në lidhje me përfitimin dhe shitjen e kësaj pasurie dhe, për pasojë, as edhe me krijimin dhe deklarinin e shumës së të ardhurave nga subjekti i rivlerësimit.

Deklarimi i detyrimeve

5. Kredi për strehim, Banka e Kursimeve, dega Tiranë, aktualisht “Raiffeisen Bank”, kontratë huaje për blerje banese, shuma 5.000.000 lekë, me afat shlyerje 25 vjet, interesi bankar 3%/vit, kësti mujor 23.800 lekë. Kontrata nr. ***, datë 23.6.2003. Shuma e detyrimit të mbetur 2.764.537 lekë.

5.1 Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratën disa dokumente⁴⁹.

5.2 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur se deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

5.3 “Raiffeisen Bank”, me shkresën nr. ***prot., datë 30.9.2019, ka konfirmuar kredinë në emër të subjektit Kujtim Luli. Komisioni e ka trajtuar këtë kredi në pasurinë nr. 1 më sipër. Shuma e detyrimit të mbetur deri në datën 26.1.2017 kur është dorëzuar deklarata *Vetting* është 2.764.537 lekë.

5.4 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

6. Pagesa për djalin K. L., për shkollën e lartë në W.P. I. MA, dega shkenca kompjuterike, për periudhën 4-vjeçare, gusht 2009 – maj 2013. Shuma 72.479 USD. Burimi i origjinës së

⁴⁷Në pyetësorin nr. 5, datë 11.5.2020.

⁴⁸Sipas faturës për arkëtim nr. ***, datë 20.10.2011 nënshkruar nga njëri prej blerësve, administruar me pyetësorin përkatës.

⁴⁹Kontratë huaje për blerje banese nr. ***, datë 25.6.2003 + plani i amortizimit të kredisë + vërtetim i njësisës së kopjes me origjinalin, datë 27.1.2017; kontratë dorëzanie nr. ***, datë 25.6.2003 + vërtetim i datës 1.7.2003, i ZRPP-së Tiranë për regjistrimin e kontratës së dorëzarisë; deklaratë noteriale nr. ***, datë 19.5.2003; nxjerrje llogarie e “Raiffeisen Bank” e datës 20.1.2017 (referojuni Aneksit nr. 4/7, në dosjen e ILDKPKI-së).

pagesave janë të ardhurat nga paga e subjektit dhe bashkëshortes. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁵⁰.

6.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: “Referuar dokumenteve të paraqitura rezulton se për djalin K. L. pagesat për shkollim, të transferuara nëpërmjet BKT-së, janë në total 72.499 USD”.

6.2 Subjekti ka deklaruar në mënyrë periodike shpenzimet e kryera për shkollimin e djalit K.L. në Universitetin W. P. I. MA, dega shkenca kompjuterike, për periudhën 2009 – 2013, në total në shumën 72.587 USD.

6.2.i Sipas transfertave bankare të kryera nëpërmjet llogarisë së subjektit në Bankën Kombëtare Tregtare⁵¹, por edhe sipas deklarimeve të tij gjatë hetimit rezultoi të paguar shuma 77.330 USD.

6.3 Komisionit, referuar dokumenteve të paraqitura dhe përgjigjeve në pyetësor⁵², i rezultoi se për djalin K. L. pagesat për shkollim janë në total 77.330 USD dhe se subjekti në deklaratat periodike ka deklaruar në total shumën 72.587 USD, ndërsa në deklaratën *Vetting* totali është deklaruar 72.479 USD. Komisioni ka kuptuar se këto diferenca kryesisht vijnë nga pagesat *cash* të kryera nga djali pranë universitetit, megjithatë për t’u qartësuar i ka kërkuar subjektit të japë shpjegime⁵³.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera, në parashtrimet e tij ka cituar se konstatimin në materialin “Rezultatet e hetimit administrativ” për vlerën totale të përlllogaritur për shkollimin e djalit K.L. e konsideron të drejtë dhe të bazuar. Diferencat që kanë ndikuar në shifrat e deklaruara për shkollimin e tij janë të lidhura me komisionet e disa transfertave bankare, një tarifë rinovimi e siguracionit mjekësor dhe kostoja e klasës së fundit e pa shoqëruar me faturë, të gjitha këto të paguara nga djali me transfertat elektronike, për të cilat subjekti nuk ka qenë i përditësuar në periudhat përkatëse të deklarimit periodik vjetor, në deklaratën e pasurisë në procesin e rivlerësimit kalimtar dhe në shpjegimet e dhëna gjatë këtij procesi sipas natyrës së tyre.

⁵⁰Kërkesë për transaksion nëpërmjet BKT-së të datës 27.7.2009, të shumës 13.746 USD në përfitim të U. W.P.I. MA, për pagesë shkolle për studentin K.L. nga Kujtim Luli + faturë shpenzimesh e W*** në shumën 13.746 USD; kërkesë për transaksion nëpërmjet BKT-së të datës 3.3.2010, të shumës 2.930 USD në përfitim të U.W. P. I. MA, për pagesë shkolle për studentin K. L. nga Kujtim Luli + faturë shpenzimesh e W*** në shumën 2.930 USD; kërkesë për transaksion nëpërmjet BKT-së të datës 2.8.2010, të shumës 11.523 USD, në përfitim të U.W.P.I. MA, për pagesë shkolle për studentin K.L. nga Kujtim Luli + faturë shpenzimesh e W*** në shumën 11.523 USD; kërkesë për transaksion nëpërmjet BKT-së të datës 4.1.2011, të shumës 11.693 USD në përfitim të U. W. P. I. MA, për pagesë shkolle për studentin K. L. nga Kujtim Luli + faturë shpenzimesh e W*** në shumën 11.673 USD; kërkesë për transaksion nëpërmjet BKT-së të datës 29.7.2011, të shumës 9.874 USD në përfitim të U.W.P.I. MA, për pagesë shkolle për studentin K. L. nga Kujtim Luli + faturë shpenzimesh e W*** në shumën 9.874 USD; kërkesë për transaksion nëpërmjet BKT-së të datës 3.1.2012, të shumës 8.800 USD në përfitim të U. W.P. I. MA, për pagesë shkolle për studentin K. L. nga Kujtim Luli + faturë shpenzimesh e W*** në shumën 8.765 USD; kërkesë për transaksion nëpërmjet BKT-së të datës 31.7.2012, të shumës 10.569 USD në përfitim të U.W.P. I. MA, për pagesë shkolle për studentin K. L. nga Kujtim Luli; kërkesë për transaksion nëpërmjet BKT-së të datës 4.1.2013, të shumës 3.399 USD në përfitim të U. W.P. I. MA, për pagesë transfertat studime nga Kujtim Luli +instruksione të transfertës bankare nga W*** në shumën 3.399 USD (referojuni Aneksit nr. 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së).

⁵¹Aneks 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së, pyetësori nr.3, datë 18.3.2020 dhe pyetësori nr.4, datë 27.4.2020.

⁵²Pyetësori nr. 4 datë 27.4.2020.

⁵³Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të deklaramëve të subjektit, dokumentacionit të administruar si dhe qëndrimit të mbajtur në prapësime, arsyeton si vijon:

Pavarësisht diferencave të konstatuara dhe të pranuar edhe nga subjekti, ka vlerësuar si më të rëndësishme dhe ka përlllogaritur në analizën financiare shumën e shpenzuar realisht për shkollimin e djalit K.L., në vlerën 77.330 USD, pasi ka konstatuar se subjekti ka deklaruar periodikisht pagesat e kryera për shkollimin e djalit në U. W. P.I.(W***) përveç diferencave të konstatuara që janë të lidhura me komisionet e disa transfertave bankare, një tarifë rinovimi i siguracionit mjekësor, si dhe kostoja e klasës së fundit e pa shoqëruar me faturë, të gjitha këto të paguara nga djali me transferta *cash* ose elektronike.

Trupi gjykues, pas një hetimi të thelluar për të krijuar bindjen e plotë ku subjekti⁵⁴ depozitoi edhe vërtetimin nga universiteti për pagesat e kryera, e-mail-in që djali i drejtonte Zyrës së Bursarit/Financës së W***, përgjigjen e kthyer dhe raportin përmbledhës të nënshkruar elektronikisht mbi tarifën, pagesat dhe përfitimet nga bursa për të gjithë periudhën e studimeve të djalit K. L. në W***, konkludon se deklaramet e subjektit karakterizohen nga veprime të rregullta për të sqaruar pasaktësitë e vërejtura me prova shkresore.

Trupi gjykues vlerëson faktin se subjekti, në mbështetje të deklaramëve të tij si në deklaramen *Vetting* por edhe gjatë hetimit, ka treguar kujdesin e shtuar për të depozituar çdo lloj dokumentacioni provues dhe lehtësisht të krahasueshëm për shpenzimet shkollore, si faturat e lëshuara nga universiteti dhe pagesat që ka kryer nëpërmjet transfertave bankare nga Shqipëria për universitetin e djalit të tij. Gjithashtu, konstatuar se në çdo faturë është specifikuar semestri (pranverë ose vjeshtë), viti akademik, është përshkruar sa është tarifa e shkollimit, bursa që ka përfituar studenti, shpenzimet për akomodim, ushqim, siguracion, etj. I njëjti informacion i përshkruar në faturat e depozituara nga subjekti, paraqitet edhe në raportin përmbledhës të dërguar nga Zyra e Financës së Universitetit W***.

Trupi gjykues, pas krahasimit të informacionit, nisur jo vetëm nga vërtetimi i shkollës por edhe nga hulumtimi⁵⁵ i kryer, ku tarifën rezultuan të njëjta me faturat e depozituara nga subjekti, krijoi bindjen se subjekti ka deklaruar me vërtetësi dhe saktësi tarifën e shkollimit.

7.Në lidhje me pagesën për djalin E. L., për shkollën e mesme “L.-G.”, Prizren, Kosovë, në periudhën 2-vjeçare, gusht 2009 – qershor 2011: shuma 5.320 euro. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaramen disa dokumente⁵⁶.

7.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: “Referuar deklaramëve të interesave private për vitet 2009 – 2011, shpenzimet e shkollimit në total për djalin E. L. janë 5.320 euro”.

⁵⁴ Pyetësori nr.10, datë 22.9.2020.

⁵⁵<https://www.wpi.edu/news/tuition>

⁵⁶Shkresë informuese e shkollës “L.G.” Prizren, drejtuar subjektit Kujtim Luli në datën 31.8.2009 për tarifën e pagesës për djalin E. L., në total 2.640 euro si konvikt (840 euro si jokonvikt); shkresë informuese e shkollës “L. G.” Prizren, drejtuar subjektit Kujtim Luli në datën 31.8.2010 për tarifën e pagesës për djalin E. L., në total 2.760 euro si konvikt (840 euro si jokonvikt) (referojuni Aneksit nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së).

7.2 Komisionit i rezultoi sesubjekti ka deklaruar në mënyrë periodike shpenzimet e kryera për shkollimin e djalit E. L. në shkollën e mesme “L.-G.”, Prizren, Kosovë, në periudhën 2009 – 2011, në vlerën totale prej 5.320 euro.

7.2.i Sipas dokumentacionit të depozituar⁵⁷rezultoi:

- shkresë informuese e shkollës “L. G.” Prizren, drejtuar subjektit Kujtim Luli në datën 31.8.2009, për tarifën e pagesës për djalin E.L., në total 2.640 euro si konviktor (840 euro si jokonviktor);
- shkresë informuese e shkollës “L. G.” Prizren, drejtuar subjektit Kujtim Luli në datën 31.8.2010 për tarifën e pagesës për djalin E. L., në total 2.760 euro si konviktor (840 euro si jokonviktor).

7.3 Referuar përgjigjes së subjektit⁵⁸ se djali E. L.nuk ka pasur shpenzime jetese gjatë kësaj periudhe sepse ka qenë në konviktor, rezulton se shuma e shpenzuar për këtë shkollim është 5.400 euro (tarifa për konviktor 2.640 + 2.760).

7.4 Për sa më sipër, trupi gjykues,nisur edhe nga qëndrimi⁵⁹ i subjektit në prapësimet e tij, konkludon se ka një diferencë të papërfillshme prej 80 euro mes deklarimeve periodikeVettingdhe dokumentacionit të shkollës dhe, për pasojë, ky konstatim nuk ndikon në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit në këtë vendimmarrje. Për më tepër, trupi gjykues, diferencën e konstatuar në mbledhjen e shumave, e vlerëson jo vetëm të papërfillshme por edhe si një gabim material.

8. Në lidhje me pagesën për djalin E. L., për universitetin R. C., W., MA, dega “Menaxhim Biznes” në vitet gusht 2013 – maj 2015 dhe për shkollën e lartë të transferuar, S. U. Boston MA, ***, dega “Kontabilitet” në vitet gusht 2015 – maj 2017. Burimi i deklaruar i origjinës së pagesave: të ardhurat nga paga e subjektit, bashkëshortes dhe djalit K. L., si dhe kursimet në vite nga këto të ardhura. Shuma 76.939 USD. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁶⁰.

⁵⁷Aneks nr. 4/9 në dosjen e ILDKPKI-së dhe pyetësor nr.1, datë 3.7.2019.

⁵⁸Pyetësori nr.3, datë 18.3.2020.

⁵⁹Referuar tabelës së paraqitur me shumata e shpenzimeve sipas viteve kalendarike, nga ripërlllogaritja ështëqartësuar se në vitin 2010, shuma 2.600 euro duhet të jetë 2680 euro, për faktin se pagesat në vitin kalendarik 2010 përfshijnë dy këste të vitit të parë (880+880=1.760 euro) dhe një këst (i parë) i vitit të dytë shkollor (920 euro), si dhe shuma e deklaruar nga vlera 5.320 euro duhet vlera 5.400 euro. Këto gabime materiale janë konstatuar dhe deklaruar në shënimet fundore (footnotes) nr.4 të përgjigjeve të pyetjes nr.2, pyetësori nr.3, datë 18.3.2020 i KPK-së...“Konstatoj gabime materiale në mbledhjen e shumës së vetëdeklaruar në vitin 2010, te vlera 2.600 euro duhet vlera 2.680 euro dhe i njëjti gabim material në mbledhjen e tri viteve është transferuar edhe në vetëdeklarimin e rivlerësimit të vitit2017, te vlera 5.320 euro duhet vlera 5.400 euro”.

⁶⁰Kërkesë për transaksion nëpërmjet BKT-së së datës 13.8.2013 të shumës 13.864 USD në përfitim të U.R.C., për pagesë shkollë për studentin E. L. nga Kujtim Luli + faturë shpenzimesh e U.R. C. të datës 16.8.2013 në shumën 13.864 USD; kërkesë për transaksion nëpërmjet BKT-së datë 3.1.2014, të shumës 8.021 USD në përfitim të U.R.C., për pagesë shkollë për studentin E. L. nga Kujtim Luli + nxjerrje llogarie e U.R. C. e datës 20.12.2013 në shumën 12.090 USD; kërkesë për transaksion nëpërmjet BKT-së të datës 15.8.2014 të shumës 9.471 USD në përfitim të R. C., për pagesë shkollë për studentin E. L. nga Kujtim Luli + nxjerrje llogarie e U. R. C. e datës 14.8.2014 në shumën 14.471 USD; printim nga llogaria në Bank of America e djalit K.L. të datës 22.1.2015 për transaksionin në shumën 12.875 USD, në përfitim të U.R. C.; printim nga llogaria në Bank of America nga djali K.L.e datës 31.7.2015 për transaksionin në shumën 9.972 USD, pagesë shkollimi + konfirmim të pagesës prej 9.972 USD për studentin E. L., vjeshtë 2015, S., U. i Bostonit; Konfirmim i pagesës së shkollimit prej 8.217 USD për studentin E. L., pranverë 2016, Universiteti i Bostonit, datë 5.1.2016; konfirmim i pagesës së shkollimit prej 10.609 USD për studentin E. L., vjeshtë 2016, Universiteti i Bostonit + faturë e pagesës 10.609 USD nga llogaria e z. K. L. për z. E.L.në datën 19.8.2016; konfirmim i pagesës së shkollimit prej 8.219 USD për studentin E. L., pranverë 2017, Universiteti i Bostonit + faturë e pagesës 8.219 USD nga llogaria e z. K. L. për z. E. L. në datën 18.1.2017 (referojuni Aneksit nr. 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së).

8.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: “Referuar dokumenteve të paraqitura në deklaratën *Vetting*, rezulton se për djalit E. L. pagesat për shkollim në SHBA janë në total 81.248 USD, deklaruar 76.939 USD, ndërsa në përmbledhje të deklarimeve në vitet 2013 – 2017 në ILDKPKI, rezulton shuma 90.280 USD. Në deklaratën e interesave private të vitit 2014, pagesa për shkollimin e djalit E. L. është deklaruar në shumën 26.561 USD, ndërsa në dokumentacionin e paraqitur në procesin e rivlerësimit, gjatë vitit 2014 janë bërë dy transferta, 8.021 USD + 9.471 USD”.

8.2 Komisionit i ka rezultuar sesubjekti ka deklaruar në mënyrë periodike shpenzimet e kryera për shkollimin e djalit E. L. në U.R. C., W., MA, dega “Menaxhim Biznes” në vitet 2013 – 2015 dhe për Universitetin të transferuar, S.U. Boston MA, dega “Kontabilitet” në vitet gusht 2015 – maj 2017, në total 90.820 USD.

8.2.i Pagesat, sipas transfertave bankare të kryera nëpërmjet llogarisë së subjektit në Bankën Kombëtare Tregtare dhe llogarisë së djalit K. L. nga Bank of America⁶¹, kanë rezultuar në shumën 101.327 USD.

8.3Për sa më sipër, Komisioni, referuar dokumentacionit bankar dhe pasqyrës së llogarisë së universiteteve (R. dhe S.) konstatoi mospërputhje në deklarambi pagesat e kryera për shkollimin e djalit E. L.. Sipas transfertave bankare dhe konfirmimit të universiteteve, për shkollimin e tij është paguar shuma 101.327 USD, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar 76.939 USD, ndërsa në përmbledhje të deklarimeve periodike në vitet 2013 – 2017, rezulton shuma 90.820 USD dhe, për pasojë, i kërkoi subjektit të japë shpjegime⁶².

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

8.4 Subjekti, në parashtrimet e tij, ndër të tjera, ka prapësuar se pagesat për shkollimin e djalit E.L., në degën “Menaxhim Biznesi”, në U. R.C., SHBA, në degën “Kontabilitet”, transferuar në S. U., SHBA, janë kryer sipas transfertave bankare dhe faturave përkatëse të vetëdeklaruar në deklaratat e pasurisë sipas viteve dhe në deklaratën e pasurisë në procesin e rivlerësimit kalimtar, dorëzuar në janar të vitit 2017 në ILDKPKI, duke bashkëlidhur dokumentacionin ligjor mbështetës.

Burimi i origjinës së pagesave për shkollimin e djalit E. L. janë të ardhurat nga paga e subjektit, bashkëshortes dhe djalit K., i cili ka pasur aftësi pagueese, duke qenë i punësuar që ngamarsi i vitit 2013 e në vijim me kontratë pune në shoqërinë “A.S.LLC”, si dhe kursimet nga këto të ardhura. Këto shpenzime janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore të pasurisë sipas pagesave në vitet 2013 – 2017, në ILDKPKI dhe në deklaratën në procesin e rivlerësimit kalimtar, dorëzuar në janar të vitit 2017 në ILDKPKI.

Detajet për pagesat për shkollimin e djalit E.L., për çdo vit kalendarik, janë të shpjeguara në përgjigjet e pyetësorëve: datë 22.9.2020, nr. 4; datë 27.4.2020, nr.3; datë 18.3.2020 dhe përgjigjet e pyetësorit standard datë 3.7.2019, të Komisionit, sidhe nëprocesverbalin datë 18.3.2016, “Mbi shpjegimet e subjektit të deklarimit të pasurive” mbajtur nga inspektori përkatës i

⁶¹Aneks 4/8 në dosjen e ILDKPKI-së dhe pyetësori nr. 3, datë 18.3.2020.

⁶²Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

ILDKPKI-së dhe në materialin “Shpjegime shtesë” datë 28.3.2016 lidhur me atë procesverbal, të dorëzuar/depozituar në atë institucion (ILDKPKI).

Përgjithësisht, raporti përmbledhës datë 25.9.2020, dërguar nga Zyra e Bursarit/Financës të U.R. C. dhe raporti përmbledhës datë 24.9.2020, dërguar nga Zyra e Bursës/Financës në S.U., konfirmojnë (me diferenca në vlera relativisht të vogla për depozita pranimi dhe kredite shtesë për shkollim), të dhënat e vetëdeklaruar në deklaratimet periodike vjetore, në deklaratën e procesit të rivlerësimit kalimtar në janar të vitit 2017, si dhe me shpjegimet dhe qartësimet gjatë procesit të verifikimit/rivlerësimit të shoqëruara me dokumentacionin ligjor provues/mbështetës.

Gjatë procesit të vlerësimit kalimtar *Vetting* janë evidentuar disa diferenca në vlera të vogla për depozita pranimi dhe kredite shtesë për shkollimin e djalit E. L. të paguara me transferta elektronike nga djali K. L. të analizuar, vlerësuar dhe trajtuara në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, datë 27.4.2020 dhe pyetësori datë 22.9.2020, të dërguara në Komision.

Referuar deklaratimit periodik për vitin 2014, vlera në shumën 26.561 USD e deklaruar për shkollimin e djalit E.L. është e saktë dhe përbëhet nga dy transferta bankare të kryera nëpërmjet BKT-së në vlerën 8.021 USD dhe në vlerën 9.471 USD, si dhe dy transferta elektronike të kryera nga djali K.L., përkatësisht, në vlerat 4.000 USD dhe 5.000 USD, të dokumentuara me dokument printimi nga llogaria e tij, të konfirmuara dhe nga raporti përmbledhës datë 25.9.2020, dërguar nga Zyra e Bursarit/Financës të U.R.C. .

Për sa i përket materialit “Rezultati i hetimit administrativ”, lidhur me diferencën mes deklaratimit në deklaratën *Vetting*, në total vlera 76.939 USD dhe përmbledhjes së deklaratimeve periodike në vitet 2013 – 2017, e cila rezulton në shumën 90.820 USD, subjekti konfirmon saktësinë e deklaratimeve periodike në vitet 2013 – 2017 mbi vlerat që ka paguar për shkollimin e djalit E. L., duke shpjeguar se diferenca vjen nga mospërfshirja e pagesës së janarit të vitit 2017 në shumën e deklaruar në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* për mungesë të informacionit mbi pagesat e kryera nga djali K. L. për shkollim të djalit E. L.. Gjatë procesit të vlerësimit kalimtar *Vetting*, periodikisht është përditësuar me të dhënat përkatëse, të cilat janë reflektuar në përgjigjet e pyetësorëve nr. 4, nëdatat 27.4.2020 dhe 22.9.2020 e vijues të Komisionit.

Për sa i përket diferencës së trajtuar në materialin “Raporti i hetimit administrativ” mes të dhënave nga transkriptet e universiteteve mbi vlerën e shkollimit të djalit E. L. në shumën 101.327 USD dhe përmbledhjes së deklaratimeve vjetore 2013 – 2017, ku rezulton shuma 90.820 USD subjekti shpjegon dhe argumenton se: “Në raportin përmbledhës datë 24.9.2020, të S. U., në kolonën ‘detyrime’, paraqitet si detyrim për pagesë ‘Tuition-Undergrad Part’ (tarifa e studimit universitar me kohë të pjesshme) vlera 9.378 USD. Kjo vlerë ka të bëjë me një detyrim të pasaktë të faturuar nga S.U., pasi llogaritja ishte kryer duke u bazuar në sistemin e studimit part-time, ndërkohë që djali E. L. ndiqte studimet në sistemin full-time.

Kjo pasaktësi është evidentuar nga vetë S.U., duke paraqitur detyrimin korrekt për pagesë ‘Tuition-Undergrad Full’ (tarifa e studimit universitar me kohë të plotë) në vlerën totale 17,720 USD, e cila përfshin ‘TOUCHNHT CHECK PAYMENT’ pagesën për shkollim të djalit

në vlerën 8.219 USD + vlerën 8.750 USD 'D. SCHOLARSHIP + vlerën 820 USD 'Grandfatherd Tuition'.

Njëkohësisht, S.U. ka kryer edhe anulimin e detyrimit për vlerën 9.378 USD, duke e paraqitur në kolonën 'pagesa/kredite' të raportit të përmbledhur me të njëjtin përshkrim (Tuition-Undergrad Part), në dallim nga pagesat e kryera, të cilat evidentohen me përshkrimin 'TOUCHNHT CHECK PAYMENT'.

Në datën 18.1.2017 me përshkrimin 'TOUCHNHT CHECK PAYMENT' në vlerën 8.219 USA pagesa është kryer nga djali K. për shkollimin e djalit E. .

Në përfundim theksoj se vlera 9.378 USD e përfshirë në materialin "Rezultati i hetimit administrativ" si pagesë e kryer për shkollimin e djalit E., nuk përfaqëson pagesë të kryer në asnjë formë. Pjesa e mbetur e diferencës përfaqëson pagesë me transfertë elektronike për kredite shtesë e kryer nga djali K. në vlerën 1.112 USD, për të cilën kam dhënë shpjegime në përgjigje të pyetësorit datë 22.9.2020, të KPK-së.

Për të dokumentuar saktësinë e deklarimeve të mësipërme lidhur me shumën vlerën 9,378 USD djali E. i është drejtuar me email-e S. U. për të marrë një vertetim vetëm për vlerat e paguara për shkollimin e tij, por nuk u mundësua marrja e vertetimit mbrenda afatit të vendosur nga KPK-ja për dorëzimin e shpjegimeve".

Subjekti ka depozituar gjithashtu përpara seancës dëgjimore⁶³ shpjegime dhe prova/akte shkresore të reja. Në materialin e depozituar ka sqaruar se: "Në përgjigje të kërkesave të përsëritura të djalit E., me e-mail-et datë 8 - 9.10.2020 për të qartësuar pagesat e kryera për shkollim në S.U., me e-mailin e datës 16.10.2020 S.U. i ka ridërguar djalit raportin përmbledhës të llogarisë "Statement of Account" datë 24.9.2020 të ngjyrosur me të verdhë gjithë pagesat e kryera për shkollimin e tij, ku nuk përfshihet vlera 9.378 USD, me komentin "... në pamundësi për të dërguar një dokument në formatin e kërkuar, bashkëlidhur dokumenti i ngjyrosur vetëm për pagesat e kryera për shkollim".

Diferencat e evidentuara më sipër nuk kanë të bëjnë me vlera/pagesa të padeklaruara të asnjë forme dhe natyre, por vijnë thjeshtë nga fakti i mospërputhjes në kohë të informacionit të plotë mbi pagesat e kryera nga djali K. me momentin e deklarimeve të kryera, si dhe nga një lexim jo i saktë i zërave/elementëve të përshkruar në raportin përmbledhës të S.U. .

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

8.5 Trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit, përgjigjeve në pyetësorë, provave të administruara dhe parashtrimeve në prapësime për provueshmërinë e vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimeve në raport me ligjin, arsyeton si vijon:

Trupi gjykues e quan bindës dhe të pranueshëm shpjegimin e subjektit lidhur me diferencën mes deklarimit në deklaratën *Vetting* dhe përmbledhjen e deklarimeve periodike në vitet 2013 – 2017, ku konfirmon saktësinë e deklarimeve periodike 2013 – 2017 mbi vlerat që ka paguar për shkollimin e djalit E. L., duke qartësuar se diferenca vjen nga mospërfshirja e pagesës së

⁶³ Parashtrësë për rezultatet e hetimit administrativ, datë 16.11.2020.

janarit të vitit 2017 në shumën e deklaruar në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* për mungesë të informacionit mbi pagesat e kryera nga djali K. L. për shkollim e djalit E. L. .

Trupi gjykues, në vlerësimin e tij, mban në vëmendje faktin se subjekti ka deklaruar periodikisht nga viti 2013 e në vazhdim pagesat e kryera për shkollimin e djalit E. L., duke i emërtuar pagesa familjare dhe ka sqaruar gjatë hetimit se burim për to kanë qenë pagat e tij, të bashkëshortes dhe djalit K. L. . Pra, këtë lloj bashkësie subjekti (të saktësuar në seancën dëgjimore “buxhet familjar”) nuk e pasqyron vetëm gjatë hetimit apo në prapësime, por e ka konkretizuar në mënyrë konsistente në deklaratimet periodike dhe që, për pasojë, logjikisht përlllogaritjet sidoqofshin ato, i nënshtrohen kontributit familjar.

Në analizë të provueshmërisë së kontributit familjar, sikurse është deklaruar nga subjekti, trupi gjykues ka konsideruar edhe përgjigjen e dhënë nga ky i fundit gjatë hetimit administrativ lidhur me kontributin e djalit K. L. për pagesat e kryera në favor të vëllait të tij, ku përveç provave të depozituara, ai ka sqaruar se në maj të vitit 2013 kur ai dhe bashkëshortja kanë qenë në SHBA, djali K.L. i ka dhënë *cash* shumën 4.000 USD për të kontribuar në pagesën e faturës së pritshme për shkollimin e djalit E.L., i cili ishte regjistruar dhe në gusht të 2013 do të fillonte studimet. Ndërsa gjatë ardhjes së djalit në Shqipëri⁶⁴, për periudhën 15.12. 2013 – 8.1.2014, djali K.L. i ka dhënë *cash* shumën 4.000 USD, e cila gjithashtu është përfshirë te transferta/pagesa e datës 3.1.2014, si dhe gjatë qëndrimit në periudhën 3.7 – 22.8. 2014 i ka dhënë *cash* shumën 4.000 USD, e cila është përfshirë në transfertën e datës 15.8.2014. Ndërsa nga gushti i vitit 2014 dhe në vazhdim, për pagesat e kryera për shkollimin e djalit E.L., trupi gjykues ka konstatuar se rezultojnë transfertat nga llogaria bankare në SHBA e djalit K.L. për universitetin ku studionte vëllai i tij E.L. . Megjithë bindjen e krijuar në investimin e shkollimit me kontribut familjar, përse kohë nëpër deklaratimet periodike janë deklaruar edhe të ardhurat e djalit K. L., është deklaruar po ashtu se investimi i shkollimit ka përfshirë edhe të ardhurat e djalit K., sado qofshin ato në momente të caktuara, kurrsesi nuk mund të mos përlllogariten dhe të anashkalohen. Nga ana tjetër, veprimet e kryera mes subjektit dhe djalit të tij K. L., në dobi të shkollimit të djalit E.L., përkojnë me periudha të cilat familja është gjendur bashkë në udhëtimet reciproke si në SHBA dhe po ashtu në Shqipëri.

Trupi gjykues, pasi mori në konsideratë gjithashtu edhe sqarimin e subjektit në prapësime se Komisioni kishte përfshirë në përlllogaritje një pagesë, tarifë studimi me kohë të pjesshme në vlerën 9.378 USD, e cila ishte faturuar gabimisht nga ana e universitetit, në mbështetje të së cilës, subjekti depozitoi edhe dokumentacionin provues, ku u konstatua se kjo vlerë kishte të bënte me një detyrim të pasaktë të faturuar nga S.U., pasi llogaritja ishte kryer duke u bazuar në sistemin e studimit *part-time*, ndërkohë që djali E. L. ndiqte studimet në sistemin *full-time*, konstatoi se diferenca në shumat e paguara për studimin e djalit të subjektit, E.L. nuk qëndronte. Më konkretisht, në dokumentacionin e depozituar datë 16.11.2020, në të cilën S.U. i kishte ridërguar djalit të subjektit, E.L., raportin përmbledhës të llogarisë “Statement of Account”, rezultojnë të evidentuara me ngjyrë të gjithë pagesat e kryera për shkollimin e tij dhe vlera 9.378 USD nuk rezulton të jetë përfshirë. Raporti është shoqëruar me e-mail-in e Universitetit ku sqarohet se janë shënuar me ngjyrë vetëm pagesat e kryera për shkollim.

⁶⁴Konfirmohen deklaratimet e subjektit pas verifikimit në sistemin *TIMS* për hyrje-daljet në Shqipëri.

Për sa më sipër, trupi gjykues i vlerëson bindëse provat e depozituara dhe shpjegimin e subjektit për diferencën e konstatuar dhe, për pasojë, nuk ka përfshirë në analizën financiare shumën prej 9.378 USD, megjithëse shuma e konstatuar nuk kishte efekt financiar në analizën e kryer për subjektin dhe familjen e tij, por thjesht dhe vetëm u trajtua për të saktësuar vlerën e shpenzuar për shkollimin e djalit E. L. .

9. Në lidhje me deklarinin për shpenzime në vitet 2004, 2005 dhe 2006, për mobilimin e apartamentit në Rr. “F. R.”, me orenditë dhe pajisjet e nevojshme (subjekti ka deklaruar se nuk disponon dokumentejustifikuese ligjore, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar). Burimi i deklaruar i krijimit: të ardhurat nga paga e subjektit, bashkëshortes dhe kursimet në vite nga këto të ardhura. Shuma 1.410.000 lekë.

9.1 Lidhur me këtë deklarinin, Komisioni e ka pyetur subjektin⁶⁵ dhe në përgjigjen e tij ai ka deklaruar shpenzimet e kryera për secilin vit për apartamentin në Rr. “F. R.”.

Vitet	2004	2005	2006	Totali
Ap. në Rr. “F. R.”	472,000	478,000	460,000	1,410,000

9.2 Trupi gjykues, pasi analizoi të dhënat e administruara dhe kreu nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor analizën financiare për këto vite, nuk i rezultuan problematika.

10. Llogari në lekë me nr. *** me tepricë/gjendje në datën 31.12.2016 shuma 991.173 lekë (vërtetimi nr. ***, datë 20.1.2017, nga “Credins Bank”). Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vërtetimin⁶⁶ nr. ***, datë 20.1.2017, të “Credins Bank” për llogarinë me gjendje 991.173 lekë, në datën 31.12.2016, në emër të subjektit Kujtim Luli.

10.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.

10.2 Nga korrespondenca e mbajtur, “Credins Bank”, me shkresën nr. ***prot., datë 12.12.2019, konfirmon llogari page në emër të z. Kujtim Luli me gjendje 991.173,9 lekë, në datën 26.1.2017.

10.3 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar, ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga “Credins Bank”.

Deklarimi i bashkëshortes së subjektit – znj. F.L.

11. Në BKT, dega “Rruga ***” Tiranë, me nr. llog. *** (Person Fizik) gjendje datë 26.1.2017, shuma 2.750 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur⁶⁷ deklaratës vërtetimin nr. ***, datë 26.1.2017, të BKT-së, për gjendjen në shumën 2.750 lekë, në llogarinë e Personit Fizik F. L. .

11.1 BKT-ja, në vijimësi të shkresës nr. ***prot., datë 24.10.2019 konfirmon me e-mail llogari në emër të subjektit F.L. me NIPT *** (Person Fizik) gjendje në datën 26.1.2017, shuma 2.752, 84 lekë.

⁶⁵Pyetësor nr.1, datë 3.7.2019.

⁶⁶Referojuni Aneksit nr. 4/10 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁷Referojuni Aneksit nr. 4/12 në dosjene ILDKPKI-së.

11.2 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.

12. Në BKT, dega “Rruga ***” Tiranë, me nr.llog*** (individ) gjendje në datën 26.1.2017, deklarohet shuma 21.716 lekë. Subjekti ka depozituar vërtetimin nr. ***, datë 26.1.2017, të BKT-së. Subjekti i ka bashkëlidhur⁶⁸ deklaratës vërtetimin nr. ***, datë 26.1.2017, të BKT-së, për gjendjen në shumën 21.716 lekë në llogari individuale të znj. F.L. .

12.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *“Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe përgjigjen e ardhur nga BKT-ja”*.

12.2 Nga korrespondenca e mbajtur, BKT-ja, me shkresën nr. ***prot., datë 24.10.2019, konfirmon llogari në emër të znj. F.L. me gjendje në shumën 21.716 lekë, në datën 26.1.2017.

12.3 Trupi gjykues, në analizë të dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, ka konstatuar se deklarimi i subjektit përputhet me përgjigjen e ardhur nga BKT-ja.

13. Në lidhje me pagesën e qirasës banesës: apartamenti 1+1, lagjja “F. R.”, p. ***, shk. ***, Tiranë, me kontratën për periudhën 20.9.2016 – 19.3.2017. Subjekti ka deklaruar pagesë 15.000 lekë/muaj, deri në datën 31.12.2016. Burimi i deklaruar i pagesës: të ardhura nga paga. Shuma 60.000 lekë. Subjekti i ka bashkëlidhur⁶⁹ deklaratës kontratë qiraje të thjeshtë datë 20.9.2016, sipas së cilës znj. F. L. merr me qira në shumën 15.000 lekë/muaj apartamentin nr. ***, k. ***, shk. ***, p. ***, Rr. “F. R.” Tiranë, të mobiluar, me afat 20.9.2016 – 19.3.2017.

13.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *“Subjekti ka paraqitur kontratë të thjeshtë qiraje. Është e paqartë arsyeja e marrjes me qira të një apartamenti, në pallatin ku ai dhe bashkëshortja kanë në pronësi apartamentin e tyre”*.

13.2 Komisionit i ka rezultuar se subjekti e deklaroi për herë të parë këtë shpenzim në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 me përshkrimin: *“pagesë qiraje banese, apartament 1+1, lagjja ‘F.R.’, p. ***, shk***, Tiranë sipas kontratës datë 20.9.2016, pagesa 15.000 lekë/muaj, në periudhën shtator - dhjetor 2016’. Vlera: 60.000 lekë. Burimi i të ardhurave: nga paga dhe kursimet nga të ardhurat familjare.”*

13.3 Ky shpenzim konfirmohet me kontratë qiraje⁷⁰ datë 20.9.2016 me palë qiradhënëse shtetasin A. A. dhe palë qiramarrëse znj. F. L. . Qiraja mujore është përcaktuar 15.000 lekë/muaj. Afati i kontratës, gjithashtu, është parashikuar për një periudhë 6-mujore, afat i filluar nga data 20.9.2016 deri më 19.3.2017. Objekti i kësaj kontrate ka përshkrimin e qartë të pasurisë së marrë me qira: *“Apartamenti nr. ***, k. ***, shk. ***, p. ***, Tiranë, i ndodhur në Rr. ‘F. R.’ i mobiluar, i regjistruar në Regjistrin Hipotekor”*.

Në tërësi konstatohet se kontrata i ka elementët e saj përbërës, duke qenë një akt që i shtrin efektet e tij për një periudhë më pak se një vit kalendarik.

Gjatë hetimit, subjekti ka deklaruar se ky apartament është marrë me qira për djalin e tij përgjatë kohës që ai kthehej në Shqipëri.

⁶⁸Referojuni Aneksit nr. 4/12, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶⁹Referojuni Aneksit nr. 4/11 në dosjën e ILDKPKI-së.

⁷⁰Aneks 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

13.4 Trupi gjykues konkludon se subjekti ka deklaruar me vërtetësi e saktësi këtë veprim, për sa kohë ka rezultuar që apartamenti në pronësi të tij nuk ka qenë i lirë sipas kontratës së qirasë⁷¹, datë 20.11.2015, me afat 1-vjeçar, parashikuar me të drejtë përsëritjeje. Gjithashtu, bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u krye nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor analiza financiare për vitin 2016, vit ku pasqyrohet edhe ky shpenzim, nuk u konkludua në asnjë problematikë ligjore.

Deklarimi i pasurive të djalit të subjektit – K.L.

14. Në lidhje me pasuri të luajtshme, një automjet tip “Volkswagen Passat”, viti i prodhimit 2005, me targa ***, blerë në Gjermani në datën 5.8.2015. Burimi i deklaruar i krijimit:të ardhurat nga paga.Vlera: 350.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës disa dokumente⁷².

14.1 ILDKPKI-ja,në raportin e saj, është shprehur: *“Deklarimi i subjektit përputhet me dokumentacionin e paraqitur dhe me përgjigjen e ardhur nga DPSHTRr-ja”*.

14.2 Komisionit i ka rezultuar se subjekti e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike të vitit 2015 me përshkrimin: *“Pasuri e luajtshme, një autoveturë tip ‘Volkswagen, Passat’, viti i prodhimit 2005, me targa A***, në pronësi të djalit K.L., blerë në Gjermani në gusht 2015. Burimi i krijimit, të ardhurat nga paga e djalit K. . Në shumën e deklaruar përfshihen blerja, shpenzimet e transportit për sjellje, doganës dhe targimit. Vlera: 350.000 lekë”*.

14.3 DPSHTRr-ja, me shkresën nr***prot., datë 1.10.2019, informon se shtetasi K.L. ka të regjistruar automjetin me targa A***.

14.4 Nga dokumentacioni i administruar rezulton se vlera e automjetit ka qenë 1.140 euro dhe është zhdoganuar më 7.8.2015 me deklaratën doganore ***, detyrimet doganore (tvsh) në shumën 36.152 lekë.

14.5 Trupi gjykues, pasi kreu përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor, analizën financiare për vitin 2015 (duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se një vit më parë subjekti ka pasur gjendje *cash* të konsiderueshme), vit kur është kryer investimi në këtë pasuri të luajtshme, nuk konstatoi problematika lidhur me krijimin e saj dhe as me provueshmërinë e ligjshmërisë për të.

15. Në Bank of America, SHBA, llogari kursimesh, gjendja në datën 26.1.2017, shuma 33.776 USD. Pjesa takuese: 100%.

15.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *“Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me depozitën e djalit K. L. në Bank of America, SHBA”*.

⁷¹Referojuni aneksit 4/11 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷²Certifikatë pronësie e automjetit tip “Volkswagen Passat” me targa AA ***, në emër të shtetasis K.L., datë 11.8.2015 + faturë blerje e datës 5.8.2015 nga z. K. L., çmimi 1.140 euro + dokument zhdoganimi nga sheshi i trageteve Durrës, datë 7.8.2015; vërtetimi i njësisë së kopjes me origjinalin (referojuni aneksit nr. 4/13 në dosjen e ILDKPKI-së).

Komisioni i ka kërkuar subjektit⁷³ të depozitohet dokumentacioni justifikues mbi këtë llogari kursimesh në SHBA dhe ai ka depozituar gjendjet e llogarive bankare çdo fundvit për periudhën 31.12.2013 – 26.1.2017.

15.2 Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti dhe administruar gjatë hetimit administrativ, konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me statementin bankar.

16. Në Bank of America, SHBA, llogari rrjedhëse, gjendja në datën 26.1.2017, shuma 968 USD. Pjesa takuese: 100%.

16.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *“Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me depozitën e djalit K. L. në Bank of America, SHBA”*.

Komisioni i ka kërkuar subjektit⁷⁴ të depozitohet dokumentacioni justifikues mbi këtë llogari rrjedhëse në SHBA dhe ai ka depozituar gjendjet e llogarive bankare çdo fundvit në periudhën 31.12.2013 – 26.1.2017.

16.2 Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit të depozituar nga subjekti dhe administruar gjatë hetimit administrativ, konstatoi se deklarimi i subjektit përputhet me statementin bankar.

Deklarimi i detyrimeve

17. Kredi në Boston MA, për blerjen e një automjeti tip “BMW ***”, viti i prodhimit 2012, në shtator 2015, në shumën 28.441 USD, për 72 muaj, me interes 2.9 %/vit, kësti mujor 431,38 USD. Shuma e detyrimit të mbetur 18.873 USD. Subjekti i ka bashkëlidhur⁷⁵ deklaratën kontratën e blerjes së automjetit nga shoqëria “H.Ch.BMW” më 26.9.2015, nga shtetasi K. L. me çmimin total 35.441 USD + dokument financimi prej 28.441 USD, kësti 431 USD, numri i pagesave 72, duke filluar nga data 10.11.2015 + plani i amortizimit të financimit.

17.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: “Djali i subjektit, K. L., ka deklaruar kredinë e përdorur për blerjen e automjetit tip “BMW” në SHBA, por nuk ka deklaruar automjetin në vlerën e tij të plotë dhe/apo pagesën e bërë prej tij, përveç kredisë.

17.2 Komisionit i rezultoi se subjekti e deklaroi për herë të parë këtë kredi në deklaratën periodike të vitit 2015 me përshkrimin: *“Kredi e djalit K. L., në Boston MA, SHBA, për blerjen e një autoveture tip ‘BMW ***’, viti i prodhimit 2012, në shtator 2015, në shumën 28.053 USD, me afat shlyerje për 72 muaj, me interes 2.9 %, kësti mujor 431.38 USD. Pagaruar 1.294,14 USD dhe vlera e mbetur 27.343 USD.”*

17.3 Në deklaratën periodike të vitit 2016 subjekti deklaroi: *“Kredi e djalit K. L., në Boston MA, SHBA, për blerjen me kontratën e shitblerjes në shtator 2015 të një autoveture tip ‘BMW3***’, viti i prodhimit 2012, në shumën 28.441 USD, për 72 muaj, me interes 2.9 %, kësti mujor 431.38 USD. Pagaruar 8.470 USD dhe vlera e mbetur 18.873 USD”*.

⁷³Pyetësor nr.3, datë 18.3.2020.

⁷⁴Pyetësor nr.3, datë 18.3.2020.

⁷⁵Referojuni Aneksit nr. 4/15 në dosjen e ILDKPKI-së.

17.4 Nga analiza e dokumentacionit të administruar kjo kredi konfirmohet⁷⁶ me:

- dokument financimi në shumën 28.441 USD, kësti 431 USD, numri i pagesave 72, duke filluar nga data 10.11.2015 + plani i amortizimit të financimit;
- kontratën e blerjes së automjetit nga shoqëria “H.Ch. BMW”, në datën 26.9.2015, nga shtetasi K.L. me çmim total 35.441 USD.

17.5 Në analizë për sa më sipër, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka deklaruar në deklaratat periodike kredinë e marrë nga djali i tij në SHBA, pordukej se nuk kishte deklaruar vlerën reale tëblerjessë automjetit nga djali i tij K. L., si dhe burimin e saktë të krijimit, pasi nga dokumentacioni vlera e automjetit është 35.441 USD, ndërsa kredia 28.441 USD dhe, për pasojë, i kërkoi subjektit të japë shpjegime⁷⁷.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera, në parashtrime ka deklaruar se mosdeklarimi i shumës totale të kontratës për blerjen e automjetit nuk ka qenë i qëllimshëm pasi (është shprehur ai):*“unë kam qenë transparent duke vënë në dispozicion të ILDKPKI-së kontratën e blerjes së makinës ku tregohen të gjitha elementet që përbëjnë shumën, por kjo është pasojë e moskuptimit të terminologjisë në kontratën në gjuhën anglisht dhe interpretimit të këtij dokumenti. Ky dokument i është vënë në dispozicion edhe ILDKPKI-së bashkëlidhur deklarimit periodik për vitin 2015, ashtu si dhe të ardhurat nga puna të djemve K. dhe E., por këto dokumente nuk janë pranuar prej tyre në momentin e deklarimit”*. Bashkëlidhur ka depozituar shkresën nr. ***, datë 13.10.2020, të Autoritetit Përgjegjës në Prokurorinë e Përgjithshme për zbatimin e ligjit nr.9049/2003, me të cilën synon të provojë faktin e kthimit të dokumentacionit provues bashkëlidhur deklaratave periodike vjetore nga ILDKPKI-ja.

Subjekti, gjithashtu, ka sqaruar se:*“... duke qenë se deklarimi është bërë në formën e ‘Deklarimit të detyrimeve’, është deklaruar vlera e kredisë dhe vlera e mbetur pashlyer. Treguesit e tjerë të përfshirë si çmimi i blerjes dhe kostot e shërbimeve të përfshira në kontratë, kam qenë në pamundësi kuptimi dhe përshkrimi pasi kontrata ka qenë në anglisht. Burim i krijimit të kësaj pasurie dhe i pagesave të kredisë janë të ardhurat e djalit K. nga puna në shoqërinë ‘A.S.LLC’”*.

Subjekti ka qartësuar se përveç vlerës së automjetit/njesisë, në shumën totale përfshihen edhe kosto shtesë siç janë shërbimet e mirëmbajtjes dhe kostot e dokumentacionit.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit, dokumentacionit të administruar si dhe sqarimeve apo qartësimeve të bëra në prapësime, arsyeton si vijon:

Trupi gjykues vlerëson se subjekti ka deklaruar saktë kredinë e marrë nga djali i tij K. L. në SHBA, qëllimin e kredisë për blerje automjeti, si dhe këstet e paguara. Gjithashtu, trupi gjykues i quan bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me paqartësitë e të dhënave për t’i deklaruar ato ekzaktesisht, pasi krahasuar me kontratën e blerjes së automjetit ku evidentohet çdo zë i çmimit të blerjes, akt i depozituar në deklaratën *Vetting*, arrihet të kuptohet se disa prej zërave si

⁷⁶Aneks 4/15 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁷⁷Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016.

shpenzime administrative apo pagesa për mirëmbajtje automjeti, siguracione, etj., nuk kanë qenë qëllim mosdeklarimi por se nuk i është kushtuar vëmendje saktësisë së tyre, ku lehtësisht mund të ishin ezauruar nëpërmjet komunikimit me djalin e tij për të pasqyruar çdo zë dhe shumën që përfaqësonte.

Trupi gjykues, pasaktësinë në mosdeklarimin e vlerës së automjetit, përse kohë ajo është evidente në kontratën e blerjes së pasurisë, nuk mund ta rendisë parësore dhe përderisa në analizën financiare të kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor për vitin 2015 ka përfshirë çmimin e blerjes së automjetit sipas kontratës, kredinë e marrë si dhe këstet e paguara dhe në përfundim, nga përllogaritjet përkatëse, nuk i rezultuan balanca negative.

Deklarimi i djalit të subjektit – E.L.

18. Gjatë hetimit administrativ Komisionit i rezultoi se djali i subjektit E.L. ka nënshkruar autorizimin dhe ka deklaruar se disponon pasuri veçmas të regjistruara në emrin e tij, por nuk ka fletë të tjera të formularit, të plotësuara apo të firmosura.

Komisioni mbajti korrespondencë me institucionet në Shqipëri dhe nga verifikimi i tyre nuk u konfirmua pasuri në emër të shtetasit E.L. .

GJETJE TË TJERA

19. Nga analizimi i dokumentacionit të administruar, Komisionit i ka rezultuar se subjekti gjatë periudhës 2011 – 2012 nuk ka kryer investime në pasuri të luajtshme ose të paluajtshme, por shpenzimet familjare kanë rezultuar më të larta sesa të ardhurat.

19.1 Komisionit, nga analiza financiare, i rezultoi se subjekti gjendet në pamundësi financiare në shumën 768.731 lekë për periudhën 2011 – 2012, për të përballuar shkollimin e fëmijëve jashtë vendit, të mbajë të pandryshuar gjendjen *cash*, si dhe të plotësojë të gjitha shpenzimet e tjera familjare dhe, për pasojë, subjektit iu kalua barra e provës⁷⁸ për të argumentuar e provuar mbi këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni

Subjekti, ndër të tjera, në parashtrimet e tij ka shpjeguar si vijon:

“i) Për vitin 2011:

- Vlera e shpenzimeve të jetesës në SHBA për djalin K. L. është llogaritur në vlerën 353.069 lekë. Lidhur me këtë fakt, vlera e saktë për shpenzimet e jetesës do të ishte rreth 164,000 lekë ose 1,541.62 USD, bazuar në standardin e Planit të Ushqimit (Food Plans), të publikuara nga Shërbimi i Ushqimit dhe Nutricionit (Food and Nutrition Service) i Departamentit të Agrikulturës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës (U.S. Department of Agriculture/USDA) në adresën <https://www.fns.usda.gov/cnpp/usda-food-plans-cost-food-reports-monthly-reports>, që përmbajnë të dhëna zyrtare në lidhje me mesataren e kostos së ushqimit ndër vite në SHBA, duke u bazuar në rekomandimet bazë të ushqimit sipas Referencave Dietike 1997-2005 (Dietary Reference Intakes), Udhëzimet Dietike për Amerikanët 2005 (Dietary Guidelines for Americans) dhe MyPyramid 2005.

⁷⁸Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe paragrafët 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

- Vlera e shpenzimeve nga sistemi TIMS për vitin 2011 është llogaritur në shumën 317.745 lekë. Lidhur me këtë fakt, vlera e saktë për shpenzimet nga sistemi TIMS do të ishte rreth 232.000 lekë referuar udhëtimeve të kryera nga familjarët nga ku rezultojnë tre udhëtime të djalit K. (Shqipëri-SHBA) me vlerë totale 1.800 USD të konvertuar në vlerë 190.000 lekë, si dhe udhëtime të deklaruara në sistemin TIMS të kryera nga bashkëshortja dhe djali K. në vlerën 305 euro të konvertuar në vlerën 42.000 lekë. Këto udhëtime janë pasqyruar edhe në tabelën e të dhënave nga sistemi TIMS për vitin 2011.

- Vlera e shpenzimeve të akomodimit në SHBA për vitin 2011 është llogaritur në shumën 183.890 lekë. Lidhur me këtë fakt, vlera e saktë për shpenzime akomodimi në SHBA për vitin 2011 do të ishte rreth 147.000 lekë. Sipas vlerës së paraqitur në materialin 'Rezultati i hetimit administrativ' vërej se llogaritja është kryer duke pasur parasysh tarifën mujore të qirasë së deklaruar, të kombinuar me periudhën 5-mujore gusht-dhjetor 2011, ndërkohë që djali K. ka paguar qira mujore për 4 muaj (shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor), pasi në muajt maj, qershor, korrik, gusht të pushimeve verore për vitin 2011, gjatë qëndrimit në SHBA është akomoduar në familjen e shtetas B.K. (L.) në W. MA, e cila ka mbuluar edhe shpenzimet e jetesës për këtë periudhë, të trajtuara më sipër. Kjo edhe për faktin e provuar me kalendarët⁷⁹ e viteve akademike të W***, bashkëlidhur, përkatësisht, i vitit akademik 2010 -2011 provon se ky vit ka përfunduar në datën 2.5.2011 dhe i vitit akademik 2011-2012 provon se ky vit akademik ka filluar në datën 25.8.2011.

-Në vështrim të shpjegimeve dhe argumenteve të parashtruara më sipër, vlerësoj se totali i shpenzimeve për vitin 2011 ka nevojë të rishikohet, duke reflektuar diferencën në ulje të shpenzimeve për vlerën 311.550 lekë.

-Ky saktësim i reflektuar në analizën financiare për vitin 2011 do të sjellë një reduktim në mungesën e burimeve financiare në vlerën 159.038 lekë.

-Krahas vlerës në ulje të shpenzimeve më sipër, vlerësoj se ka nevojë të rishikohet vlera 2.266,260 lekë për pagesat e shkollës për djalin K., duke llogaritur me kursin e këmbimit lekë-dollar në nivelet më të ulëta për vitin 2011 (muajt prill, maj, qershor, gusht) që përgjithësisht e kam realizuar për të ulur sa më shumë shpenzimet për shkollimin.

ii) Për vitin 2012:

- Vlera e shpenzimeve të jetesës në SHBA për djalin K. është llogaritur në vlerën 358.075 lekë. Lidhur me këtë fakt, vlera e saktë për shpenzimet e jetesës do të ishte rreth 164.000 lekë ose 1.546.01 USD, bazuar në standardin e Planit të Ushqimit (Food Plans), të publikuara nga Shërbimi i Ushqimit dhe Nutricionit (Food and Nutrition Service) i Departamentit të Agrikulturës së SHBA-së(U.S. Department of Agriculture/USDA) në adresën <https://www.fns.usda.gov/cnpp/usda-food-plans-cost-food-reports-monthly-reports>, e llogaritur në vlerën përfundimtare të totalit vjetor për vitin 2012⁸⁰ sipas të dhënave në tabelën e mëposhtme.

- Vlera e shpenzimeve të akomodimit në SHBA për vitin 2012 është llogaritur në shumën 335.696 lekë. Lidhur me këtë fakt, vlera e saktë për shpenzime akomodimi në SHBA për vitin

⁷⁹Kalendarët vjetorë për referencë gjenden këtu: <https://www.wpi.edu/academics/calendar-catalogs/past-catalogs>
Kalendarët për vitet 2009 – 2013, f. 3 ose 4 (Undergrad Calendar):

<https://www.wpi.edu/sites/default/files/docs/Academic-Resources/Academic-Catalogs/ugrad0910.pdf>

⁸⁰Shihninë muajt maj, qershor, korrik, gusht, të pushimeve verore të vitit 2012, djali K. L. gjatë qëndrimit në SHBA është akomoduar në familjen e shtetas B. K.(L.) në W*** MA, e cila ka mbuluar edhe shpenzimet e jetesës, të provuar me deklaratën personale të saj.

2012 do të ishte rreth 298.596 lekë. Sipas vlerës së paraqitur në materialin “Rrezultati i hetimit administrativ” vërej se llogaritja është kryer duke pasur parasysh tarifën mujore të qirasë së deklaruar, të kombinuar me periudhën 9-mujore 2012, ndërkohë që djali K. ka paguar qira mujore për 8 muaj, pasi në muajt maj, qershor, korrik, gusht të pushimeve verore për vitin 2012, gjatë qëndrimit në SHBA, është akomoduar në familjen e shtetasës B. K. (L.) në W. MA, e cila ka mbuluar edhe shpenzimet e jetesës për këtë periudhë, të trajtuara më sipër. Kjo edhe për faktin e provuar me kalendarët e viteve akademike të W***, bashkëlidhur, përkatësisht, i vitit akademik 2011-2012 provon se ky vit ka përfunduar në datën 30.4.2011 dhe të viteve akademike 2012 – 2016 provon se ky vit akademik ka filluar në datën 23.8.2012.

Në vështrim të shpjegimeve dhe argumenteve të parashtruara më sipër, vlerësoj se totali i shpenzimeve për vitin 2012 ka nevojë të rishikohet, duke reflektuar diferencën në ulje të shpenzimeve për vlerën 156.900 lekë.

-Ky saktësim i reflektuar në analizën financiare për vitin 2012 do të sjellë një reduktim në mungesën e burimeve financiare në vlerën 67.043lekë.

-Krahas vlerës në ulje të shpenzimeve më sipër, vlerësoj se ka nevojë të rishikohet vlera 2,064,154 lekë për pagesat e shkollës për djalin K., duke e llogaritur me kursin e këmbimit lekë-dollar në nivelet më të ulëta për vitin 2012 (muajt shkurt-mars) që, përgjithësisht, e kam realizuar për të ulur sa më shumë shpenzimet për shkollimin.

Bazuar në rrethanat e reja të faktit të mbështetura në provat shkresore bashkëlidhur, për shpenzimet e jetesës dhe shpenzimet e sistemit TIMS, parashtroj uljen e nivelit të gjendjes së pamundësisë financiare si më poshtë:

-Llogaritja e shpenzimeve të jetesës së djalit K. në vitet 2011 dhe 2012 sipas standardeve shtetërore në SHBA, shpenzimet e sistemit TIMS për këto dy vite sipas praktikës njësuere të KPA-së dhe shpenzimet në marrëdhënie qiraje, evidenton faktin se mungesa e burimeve financiare për vitet 2011 dhe 2012 është në vlerën 226.081 lekë, pa llogaritur gjendjen cash.

-Kjo rrethanë e re fakti, e provuar me provat e reja shkresore që kërkoj të administrohen, evidenton nevojën për të rishikuar llogaritjen e mungesës së burimeve financiare për këto dy vite.

-Në vitet 2003 – 2016 të gjitha shpenzimet familjare të deklaruara i kam përballuar me të ardhurat e mia, bashkëshortes dhe kontributin e fëmijëve, nga burimet e ligjshme të deklaruara, duke menaxhuar të ardhurat dhe kursimet në mënyrën më ekonomike të mundshme”.

Analiza e provave dhe fakteve në raport me ligjin e zbatueshëm

Trupi gjykues, në analizë të deklarimeve të subjektit, përgjigjeve në pyetësorë, provave të administruara, si dhe shpjegimeve në rezultatet e hetimit administrativ, arsyeton si vijon:

Lidhur me sqarimet/pretendimet e subjektit është marrë në konsideratë pretendimi për shpenzimet e qirasë, duke ulur këtë shpenzim me një muaj, përkatësisht në vitet 2011 dhe 2012, duke u bazuar në kalendarin shkollor të depozituar nga subjekti, ku sipas këtij kalendari provohet periudha e shkollimit dhe koha që djali ka qëndruar me qira dhe pas përfundimit të vitit akademik (pushimet verore) ka qëndruar te e afërmja e tyre, shtetasja B.K. (L.), ose ka ardhur në Shqipëri.

Lidhur me shpenzimet e jetesës, trupi gjykues nuk e ka marrë në konsideratë këtë pretendim, pasi i ka qëndruar deklaramit të subjektit gjatë hetimit administrativ dhe jo Planit të Ushqimit (Food Plans), i publikuar nga Shërbimi i Ushqimit dhe Nutricionit (Food and Nutrition Service) të Departamentit të Agrikulturës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për shkak se kjo provë është një statistikë orientuese mbi shpenzimet e mundshme. Për sa kohë që subjekti e ka deklaruar gjatë hetimit se sa kanë qenë shpenzimet e jetesës, trupi gjykues e ka marrë të mirëqenë atë deklaram dhe vlerëson se kjo provë e depozituar në prapësime duket se nuk mund t'i vishet nivelit të jetesës së studentit në këtë rast.

Në lidhje me shpenzimet e sistemit *TIMS*, u vërejt se as ky zë nuk ka ndryshime, pasi gjatë vitit 2011 nuk janë vetëm udhëtimet e djalit K. dhe bashkëshortes së subjektit, por edhe djali tjetër E. ka pasur lëvizje.

Si rezultat i ndryshimit të shpenzimeve të qirasë për vitet 2011 dhe 2012, trupi gjykues, nga përlllogaritjet e kryera nga Njësia e Shërbimit Ligjor, konkludoi se balanca e re negative është në shumën 694.654 lekë (433.810 lekë në vitin 2011 dhe 260.844 lekë në vitin 2012), balancë e cila nuk vlerësohet si masë penalizuese në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, parë kjo edhe në harmoni me veprimet konkludente të subjektit, për të qenë i vërtetë dhe i saktë në deklaramet e tij.

20. Në lidhje me gjendjen *cash*

20.1 ILDKPKI-ja, në raportin e saj, është shprehur: *“Në deklaramtën ‘Para fillimit të detyrës 2003’, subjekti (dhe bashkëshortja) ka deklaruar gjendje cash dhe nuk ka deklaruar ndryshime të saj në deklaramtat e interesave private ndër vite. Në deklaramtën Vetting nuk ka deklaruar gjendje cash”.*

20.2 Gjatë hetimit, Komisionit i ka rezultuar se subjekti në deklaramtën periodike të vitit 2003 e ka depozituar dy herë formularin A-5 Likuiditete, por me shuma të ndryshme. Përkatesisht ka deklaruar *cash* shumat 3.000.000 lekë dhe 2.000.000 lekë.

20.3 Gjithashtu, për sa i përket gjendjes *cash* rezulton që përveç shumës së deklaruar në vitin 2003 subjekti nuk ka kryer më deklarime në lidhje me shtesat apo pakësimet deri në vitin 2015, ku në këtë vit (2015) deklaroi ekzaktesisht: *“1.000.000 lekë, gjendje cash nga kursimet e mia dhe të bashkëshortes të mbartura nga puna e deklaruar për vitin 2015”.*

20.4 Komisioni e ka pyetur⁸¹ subjektin:(i)mbi këto deklarime;(ii)nëse e ka mbartur apo jo këtë gjendje *cash*; si dhe (iii) cili ka qenë përdorimi i tyre. Në vijim, në përgjigjen e dhënë, subjekti ka shpjeguar se: *“... në momentin e dorëzimit të deklaramtës, përfaqësuesi i Inspektoratit të ulët në Prokurorinë e Përgjithshme, më ka pyetur nëse kisha pasqyruar në deklaramtë kursimet (gjendjen cash, në llogari rrjedhëse apo në depozitë, etj.) të mbartura nga periudha deri në fund të vitit 2003, të cilin e kam sqaruar se te formulari-A5 kam deklaruar gjendje cash në shumën 2 milionë kurse nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes gjatë vitit 2003. Ndërkohë, përfaqësuesi i Inspektoratit të ulët më ka kërkuar të deklaram kursimet e mbartura deri në vitin 2003, duke më sqaruar se kursimet për vitin 2003 dalin nga shuma e të ardhurave të deklaramta duke zbritur shpenzimet... Kursimet nga të ardhurat, si balancë e të ardhurave*

⁸¹ Pyetësor nr. 3, datë 18.3.2020.

të deklaruar minus shpenzimet e deklaruar etj., nuk janë deklaruar vit pas viti për mungesë dhe të udhëzimeve të qarta nga punonjësi i ngarkuar në cilësinë e përfaqësuesit të Inspektoratit të ulët në Prokurorinë e Përgjithshme i ngarkuar për të bërë sqarimet e nevojshme dhe për administrimin e deklarimeve të pasurisë në Prokurorinë e Përgjithshme. Por çmoj se duke deklaruar të ardhurat dhe burimet e tyre, si dhe shpenzimet për kredi, blerje/shitje autoveture dhe shkollimin e djemve vit pas viti, etj., evidentohen edhe kursimet vit pas viti... Sqaroj se gjendja cash, e mbartur në vitin 2003, vit pas viti plus të ardhurat e mia dhe bashkëshortes dhe minus shpenzimet e deklaruar në deklaratat periodike vjetore ka pasur rritje dhe ulje, sipas balancës vit pas viti, kursime plus të ardhura minus shpenzime. Në mars të vitit 2013 që ka filluar punë djali K., i cili me të ardhurat nga puna të deklaruar periodikisht sipas viteve, ka dhënë kontribut të përbashkët familjar në mbulimin e shpenzimeve për jetesë/udhëtimet e djalit E., ashtu për shkollimin e djalit E. të deklaruar sipas viteve. Gjendja cash në deklarinin për vitin 2015, pjesërisht ka qenë e mbartur dhe pjesa tjetër e krijuar nga të ardhurat e mia dhe të bashkëshortes, si dhe nga kursimet gjatë vitit 2015.”

20.5 Komisioni, në analizën financiare të kryer, ka marrë në konsideratë deklarinin e parë të subjektit dhe atë gjendje *cash* e ka mbartur deri në vitin 2014, për sa kohë që nuk është deklaruar asnjë ndryshim i kësaj shume, shtesë apo pakësim.

20.6 Në bazë të këtyre deklarimeve, Komisioni hetoi nëse subjekti ka pasur mundësi të krijonte shumën 3.000.000 lekë deri në fund të vitit 2002 dhe pasi kreu përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor analizën financiare, i rezultoi se subjekti kishte pasur mundësi të kursente këtë shumë, si dhe të përballonte shpenzimet familjare për periudhën 1991 – 2002.

20.7 Sa i përket deklarimeve të subjektit për gjendjen *cash* ndër vite, trupi gjykues analizon lidhjen mes deklarinimit të fundit periodik dhe deklaratës *Vetting*. Nisur nga fakti se subjekti ka deklaruar në vitin 2015 gjendjen *cash* në shumën 1.000.000 lekë dhe nuk deklaroi asnjë ndryshim lidhur me këtë shumë (pra shtesë apo pakësim të saj), në deklaratën pasardhëse, Komisioni i ka qëndruar strikt këtij deklarinimi kur ka kryer analizën financiare për vitin 2016 duke përfshirë këtë shumë si gjendje *cash* në fund të këtij viti. Trupi gjykues çmon të argumentojë mbi vijueshmërinë e kësaj shume në raport me shpenzimet e kryera nga ana e subjektit dhe familjes së tij në tërësi, në harkun kohor: viti 2016 deri në deklaratën *Vetting*. Fakti që në deklaratën *Vetting* subjekti vjen me gjendje 0 (zero) të likuiditeteve *cash*, presupozohet që kjo shumë është shpenzuar deri në këtë deklarinim. Ky argument bëhet bindës edhe me deklarinin e subjektit se: “*Mosdeklarinimi i ndryshimit të gjendjes cash nuk ka qenë i qëllimshëm, por ka ardhur si rezultat i paqartësisë në plotësimin e deklaratave periodike vjetore të pasurisë lidhur me lëvizjen e gjendjes cash*”. Kjo pasaktësi mes gjendjes *cash* në vlerën 1.000.000 në vitin 2016 dhe vlerës 0 (zero) në deklaratën *Vetting* nuk mund të konsiderohet problematikë në rëndim të pozitës së subjektit, për sa kohë që kjo vlerë përbëhet nga burim i ligjshëm krijimi dhe nuk është përdorur për ndonjë investim të mundshëm në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme, por ka pasur si destinacion vetëm shpenzime familjare. Gjithashtu, edhe fakti që në deklaratën *Vetting* nuk pasqyrohet një vlerë më e madhe sesa vlera 1.000.000 lekë gjendje *cash*, që mund të përbënte dyshime të arsyeshme lidhur me krijimin e saj brenda një kohe shumë të shkurtër, atëherë trupi gjykues nuk i jep vlerë këtij konstatimi në

vlerësimin tërësor të subjektit. Ky arsyetim është prirur edhe nga qëndrimi i mbajtur nga Kolegji i Posaçëm i Apelit në vendimmarrjen⁸² e tij.

21. Nga hetimi, në dokumentacionin e dërguar nga DRT-ja Tiranë⁸³ Komisionit i ka rezultuar një kontratë huapërdorje për pasuri të paluajtshme mes bashkëshortes së subjektit znj. F.L. (huapërdorëse) dhe shoqërisë “B.S.” me administrator shtetasin E. A. (qiramarrësi).

21.1 Kontrata është parashikuar me afat, konkretisht nga data e nënshkrimit të saj 1.1.2012 deri më 31.12.2017.

Në kontratë është parashikuar arsyeja e dhënies në huapërdorje të pasurisë, më konkretisht citohet: *“Qiramarrësi këtë pronë ia lëshon në huapërdorje për nevoja pune dhe bashkëpunimi av.F.L. për t’u përdorur për biznesin e saj.”*

21.2 Komisionit i ka rezultuar se shtetasi E. A. është gjithashtu edhe administrator i shoqërisë “P***o” sh.p.k., ku bashkëshortja e subjektit ka punuar në vitet 2009 dhe 2011 si konsulente ligjore me kontratë shërbimi.

21.3 Nga pikëpamja ligjore kontrata ka të parashikuar palët, shprehjen e vullnetit të ndërsjellë të palëve për ta lidhur atë, afatin e përdorimit të pasurisë, të drejtat dhe detyrimet e njëri-tjetrit për sa kohë kjo kontratë do të ishte e vlefshme, pra, në tërësi nuk konstatohen problematika.

21.4 Subjekti është pyetur⁸⁴ në lidhje me këtë marrëdhënie kontraktore dhe në përgjigjen e dhënë, ndër të tjera, ka shpjeguar se bashkëshortja e tij ka punuar si avokate në një nga ambientet e apartamentit 2+1, të marrë me qira nga shoqëria “B. S.”, ambiente të cilat janë përdorur edhe nga kjo shoqëri për nevojat e saj. Subjekti ka deklaruar se arsyeja e dhënies në huapërdorje të këtij ambienti pune, ka qenë nevoja e kësaj shoqërie për konsulta me karakter ligjor, të cilat i janë ofruar nga bashkëshortja pa shpërblim. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar⁸⁵ se veç kontratës së huapërdorjes bashkëshortja e tij nuk ka pasur kontratë tjetër me shoqërinë “B.S.A.” dhe se siç është përcaktuar në kontratën e huapërdorjes ka ritheksuar se ajo i ka ofruar kësaj shoqërie konsulta/shërbime me karakter ligjor pa kundërshtëpërblim.

21.5 Trupi gjykues vlerëson se nënshkrimi i kësaj kontrate identifikon thjesht dhe vetëm ushtrimin e profesionit të lirë të avokatisë, ushtruar nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, aktivitet privat, i regjistruar pranë zyrave tatimore, për të cilën ka kryer rregullisht deklaratimet, ka paguar detyrimet tatimore, si dhe ka identifikuar ambientin e punës. Marrëdhënia e bashkëshortes së subjektit me një të tretë është krijuar për shkak të punës dhe rolit të saj, qoftë si Person Fizik, por edhe për shkak të shërbimit të ofruar qiradhënësit, i cili në fakt e ka pasur vetë të nënkontraktuar nga një qiradhënës tjetër. Trupi gjykues nuk krijoi dyshime lidhur me dokumentacionin e administruar dhe as me shpjegimet e dhëna nga subjekti.

B. KONTROLLI I FIGURËS

⁸²Nr. 28, datë 23.10.2020, më konkretisht arsyetimit të bërë në pikën 8.15.

⁸³Shkresë nr. ***prot., datë 23.10.2019, nga DRT-ja Tiranë.

⁸⁴Me pyetësorin nr. 4, datë 27.4.2020 dhe pyetjet drejtuar me e-mail në datat 27, 28 dhe 29.4.2020.

⁸⁵Në pyetësorin nr. 6, datë 26.6.2020 dhe dokumentacioni bashkëngjitur.

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte, nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar raportin nr*** prot., datë 30.10.2017 mbi kontrollin e figurës, deklasifikuar me vendimin nr. ***, datë 8.4.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar:

Përshtashmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Kujtim Luli.

Hetimi i Komisionit

Nga verifikimi i deklaratës (shtojca nr.3) së plotësuar nga subjekti i rivlerësimit për kriterin e figurës, u konstatua se subjekti ka deklaruar në pjesën 5 titulluar “Të dhëna për sigurinë”, në gjuhën “b” *“Djali i motrës – A. – A. K.P. është dënuar për veprën penale ‘trafikimi i narkotikëve’, mbetur në tentativë, sipas nenit 283/a/1 – 22 të Kodit Penal. Djali i vëllait – G.– A.L. është dënuar për veprën penale ‘Shtrëngim me anë të kanosjes ose dhunës për dhënie pasurie, në bashkëpunim, sipas nenit 109/b/1 e 25 të Kodit Penal’.*

Komisioni, si organi i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të lartpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016.

Nga hetimi i Komisionit nuk u gjet asnjë element që të vërtetojë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Në adresë të Komisionit është dërguar një denoncim⁸⁶ anonim në përmbajtje të të cilit thuhej se shtetasi Kujtim Luli është xhaxhai i shtetasit A.L. dënuar për krim të organizuar/ kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

Komisioni e njohu subjektin me këtë denoncim, i cili në shpjegimet e tij⁸⁷ është shprehur se:

Në deklaratën për kontrollin e figurës dorëzuar me nr. *** prot., datë 28.1.2017, në DSIK, në shtojcën nr. 3, në pjesën 5, tëpyetjes: *“A keni dijeni se një nga anëtarët e familjes suaj është përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar?”* i është përgjigjur alternativës “po”, si dhe kërkesës së radhës i është përgjigjur me shkrim duke deklaruar të dhënat e identitetit të secilit prej tyre (A. K. P.dhe A.L.), lidhjen familjare dhe akuzat për të cilat janë akuzuar e deklaruar fajtorë dhe dënuar nga gjykata, duke u bazuar në të dhënat e publikuara në faqen zyrtare elektronike të ish-Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë, për të mundësuar plotësimin e kësaj rubrike lidhur me akuzat ndaj secilit prej nipërve. Në vijim ai ka deklaruar

⁸⁶Nr. *** prot., datë 16.10.2020.

⁸⁷Konfidenciale, datë 20.10.2020.

se deklarimi është bërë në zbatim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, që u referohet veprave të parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10129/2009, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

Në deklaratën për kontrollin e figurës, gjithashtu, në përgjigje të pyetësorit në vijim ka deklaruar dhe ritheksuar se nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në asnjë formë apo mënyrë komunikimi me persona të përfshirë në krimin e organizuar, përfshi edhe dy nipërit; nuk ka pasur dhe as nuk ka dijeni se anëtarë të familjes, përfshirë edhe dy nipërit, kanë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, që në momentin e arrestimit rreth fundvitit 2013 të djalit të motrës, e cila jeton familjarisht në Shkodër dhe të arrestimit rreth fillimvitit 2015 të djalit të vëllait që jeton familjarisht në Tiranë, personalisht i ka mbajtur qëndrim dhe nuk ka shkuar në banesat ku motra dhe vëllai jetojnë/nin me djemtë e dënuar për të shmangur çdo kontakt me ta. Gjithashtu, me djalin e motrës, prej fundvitit 2013 dhe me djalin e vëllait prej fillimvitit 2015 ka deklaruar se është distancuar dhe ka shmangur takimet me secilin prej tyre, duke mos marrë pjesë edhe në evenimentet familjare që ata kanë pasur. Këtë mënyrë sjelljeje në marrëdhëniet me dy nipërit e dënuar për veprat penale të sipërpërmendura e ka motivuar si distancim ndaj tyre për të shmangur çdo cenim që mund t'i shkaktojnë lidhjeve të afërta familjare.

Edhe në seancë dëgjimore subjekti ka sqaruar se e quan keqdashës dhe cinikdenoncimin anonim dhe se deklarata për kontrollin e figurës, në zbatim të nenit 34 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar verifikimit nga DSIK-ja, institucion i cili ka kryer kontrollin e figurës së subjektit dhe në raportin e dërguar në Komision, “Mbi kontrollin e figurës”, ka përfunduar, ka përshkruar konkluzionet të cilat u cituan edhe në raportin e mbajtur nga relatorja në këtë seancë.

Ndërkohë, tej këtyre shpjegimeve të subjektit, Komisioni i kërkoi Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si dhe Gjykatës së Lartë dërgimin e dosjeve gjyqësore të shtetasve A. P. dhe A. L., me qëllim verifikimin e ndonjëinterferimi të mundshëm të subjektit në dënimin e këtyre shtetasve për shkak të pozicionit të tij apo përmes ushtrimit të profesionit të bashkëshortes.

1. Gjykata e Shkallës së Parë⁸⁸ për Krime të Rënda ka dërguar dosjen gjyqësore në ngarkim të të dënuarit A. P. .

Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore⁸⁹, ndër të tjera, u konstatua se prokurori në kërkimin e tij për të deklaruar fajtor të pandehurin ka cituar se: *“Masa e dënimit që duhet t'i jepet ndaj tij duhet t'i përgjigjet rolit të saj ndëshkues, edukues e parandalues... faktin që vepra penale mbeti e paralizuar, mbeti në tentativë... gjithashtu në dhënien e masës së dënimit ndaj*

⁸⁸Me shkresën nr. *** prot., datë 22.10.2020.

⁸⁹i. Sipas vendimit të Regjistrimit të Procedimit Penal datë 25.11.2013 (akt i administruar në dosjen hetimore) thuhet se materiali është referuar e përcjellë nga Sektori kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve, pranë Drejtorisë së Policisë së Qarkut Durrës. Po në këtë akt pasyrohet fakti se drejtuesi i automjetit (më tej i pandehuri dhe i dënuari) është arrestuar në flagrancë të kryerjes së veprës penale “trafikim i narkotikëve”, mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 283/a dhe 22 të Kodit Penal.ii. I pandehuri është mbrojtur në këtë çështje nga av. M.P. . iii. Në caktimin e masës së sigurisë i pandehuri është mbrojtur nga av. Gj.N. . iv. Diskutimi përfundimtar (akt i administruar në dosjen gjyqësore) në shkallë të parë është dhënë nga prokurori i çështjet z. B.D. (edhe veprimet hetimore janë kryer nga i njëjti prokuror).

tij, kemi parasysh dhe qënien e tij person i padënuar dhe moshën e tij të re” dhe në përfundim ka kërkuar, bazuar në kërkesat e neneve 378/1, 190/1 dhe 393 të Kodit të Procedurës Penale:

Deklarimin fajtor të të pandehurit A.P., për kryerje të veprës penale ‘trafikim i narkotikëve’, mbetur në tentativë⁹⁰, parashikuar nga neni 283/a, paragrafi 1 e 22 i Kodit Penal dhe dënimi i tij me 7 vjet e 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale zbritjen me 1/3 e dënimit me burgim dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim... ”

Analiza e provave

Duke iu referuar veprimeve që duhet të ndodhin gjatë kryerjes së kësaj vepre penale si importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, për sa kohë provohet se nuk kanë mundur të realizohen, atëherë në mënyrë të drejtpërdrejtë veprës i vishet edhe tentativa si parashikim i bërë nga ligjvënësi për të rregulluar dhe provuar situata/ngjarje të tilla. Në këtë kontekst është e kuptueshme që ekzistenca e veprës penale në këtë rast ndërlidhet me tentativën dhe kuptimin e saj dhe, për pasojë, trupi gjykues nuk konstaton asnjë favorizim të mundshëm në dënimin e dhënë duke hamendësuar se një veprim i tillë mund të kishte ndodhur nga ndikimi i subjektit për shkak të detyrës.

Në analizë të dokumentacionit, trupi gjykues konstaton se në kohën që është arrestuar apo edhe dënuar shtetasi A.P., subjekti ushtronte detyrën në Prokurorinë e Përgjithshme.

Trupi gjykues vëren se ndaj të pandehurit organi i akuzës ka parashtruar diskutimin përfundimtar ku dhe ka kërkuar dënimin përkatës, bazuar në ligjin penal në referencë të parashikimit konkret për kryerjen e veprës penale.

Në të tilla kushte nuk rezultoi ndonjë provë apo rrethanë që implikon subjektin e rivlerësimit në këtë çështje penale, për shkak të detyrës së tij, në favor të lidhjes familjare.

2. Gjykata e Lartë⁹¹ ka dërguar dosjet gjyqësore edhe në çështjen në ngarkim të shtetasit A.L.

Nga aktet e administruara rezultoi si vijon:

Me vendimin nr. ***⁹², datë 14.9.2016 i akuzuari A.L. është deklaruar fajtor për kryerjen e veprës penale “shtrëngimit me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 109/b/2 dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 7 vjet burgim.

Në diskutimet përfundimtare prokurori E.N. ka kërkuar deklarin fajtor të të gjithë të pandehurve dhe dënimin e tyre me nga 7 vjet burg secili për veprën penale parashikuar nga nenet 109/b/2 e 25 të Kodit Penal.

I dënuari A. L.⁹³ ka ushtruar ankim (nënshkruar nga përfaqësuesi i tij av. A.V.), në Gjykatën e Apelit⁹⁴ për Krime të Rënda Tiranë, me objekt “prishje e vendimit nr. ***, datë 14.9.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe pushimin e çështjes”.

⁹⁰Ngjarje e ndodhur në datën 24.11.2013.

⁹¹Me shkresën nr. ***prot., datë 13.11.2020.

⁹²Shihni dosjen gjyqësore, vol. VII.

⁹³Shihni dosjen gjyqësore, vol. VIII.

⁹⁴Gjykata e Apelit për Krime të Rënda (shihni dosjen gjyqësore vol. IX) me vendimin⁹⁴ e saj nr. 1, datë 6.1.2017, për të pandehurin A. L. ka vendosur dënimin e tij me 2 vjet e 6 muaj burgim dhe në aplikim të nenit 59 të Kodit Penal, pezullimin e

I pandehuri në diskutimin përfundimtar është përfaqësuar nga av. A. V. dhe av. F. L. .

Në konkluzion, organi i akuzës ka kërkuar lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 14.9.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë është ushtruar rekurs⁹⁵ nga organi i akuzës (Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Për krime të Rënda përfaqësuar nga prokurori A.B.) kryesisht nisur nga ndryshimi i cilësimit juridik të veprës, duke kërkuar prishjen e vendimit të apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë.

Aktualisht, çështja vijon të jetë për gjykim në Gjykatën e Lartë.

Analiza e provave

Përsa kohë mbrojtja e të pandehurit nuk është prezantuar me statusin e një të afërmi të familjes, por në cilësinë e avokates dhe nisur nga fakti se prokurorët që kanë ngritur akuzën dhe përfaqësuar çështjen në Gjykatën për Krime të Rënda të Shkallës së Parë dhe të Apelit, kanë kërkuar deklarimin fajtor dhe dënimin, për më tepër prokurori i apelit ka ushtruar rekurs kundër vendimit të Gjykatës së Apelit, nuk konstatohet asnjë favorizim i mundshëm nga prokurorët për të hamendësuar se një veprim i tillë mund të kishte ndodhur nga ndikimi i subjektit për shkak të detyrës.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit u pyet në seancë dëgjimore edhe në drejtim të faktit nëse bashkëshortja e tij ndante me të shqetësimet profesionale.

Subjekti, në përgjigjen e dhënë, ka mohuar faktin të kishin komunikim për aspektin profesional me bashkëshorten. Ai ka theksuar: *“...duhet të konfirmoj që secili nga ne në veprimtarinë e tij nuk merr angazhime dhe informacione për veprimtarinë që kryen. Ashtu si unë që nuk kam dashur të di për punën dhe çështjet e saj, ashtu edhe ajo as nuk ka dashur t’ia dijë, por edhe unë nuk kam pranuar edhe nëse ka dashur, që t’i jap informacion për punët e mia. Kjo është e..., ndoshta mund të perceptohet si e pabesueshme, por kjo ka qenë një ndër armët më të forta në veprimtarinë time, sepse po të ndash çështjen me bashkëshorten në shtëpi, me familjen, nuk je më pastaj prokuror, mos shko më në zyrë, mos shko më të përballesh me të pandehurit në sallë, mos shko më të bësh moral se si duhet zbatuar ligji në ushtrimin e funksioneve të tua si prokuror. Kjo ka qenë dhe ngelet e shenjtë për mua në gjithë jetën time. Nuk ka pasur shans të më afrohet njeri, të më ndërhyjë për çështje sepse unë vazhdimisht, sepse më nxorrët atje ku unë nuk desha të dal, kam qenë shumë strikt dhe nuk i kam krijuar mundësi askujt të më afrohet për të më kërkuar favor në çështje dhe në veprimtarinë time.”*

Fakti që bashkëshortja e subjektit ka marrë në mbrojtje këtë të pandehur është një e drejtë legjitime e avokatit për sa kohë ky nuk është rast sipas ligjit⁹⁶ kur avokati nuk lejohet të japë ndihmesë ligjore ose të përfaqësojë një person.

ekzekutimit të pjesës së mbetur të dënimit duke u vënë në provë i pandehuri për një periudhë prove prej 3 vjetësh, si dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës. Në zbatim të nenit 60 të Kodit Penal është urdhëruar i pandehuri të mos shoqërohet me të bashkëpandehurit e tjerë, si dhe “heqjen e masës së sigurimit” “arrest në shtëpi” të caktuar me vendimin nr.113, datë 1.7.2015, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë. Kjo gjykatë ka bërë ndryshimin e cilësimit juridik të veprës penale nga paragrafi i dytë në paragraf të parë “shtrengimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/b paragrafët 1 dhe 25 të Kodit Penal.

⁹⁵Shihni dosjen gjyqësore vol. X.

⁹⁶Ligjit të kohës “Për avokatinë”

Në mënyrën e të konceptuarit të këtij denoncimi vihet re se është synuar të pasqyrohet kontakti i papërshtatshëm i subjektit të rivlerësimit me nipërit e tij të dënuar, të cilët i kishte deklaruar në formularin (shtojca nr. 3). Ky është vetëm një element apo *indicie* që përveçse në bazë ka lidhjet familjare, të cilat subjekti nuk i zgjedh por ato vijnë natyrshëm, duhet që ky kontakt të provohet përmes shpeshësisë së takimeve, qëllimit të tyre dhe efektit që sjell funksioni/detyra e tij.

Trupi gjykues e quan bindës qëndrimin e subjektit në shpjegimet e tij lidhur me deklarin në deklaratën përkatëse mbi marrëdhënien e tij farefisnore, si dhe veprat penale për të cilat nipërit e tij akuzoheshin, si dhe më tej teksa deklaroi se jo vetëm nuk kishte mbajtur kontakte me ta prej ndodhivë, por kishte preferuar të mos ishte më pjesë e ceremonive familjare të motrës apo vëllait të tij.

Trupi gjykues, nën të gjitha argumentet e parashtruara dhe arsyetuara më sipër në lidhje me kontrollin e figurës, arrin në konkluzion se: (i) subjekti ka kryer deklarin të saktë dhe të vërtetë për sa kohë i ka deklaruar veprat penale, për të cilat janë dënuar nipërit e tij; (ii) të gjitha procedurat hetimore dhe gjyqësore të qartësuar në dosjet gjyqësore penale të dy nipërve të subjektit, në asnjë rast, nuk kanë pasqyruar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe as të tërthortë ndonjë *indicie* me sensin e ndërhyrjes së subjektit të rivlerësimit për të favorizuar të dënuarit në masën e dënimit për veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe dënuar; (iii) po ashtu, fakti që DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë dhe se përgjatë hetimit administrativ nuk rezultoi i provuar ndonjë informacion që ndikonte në pozitën e subjektit, me qëllim penalizimin e tij për vijimin e ushtrimit të detyrës, si dhe fakti që në të gjithë analizën e lartpërmendur nuk u provua denoncimi anonim, që mund të cenojë figurën e subjektit, trupi gjykues konkludon mbi provueshmërinë e përshtatshmërisë së subjektit për vijimin e ushtrimit të detyrës.

Një tjetër element i rëndësishëm që merr vlerë në vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit është edhe fakti i mosparaqitjes së asnjë denoncimi nga publiku, sikurse parashikohet nga neni 53 i ligjit nr. 84/2016.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Raporti është përgatitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

Raporti i vlerësimit profesional është mbështetur në: formularin e vetëdeklarimit; tri dokumente ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; të dhëna e dokumente që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLP-së.

Raporti i vlerësimit profesional⁹⁷, në analizë të gjetjeve⁹⁸, si dhe bazuar në të gjitha burimet e informacioneve për subjektin e rivlerësimit, nuk ka evidentuar problematika në aspektin e aftësive profesionale, organizative, etikën dhe integritetin e tij.

Të dhënat arkivore (ankesat dhe masat disiplinore- vlerësimet)

Nga verifikimi në arkivin e Prokurorisë së Përgjithshme nuk rezulton që subjekti Kujtim Luli të ketë pasur masa disiplinore.

Mbi bazën e kërkesës për informacion dërguar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i është kërkuar informacion strukturave përkatëse të Prokurorisë së Përgjithshme dhe të gjitha prokurorive pranë shkallës së parë. Në përgjigje të shkresave rezulton që subjekti i rivlerësimit të mos ketë pasur ankesa, kallëzime apo procedime penale në ngarkim të tij.

Sa i përket komponentëve mbi të cilët subjekti është vlerësuar ka rezultuar si vijon:

1. Aftësitë profesionale

a. Njohuritë ligjore

Përsa i përket vlerësimit në aspektin profesional, subjekti i rivlerësimit ka shfaqur aftësi shumë të mira në interpretimin dhe zbatimin e ligjit, analizën e jurisprudencës dhe arsyetimit ligjor e logjik. Ai identifikon normën ligjore penale ose procedurale penale të zbatueshme, jep kuptimin, interpretimin dhe arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në funksion të nxjerrjes së konkluzioneve për zbatimin e ligjit përdor referenca në jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese. Në rastet e çështjeve me natyrë procedurale përdor metodat e interpretimit për të nxjerrë thelbin e institutit procedural që është në diskutim, ndërsa në rastin kur problematika lidhet me zbatimin e ligjit material i kushton rëndësi çdo elementi të veprës penale për të konkluduar në kualifikimin e faktit penal sipas normës penale dhe/ose rrethanave lehtësuese apo rënduese për të konkluduar në caktimin e llojit dhe masës së dënimit sipas ligjit penal. Subjekti i kushton rëndësi analizës dhe vlerësimit të provave të administruara dhe zbatimit të procesit të rregullt ligjor dhe ka marrë pjesë në aktivitete profesionale për ngritjen e nivelit të tij profesional. Nga vlerësimet e punës së subjektit Kujtim Luli për vitet 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se: në vitet 2015 dhe 2016, subjekti Kujtim Luli është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara prej tij, mbështetur në treguesit vjetorë të punës.

b. Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, prokuror Kujtim Luli, ka aftësi në arsyetimin ligjor. Aktet e arsyetuara prej tij janë të qarta, të plota dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe niveli i arsyetimit në aktet e vëzhguara është në përputhje me standardin e procesit të rregullt ligjor. Në aktet e përpiluara prej tij evidentohet pasqyrimi i rrethanave të faktit, disponimi dhe arsyetimi i vendimit të ankimuar, ankimi/et dhe shkaqet e ngritura/pretenduara dhe analiza e vlerësimi i provave në përputhje me bazën ligjore të aplikueshme për pranimin ose prapësimin e pretendimeve të ngritura.

⁹⁷Për më shumë të dhëna e detaje të subjektit mund t'i referoheni raportit të vlerësimit profesional të përgatitur nga KLP-ja, dokument i cili administrohet në dosjet e hetimit administrativ të Komisionit.

⁹⁸Bazuar në kriteret ligjore të parashikuara nga nenet 73-76 të ligjit nr. 96/2016.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, z. Kujtim Luli, në periudhën e rivlerësimit, ka kryer detyrën prokuror/drejtor në Prokurorinë e Përgjithshme dhe të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Durrës.

Lidhur me efektivitetin në aspektet sasiore dhe kohore, subjekti i rivlerësimitka përballuar ngarkesën e punës me efikasitet, në kohë dhe me cilësi. Nga analiza e pesë çështjeve të përzgjedhura në short, rezultoi se qëndrimi i tij është mbajtur brenda afateve, sipas kërkesave të ligjit procedural penal.

Ai ka përballuar një ngarkesë të konsiderueshme pune, duke treguar aftësi në organizimin efektiv të kohës së punës dhe duke kryer detyrat e ngarkuara me efikasitet.

Përsa i përket natyrës së çështjeve të Prokurorisë së Përgjithshme, subjekti i rivlerësimit, prokuror Kujtim Luli, ka ushtruar funksionin e prokurorit në Drejtorinë Gjyqësore e më pas drejtor/prokuror në Drejtorinë e Studimeve në Prokurorinë e Përgjithshme. Natyra e çështjeve ka qenë e larmishme, si përfaqësime në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë (KPGJL) në çështje të juridiksionit rishikues dhe në Gjykatën Kushtetuese, mbikëqyrje të ligjshmërisë dhe ushtrimin me eficensë të së drejtës së ankimit në Prokuroritë e Apeleve në Shkodër dhe Gjirokastrë dhe në Prokuroritë e Shkallës së Parë në juridiksionin e tyre, ekzekutim të vendimeve të KPGJL-së me ekzekutim të menjëhershëm, etj. Gjithashtu ka drejtuar e kontrolluar veprimtarinë e katër sektorëve të Drejtorisë për të përgatitur projekt-raportet e Prokurorit të Përgjithshëm për në Komisionet e Kuvendit të Shqipërisë, si dhe projekt-aktet normative të Prokurorit të Përgjithshëm. Ka dhënë mendime e sugjerime për projektligje apo projektvendime të Këshillit të Ministrave të ardhura për mendim në Prokurorinë e Përgjithshme, etj.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Nga shqyrtimi i dosjeve të shortuara rezulton se subjekti i rivlerësimit shfaq aftësi shumë të mira në organizimin efikas të punës së tij, në përfaqësimin e akuzës në proceset gjyqësore, duke përballuar me cilësi dhe shpejtësi volumin e punës. Kjo aftësi evidentohet si në proceset e përfaqësimit në çështje të juridiksionit rishikues në Kolegjin Penal të Gjykatës së Lartë (KPGJL) dhe në Gjykatën Kushtetuese, ashtu edhe gjatë periudhës që ka ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Apelit Durrës, në përfaqësimin në gjykim të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale në Gjykatën e Apelit Tiranë. Për vitet 2015 dhe 2016, vlerësimet e Prokurorit të Përgjithshëm për subjektin Kujtim Luli janë “shumë mirë” për aftësitë për të kryer procedurat gjyqësore prej tij.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i akteve të dorëzuara nga subjekti dhe dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, konstatohet se subjekti i rivlerësimit, prokurori Kujtim Luli, në ushtrim të kompetencave të tij, ka aftësi për të administruar dosjet, të cilat janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, na njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorëve dhe disponimin e gjykatave.

Nga vlerësimet e punës së subjektit Kujtim Luli për vitet 2015 dhe 2016, të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se subjekti Kujtim Luli është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë për të administruar dosjet prej tij.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Kujtim Luli, është konstatuar se ka treguar etikë në ushtrimin e funksioneve të prokurorit. Nga aktet e përzgjedhura nga subjekti, si dhe nga shqyrtimi i dosjeve të shortuara ka rezultuar se gjuha e përdorur në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Nga verifikimi në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se për subjektin e rivlerësimit nuk është marrë asnjë masë disiplinore.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, prokurori Kujtim Luli, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se subjekti ka ushtruar funksionet me integritet në punë, pasi nuk ka të dhëna në lidhje me ndikime apo presione të jashtme të çfarëdolloji. Nuk ka asnjë të dhënë apo ankesë për ndikim apo presion të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti dhe nga pesë dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Kujtim Luli. Në asnjë prej dokumenteve dhe dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Gjithashtu, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në tri dokumentet ligjore dhe në aktet e pesë dosjeve të vëzhguara gjuha e përdorur në akte nga subjekti i rivlerësimit është normale, komunikimi i tij është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë. Nuk rezultojnë të dhëna që flasin për mënyrën e komunikimit ndërpersonal të subjektit me pjesëmarrësit në proces.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në lidhje me vlerësimin e aftësive për të bashkëpunuar, nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, për vitet 2015 dhe 2016 të Prokurorit të Përgjithshëm, subjekti i rivlerësimit, prokurori Kujtim Luli, është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë e bashkëpunimit, mbështetur në treguesit vjetorë të punës së tij.

c) Gatishmëria për t’u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Kujtim Luli, ka marrë pjesë në aktivitete profesionale, si ekspert trajnimi vazhdues pranë Shkollës së Magjistraturës dhe për ngritjen e nivelit

profesional, ashtu edhe në shkëmbimin e eksperiencave apo përfaqësimin e institucionit brenda dhe jashtë vendit, duke u vlerësuar me certifikatat përkatëse, si vijojnë:

- pjesëmarrës në trajnimin me temë: “Jurisprudenca e GJEDNJ-së për çështjet kundër Shqipërisë në fushën penale. Zbatimi i tyre në praktikën gjyqësore”, zhvilluar në Shkollën e Magjistraturës, datë 28-29.7.2015;
- ekspert në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës “Rishikimi në procesin penal. Vendimet që mund të rishikohen. Rastet dhe procedura e rishikimit. Gjykimi i rishikimit në vështrim të jurisprudencës së GJL, GJK dhe GJEDNJ”, datë 24-25.4.2014;
- ekspert në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës “Rishikimi në procesin penal. Vendimet që mund të rishikohen. Rastet dhe procedura e rishikimit. Gjykimi i rishikimit në vështrim të jurisprudencës së GJL, GJK dhe GJEDNJ”, datë 23-24.4.2015;
- pjesëmarrës në trajnimin me temë “Metodat e hetimit në procesin penal dhe metodat e teknikat në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe krimeve serioze”, zhvilluar në Hagë-Hollandë, datë 5-17.10.2014.

C/1 RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Në lidhje me tri dokumentet⁹⁹ ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe mepesë¹⁰⁰ dosjet e përzgjedhura me short, trupi gjykues nga verifikimi i tyre nuk konstatoi asnjë problematikë në lidhje me komponentët e vlerësimit profesional, madje në dosjet e shortuara kryesisht është vendosur sipas kërimit të subjektit.

Ushtrimi i detyrës funksionale të subjektit të rivlerësimit shihet i ndërthurur midis rolit të tij si prokuror duke përfaqësuar organin e akuzës në instancat më të larta gjyqësore, por edhe në drejtim të ushtrimit të detyrës së tij në drejtorinë dhe më pas sektorin e koordinimit/studimeve, kërkimeve ligjore dhe integritit, me pjesëmarrje në përgatitjen e akteve normative të Prokurorisë së Përgjithshme, dhënien e mendimeve e sugjerime për projektligje apo projektvendime të ardhura për mendim nga Komisionet e Kuvendit të Shqipërisë, ministritë apo institucione me të cilët është e lidhur veprimtaria funksionale e prokurorisë, kontributet periodike të Prokurorisë së Përgjithshme për Raport Progreset në zbatim të rekomandimeve të BE-së; deri dhe aktualisht sikurse ka theksuar në parashtrësën e tij mbi vijueshmërinë e kontributit për implementimin e reformës në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm në përballje me sfidat aktuale në kuadrin e reformës në sistemin e drejtësisë penale.

⁹⁹Për analizën e thelluar mbi këto dokumente, referojuni raportit të vlerësimit profesional të KLP-së, në dosjen e hetimit administrativ të Komisionit. Dokumenti nr.1. Mendim para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, me objekt “shfuqizimin e toqfjalëshit Ky akt është përpiluar dhe nënshkruar në datën 1.12.2014, nga prokurori Kujtim Luli, në cilësinë e prokurorit pranë Prokurorisë së Përgjithshme Tiranë. Dokumenti nr. 2 “konkluzione për ankimin kundër vendimit penal nr. ***, datë 15.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Dokumenti nr. 3 “konkluzione për rekursin kundër vendimit nr. ***, datë 21.5.2012, të Gjykatës së Apelit Shkodër.

¹⁰⁰Dosja nr.1 “Konkluzione për vendimin penal nr. ***, datë 12.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë”. Dosja nr.2 “Konkluzione për vendimin penal nr. ***, datë 11.6.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan”. Dosja nr.3 Rekurs për vendimin nr. ***, datë 3.6.2015 të Gjykatës së Apelit Durrës, me të gjykuar A. Sh. . Dosja nr.4 Qarkore nr. ***, datë 26.5.2014, “Për unifikimin e ushtrimit me efikasë të së drejtës së ankimit”. Akti është konceptuar në datën 21.5.2014, nga prokurori Kujtim Luli, gjatë periudhës që ka ushtruar funksionin si Drejtor/Prokuror në Drejtorinë e Studimeve, Kërkimeve dhe Integritit në Prokurorinë e Përgjithshme. Dosja nr.5 “Konkluzione për rekursin kundër vendimit nr.***, datë 21.5.2012, të Gjykatës së Apelit Durrës me kërkues N.A.”.

Njohuritë e zhvilluara në këtë formë, përfshirë këtu edhe angazhimin si ekspert në trajnimet e organizuara nga Prokuroria e Përgjithshme, OPDAT, EURALIUS, KE, PAMECA, OSCE, IOM, QSHDNJ, KSHH, etj., autorësitë në disa botime dhe artikuj në fushën e drejtësisë, brenda dhe jashtë vendit, referimin në Konferenca dhe aktivitete kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare në kuadrin e projekteve të KE, EURALIUS, OPDAT, ICITAP, ABA/CELI, CARDS, DANIDA, PACO-IMPACT e CARPO të BE, etj., për reformimin e sistemit të drejtësisë dhe Prokurorisë në Shqipëri i kanë dhënë mundësinë të jetë më i suksesshëm në ushtrimin e funksionit të tij bazë, në mbrojtjen e organit të akuzës. Trupi gjykues, pas rivlerësimit të raportit të Grupit të Punës, mosadresimit të ndonjë denoncimi, nuk gjeti *indicie*, apo elemente që mund të ngrenë dyshime për paaftësi profesionale dhe, pas rekomandimit të relatores së çështjes, arrin në përfundim se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas gërmës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

VLERËSIM TËRËSOR I ÇËSHTJES

Trupi gjykues, referuar Aneksit të Kushtetutës, nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriteret e rivlerësimit, bazuar në vlerësimin tërësor të rrethanave të çështjes, në provat e administruara, në shpjegimet e subjektit në seancë dëgjimore publike, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara, konkludoi se subjekti i rivlerësimit, z. Kujtim Luli:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, mbështetur në parimin e objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, çmon se subjekti i rivlerësimit me veprimet dhe mosveprimet e tij nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Kujtim Luli, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.
- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, pas propozimit të relatores, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë” duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe neni 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kujtim Luli, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 3.12.2020.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Brunilda BEKTESHI
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare/Kundër

Sekretare gjyqësore
Denisa Kosta